

## Vrojtime leksikografike

# Konversioni në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe

Mr. Agim Spahiu

26 tetor 2008

### Përmbledhje

Në këtë shkrim flitet për një mënyrë të veçantë të fjalëformimit në gjuhën shqipe, siç është **KONVERSIONI**. **KONVERSION** do të thotë kalim i një pjese të ligjëratës në tjetër pa ndonjë ndajshitesë. Dhe kjo mënyrë e formimit të fjalëve është vështruar në kuadër të **Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980.

Gjuha shqipe është shumë e pasur nga kjo mënyrë fjalëformimi. Është karakteristike se e njëjta fjalë mund të ketë vlera të ndryshme leksiko- gramatikore. Kjo gjë mjaft gjerësisht dhe mirë është prezantuar edhe në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980. Autorët e këtij **Fjalori** kanë bërë përpjekje të përfshijnë fjalët në çdo kontekst, në çdo pozicion të ligjërimin. Kështu, p. sh. në këtë **Fjalor** ata e kanë shpjeguar mjaft gjerësisht fjalën **FLAKË**, si emër i gjinisë femërore, por nuk kanë lënë anash edhe përdorimet e tjera të kësaj fjale, ngase në pikën 5 e 6 shënohet edhe përdorimi mbiemëror (shkurt: përd. mb.), ndërsa në pikën 6 e 7 edhe si ndajfolje (shkurt: përd. ndajf); **FLAKË** f. 4. përd. mb. fig. Shumë i ndritshëm, që shkëlqen nga në është fare i ri a ngaqë ka ngjyra të ndezura (për një rrobë, për një send prej metali etj.); fare i ri. E kishte fustanin *flakë*. Me pushkë *flakë*. 5. përd. mb. fig. Që shkëlqen si zjarri, që shpreh një ndjenjë të zjarrtë; i zjarrtë. Me sytë e saj *flakë*. 6. përd. ndajf. Shumë, fare (zakonisht me mbiemrat i kuq, i ri). Flakë i kuq. E kuqe *flakë*. E re *flakë* (për një rrobë etj.). 7. përd. ndajf. Krejt, tërësisht; menjëherë. E mori *flakë*. Pra, në këtë shembull të Fjalorit shohim se fjala **FLAKË**, pos si emër i gjinisë femërore, në pozicione të tjera të ligjërimin, pa asnjë ndajshitesë, del edhe si mbiemër e ndajfolje. Kjo mundësi e fjalëformimit është shumë e njohur në gjuhën tonë, është shumë produktive dhe quhet **KONVERSION**.

Në **Gramatikën e gjuhës shqipe 1** (Morfologjia) të ASHSH-së këtë mënyrë të fjalëformimit e gjejmë të shpjeguar kështu:

*Konversioni është mënyra e formimit të një fjale të re si pasojë e kalimit të një pjese tjetër të ligjëratës për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit të*

saj. Duke kaluar në një pjesë tjetër të ligjëratës, fjala e formuar me këtë mënyrë ndërron edhe paradigmen e saj (fiton një paradigme të re), ose e humbet atë krejtësisht (kur një pjesë e ndryshueshme e ligjëratës kalon në një pjesë të pandryshueshme). Për këtë arsye konversioni është quajtur edhe mënyrë morfologjiko- sintaksore. Si formant fjalëformues në konversion shërben paradigma që fiton fjala e re e motivuar, ose humbja e paradigmes së vjetër dhe lidhjet e reja sintaksore të fjalës (kur kalohet nga një pjesë e ndryshueshme e ligjëratës në pjesë të pandryshueshme)<sup>1</sup>.

Po kështu, sipas kësaj **Gramatike**, dallohen dy grupe fjalësh të formuara me anë të konversionit:

1. Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës; dhe 2. Pjesë të ndryshueshme të ligjëratës. Te grupi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dallohen dy nëngrupe: a) Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që vijnë nga pjesë të pandryshueshme, p.sh., parafjalë prej ndajfoljesh: afër, anës, brenda, drejt, gjatë, jashtë, krahas, larg, matanë, para, pas, përmes, pranë, sipër, veç etj.; lidhëza prej ndajfoljesh: ku, kur, nga, si etj.; b) pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që vijnë nga pjesë të ndryshueshme, p. sh., ndajfolje: vjet, mot, sheshit, hipur, ndenjtur, shkoqur etj.; parafjalë: buzë, rreth, mes, rrëzë etj.; lidhëza: daç, qoftë; pjesëza: le, desh,; pasthërma: qyqja, korba, forca, o burra etj. 2. Pjesë të ndryshueshme të ligjëratës. Me anë të konversionit formohen emra prej mbiemrash ( të nyjshëm e të panyjshëm) dhe mbiemra të panyjshëm prej emrash<sup>2</sup>. Në gjuhësi dukuria e kalimit nga mbiemri në emër quhet emërzim a substantivim, kurse e kundërta mbiemërzim a adjektivim; po kështu, shndërrimi i një emri në ndajfolje quhet ndajfoljezim a adverbializim etj.

Në këtë shkrim, me qëllim që të kemi një pasqyrë sa më të saktë të kësaj dukurie gjuhësore, pra, për t'i parë të gjitha mundësitë e konversionit të kategorive leksikogramatikore të gjuhës shqipe, ne, edhe kësaj radhe, iu kemi qasur Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980. Dhe nga ky Fjalor, nëpërmjet programeve të njohura të Linux-it, kemi nxjerrë një **Fjalorth** ku përfshihen të gjitha rastet e mundshme të këtij lloj formimi të fjalëve në gjuhën tonë. Por, jemi gjithashtu të vetëdijshëm se edhe FGJSSH-i i vitit 1980 nuk mund të jetë krejtësisht shterues për këtë problematikë.

**ABSTRAKT** mb. 5. si em. ~E, ~JA f. Diçka që është nxjerrë me anë të përgjithësimit mendor dhe që vështrohet e shkëputur nga sendet, dukuritë dhe vetitë e marrëdhëniet e tyre konkrete; kund. konkrete. Nga konkretja tek abstraktja.

**ACAR** m. 5. përd. mb. Shumë i pastër e i

ngjirë (për veshjen). I ka petkat acar.

**ADALET** ndajf. thjeshtligj. 2. përd. mb. Shumë i madh, goxha. Një adalet tepsi.

**ADAXHIO** ndajf. muz. 2. si em. ~, ~JA f. ~, ~T. Vepër muzikore ose një pjesë e saj me kohë të ngadalshme e të zgjatur.

<sup>1</sup>Shih, Vep. e cit., f. 77.

<sup>2</sup>Po aty, f. 77/78.

- AFION** m. 3. përd. mb. Shumë i verdhë, shumë i zbehtë. U bë afion u zverdh shumë.
- AFRATË** f. 2. përd. mb. Shumë i hidhur (edhe fig.), llaçi ishte afratë. E ka gojën afratë.
- AGULLAÇ** mb. krahin. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Frutë e papjekur.
- AGURIDH** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. zakon. ~E, ~ET. Frutë e papjekur; rrush i papjekur, gresë. Aguridhet të mbledhin gojën. Kishte ngrënë ca aguridhe. Dalëngadalë aguridhja bëhet mjaltë. fj. u.
- AGZOT** m. 2. edhe përd. mb. fig. Shkëndijë, vetëtimë, zjarr. Trim agzot. Fjalë e agzot. E ka syrin agzot.
- AJËRFTOHËS** mb. tek. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat i posaçëm për ftohjen e ajrit.
- AJËRMATËS** mb. tek. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Vegël e posaçme, që shërben për matjen e dendësisë së ajrit ose të trupave të tjerë të gaztë.
- AJËRNXJERRËS** mb. tek. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat i posaçëm për nxjerrjen e ajrit në sistemet e ngrohjes.
- AJKË** f. 4. përd. mb. Gjysmë i lëngshëm e si i yndyrshëm, i butë (për salcën, baltën etj.).
- AKRILIK** mb. 3. si em. ~, ~U m. Lesh akrilik. Triko me akrilik.
- AKULL** m. 2. përd. mb. Shumë i ftohtë. M'u bënë duart akull. U bëra akull ngriva fare.
3. përd. mb. Shumë i pastër; i ngrirë. E bëri shtëpinë akull. I rrinë (i mban) rrobat akull.
4. përd. ndajf. Shumë, fare (me mbiemrat); shumë bukur, shumë mirë, shumë pastër (me foljet). Akull i ftohtë. I pastër akull. Akull i ri. Ishte veshur akull.
5. përd. mb. fig. I ftohtë, pa ndjenja (për njeriun); i ngrirë. Është akull me mua.
- ALAMET** m. thjeshtligj. 3. përd. mb. Përdoret para një emri me kuptimin: shumë i madh (i gjatë, i mirë, i bukur etj.). Alamet djali (vajze). Alamet shtëpie. Alamet dasme.
- ALEGRO** ndajf. muz. 2. si em. ~, ~JA f. ~, ~T. Vepër muzikore ose një pjesë e saj me kohë të shpejtë e të gjallë.
- ALFA** f. palak. 2. si em. f. ALF/Ë, ~A fig. libr. Fillimi i diçkaje, gjëja e parë që duhet bërë, pika nga duhet nisur; a-ja, abëcëja.
- ALILLUJA** pasth. fet. vjet. 2. si em. f. ~, ~T. Thirrja që shqiptohet dhe kënga lavdëruese, që këndohet si përgjigje pas disa lutjeve sipas dogmës në shërbesat e krishtera.
- ALLAFRËNGA** ndajf. thjeshtligj. 2. përd. mb. I bërë sipas modës së Evropës Perëndimore. Rroba allafrenga. Këpucë allafrenga.
- ALLAH** m. fet. vjet. 2. përd. pasth. Përdoret për të shprehur habi, çudi ose frikë, tmerr.
- ALLATURKA** ndajf. thjeshtligj. 2. përd. mb. Që është bërë sipas mënyrës turke-orientale. Kafe allaturka. Gjellë allaturka.
- ALLÇAK** m. thjeshtligj. 2. si mb. ~, ~E. Torollak, gjysmak nga mendja. Djalë allçak. Grua allçake.
- AMBICIOZ** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri që ka ambicie, ai që ushqen ambicie. Ambicioz i madh.
- AMFIB** mb. 4. si em. m. kryes. ~Ë, ~ËT biol. Kafshë ose bimë që mund të jetojnë në tokë dhe në ujë.
- AMULL** ndajf. 2. përd. mb. I amullt. Ujë amull.
- ANAMES** ndajf. krahin. 2. përd. parafj. Midis. Anames tyre.
- ANDANTE** ndajf. muz. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Vepër muzikore ose një pjesë e saj me kohë as shumë të shpejtë, as shumë të ngadaltë.

- ANDART** m. hist. 2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me çetat e komitëve grekë në shërbim të shovinistëve; që është karakteristik për to. Çeta andarte. Veshje andarte.
- ANGARI** f. 3. përd. ndajf. Në mënyrë të detyruar e pa marrë asnjë shpërblim. Punonin angari.  
4. përd. ndajf. fig. Pa dëshirë e shkel e shko, sa për të shkuar radhën. Punon angari. E bën (e merr) punën angari.
- ANTIZOGIST** mb. hist. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kundërshtar i regjimit antipopullor të Ahmet Zogut.
- ANTROPOID** mb. zool. 2. si em. m. vet. ~Ë, ~ËT. Familje e majmunëve, që i ngjajnë njeriut.
- APO** lidh. 6. përd. pj. Përdoret në fillim të një fjalie me kallëzues mohues për ta rrëzuar mohimin dhe për të përforcuar pohimin. Apo nuk ishte trim! Apo nuk janë të ëmbla! Apo nuk fliste!  
7. përd. pj. Përdoret së bashku me pjesëzën «jo» për të përforcuar një pohim a një mohim. Këndon bukur, apo jo? Nuk vlen fare, apo jo!
- AR** I m. 3. përd. mb. Në ngjyrë të verdhë të ndritshme, i artë. Flokë ari. Ngjyey në ar.
- ARAP** m. 6. përd. ndajf. Përdoret për të treguar shkallën e lartë të ngjyrës së zezë. Arap i zi u bë.
- ARAQE** f. krahin. 2. përd. ndajf. Si vjegë, që të mund të zgjidhet lehtë. E lidh araqe.
- ARGJEND** m. 4. përd. mb. Në ngjyrë të bardhë të shkëlqyer. I argjendtë.
- ARNAUT** m. vjet. 2. si mb. ~, ~E. Që lidhet me shqiptarët, i shqiptarëve (siç quheshin nga turqit), shqiptar. Luftëtarët arnautë. Trimëria arnaute.
- ARRË** f. 2. përd. mb. Me koren të pjekur mirë e brenda e butë (për bukën).
- ASKET** m. 3. si mb. ~, ~E. shih ASKETIK, ~E.
- ASHPËR** mb. 11. si em. ~ËR, ~RIT (të) as. Ashpërsi në sjellje e në fjalë; kund të butë. I foli (e pyeti, iu përgjigj) me të ashpër. E zuri me të ashpër.
- ASHTU** ndajf. 9. përd. pj. bised. Afërsisht, rreth, pothuajse. Ashtu si nga mbrëmja. Ashtu nga maji.
- AVENTURIER** m. 3. si mb. ~, ~E. Që vepron pa parime e me mendjelehtësi, që u hyn punëve të rrezikshme pa i peshuar mirë, që kërkon e bën aventura. Tip aventurier. Politikë aventuriere. Plan aventurier.
- AVULL** m. 6. përd. mb. I nxehtë, shumë i ngrohtë. U bë dhoma avull. Jam avull nga ethet.
- AXHAMI** m. bised. 3. përd. mb. bised. Që është ende i vogël e i parritur. Djalë axhami. Vajzë axhami.  
B.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja b. B-ja e madhe (e vogël). B-ja e dorës
- BADIHAVA** ndajf. bised. 4. përd. mb. Që kushton shumë lirë; që jepet falas ose pothuaj falas. Mall (plaçkë) badihava.
- BAJRAK** m. 5. përd. mb. Që e ka trupin të gjatë e të drejtë; i bukur, i hijshëm. Me shtatin bajrak.
- BAKALARO** f. 2. përd. mb. fig. bised. Thatanik. Ishte bërë bakalaro.
- BAKËRT** mb. 3. si em. BAKËRTA, ~T (të) f. vet. Bakëre. Të bakërtat rrojnë shumë.
- BALLË** I m. 7. përd. parafj. Përballë, përkundrejt, përpara. Ballë një muri. Ballë armikut.
- BALLËFSHEHUR** mb. 2. përd. ndajf. krahin. Me kokën të ulur nga turpi, me druajtje. Rrinte ballëfshehur.
- BALLËHAPUR** ndajf. 2. si mb. Që e ka ndërgjegjen të pastër, që ecën me guxim e pa druajtje në jetë; i hapur, i çiltër. Jam ballëhapur.
- BALLËKRENAR** ndajf. poet. 2. përd. mb. Që e mban ballin lart, krenar.

- BALLULUR** ndajf. 2. si mb. Që e mban kokën ulur nga hidhërimi a nga vuajtjet; kokulur. Gratë ishin ballulura.
- BARDHËKUQE** mb. bot. 2. si em. BARDHËKUQ/E~JA f. ~E, ~ET. Kërpudhë bardhëkuqe.
- BARKJASHTË** mb. 2. si em. BARKJASHT/Ë,~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri i varfër e i këputur; rreckaman, zhelan.
- BARKPANGOPUR** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Njeri i varfër e i këputur. Një barkpangopur kam qenë.
- BARKPLOT** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri që është i ngopur; i pasuri, pasaniku; kund. barkzbrazuri. Barkploti nuk i zë besë barkboshit. fj. u.
- BARKTHATË** mb. 3. si em. BARKTHAT/Ë,~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri që vuan urie nga skamja, njeri i varfër e i këputur. U ngritën barkthatët në luftë.
- BARKZBRAZUR** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Njeri që vuan urie nga skamja, i urituri; i varfëri, varfanjaku; kund. barkploti.
- BARNGRËNËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kafshë që ushqehet me bar e me bimë të ndryshme.
- BARUT** m. 2. përd. mb. fig. Që nxehet shpejt, që merr zjarr menjëherë; i gjallë e i shkathët, i zjarrtë. Është barut. E ka zemrën barut.
- BARXHË** f. 2. përd. mb. Që e ka qimen të përhimë, të përzier, gjysmë të bardhë e gjysmë të zezë (për dhitë). Dhi barxhe.
- BASHKUES** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT tek. Vegël që shërben për të bashkuar dy pjesë të një mekanizmi a dy sende. Bashkuesi i shulit të pushkës.
- BAZË** f. 16. përd. mb. Kryesor, themelor; që shërben si mbështetje ose si pikënisje. Njohuri bazë. Rregulla bazë. Çështje bazë. Punim bazë. Tekst bazë. Ide bazë. Ushqim bazë. Plehërim bazë. Parim bazë. Shkencë bazë. Sektor bazë. Çmim bazë. Rroga bazë.
- BEDEL** m. 4. përd. ndajf. Kot, për dhjamë qeni. Shkoi (vajti, u vra) bedel.
- BEHAR** m. 2. përd. mb. fig. Që është gjithnjë i qeshur e i përzemërt, që nuk zemërohet, i çelur e gojëmbël. Njeri behar. E ka gojën behar. Behar është gjithnjë.
- BELICË** f. 3. përd. mb. Që i ka kokrrat të bardheme. Qershi belicë.
- BELIK** mb. vjet. 2. si em. ~, ~U m. BELIQE, BELIQET. Pronë e shtetit, mall i shtetit. Malli i belikut.
- BEMOL** m. muz. 2. përd. mb. Një gjysmë toni më poshtë (për notat). Shkruar në si bemol.
- BERIHA** f. thjeshtligj. 2. përd. pasth. Përdoret si thirrje për ndihmë në rast rreziku.
- BERONJË** I f. 2. përd. mb. Që nuk bën fëmijë; që nuk pjell; që nuk prodhon: shterpë. Grua beronjë. Dele (dhi) beronjë. Tokë (arë) beronjë. Misër beronjë.
- BESË** f. 8. përd. mb. ~ËS (i, e). Që e mban fjalën e dhënë, besnik. Njeri (burrë) i besës. Grua e besës.
- BESUAR** mb. 2. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që gëzon besimin e plotë të dikujt; besnik.  
3. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të) vjet. Ai që ngarkohet nga dikush të kryente veprime në emër të këtij me fuqi të plota, ai që vepronte sipas porosive të dikujt.
- BEZHË** mb. 2. si em. BEZH/Ë,~A f. Ngjyra kafe e çelur pak në të verdhë; boja që ka këtë ngjyrë. Bezhë e hapur (e ndezur).
- BËRLLOK** m. 2. përd. mb. keq. I papastër, i ndyrë; që nuk vlen, i keq. Njeri bërllok. Mall bërllok mall i dobët, i pavlerë.
- BIGË** f. 7. përd. ndajf. Çift e drejt për-pjetë. I ka mustaqet bigë. I bëri (i ngriti, i çoi) këmbët bigë. mostërf. vdiq; ngordhi. I bën (i ngre, i mban) veshët bigë i ngre veshët për të dëgjuar më mirë, përgjon me vëmendje të madhe, i bën veshët pipëz.

- BIJË** f. 7. përd. mb. Që ka lindur ose që është formuar duke u shkëputur nga diçka tjetër kryesore a fillestare. Qelizë bijë. Ndërmarrje (uzinë) bijë. Shoqëri bijë.
- BILBIL** m. 4. përd. mb. Që këndon shumë bukur; që flet shpejt e bukur; që është i mprehtë, që e kap shpejt diçka. E ka gjuhën bilbil. Është bilbil nga goja. I ka veshët bilbil.
- BILUR** m. bised. 3. përd. mb. fig. Shumë i pastër, shumë i kthjellët; shumë i bardhë. Është qielli bilur.
4. përd. ndajf. fig. Shumë (me mbiemrat «i bardhë», «i pastër», «i kthjellët»).
- BIMËNDRËNËS** mb. biol. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kafshë a qenie tjetër që ushqehet me bimë.
- BINDËRME** f. 3. përd. ndajf. Njëri mbi tjetrin, që të puthiten mirë; kaluar, kaluarthi. I shtroj dërrasat bindërme. I vë vargjet e duhanit bindërme.
- BINJAK** mb. 4. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Kalli misri, që përbëhet nga katër a pesë kallinj të vegjël të ngjitur së bashku; vëllezër.
- BIRINXHI** ndajf. vjet. 2. përd. mb. Shumë i mirë, i dorës së parë. U bë birinxhi. Qenka birinxhi.
- BIS** pasth. 2. përd. mb. libr. Përdoret për të treguar që diçka del për se dyti, e përsëritur.
- BISBIQ** II m. 3. përd. mb. sipas kuptimeve të emrit. Dele bisbique. Fëmijë bisbiq.
- BISK** m. 5. përd. mb. I hollë i drejtë e i gjatë; i hajthëm. I ka vetullat bisk. U bë bisk.
6. përd. ndajf. Si fill i drejtë e pa ndërprerje. I doli gjaku bisk.
- BISKONJË** f. 3. përd. mb. I hollë, i gjatë e i drejtë si një bisk. Grua biskonjë. Vetull biskonjë.
- BISKOTË** f. 2. përd. mb. spec. I pjekur dy herë (për porcelanin a për qeramikën që nuk lyhet me smalt dhe që piqet dy herë në furrë). Prodhime biskotë.
- BISHTARTË** mb. 2. si em. BISHTART/Ë, ~A f. ~A, ~AT zool. Lloj fluturë, që e ka ngjyrën e bishtit të verdhë si ar.
- BISHTGJATË** mb. 2. si em. BISHTGJAT/Ë, ~I m. ~Ë, ~ËT. Fik me bisht të gjatë. Bishtgjatët piqen në gusht.
3. si em. BISHTGJAT/Ë, ~I m. ~Ë, ~ËT zool. Bishtatundës.
- BISHTJE** mb. 2. si em. BISHTJ/E, ~A f. ~E, ~ET. Dardhë bishtje.
- BITEVI** ndajf. bised. 2. përd. mb. Njëpjesësh, i gjithë, i tërë, i plotë, i njëjtë. Një bukë bitevi.
- BIZELE** f. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të blertë të çelur. Ngjyrë bizele. Këmishë (stof) bizele.
- BLETË** f. 3. përd. mb. fig. I shpejtë, i shkathët në punë.
- BOÇKË** f. 3. përd. mb. Që bën kokrra të mëdha e të rrumbullakëta (për pemët si arra, fiku, kajsia, kumbulla, qershia etj.); kokërrmadh. Arrë (kumbull, gështenjë, qershia) boçkë. Vezë boçkë.
- BOKË** f. 2. përd. mb. E ashpër e plot gurë, e varfër, jopjellore (për tokën). Arrë bokë.
- BONJË** f. 2. përd. mb. fig. Që e do punën, që punon shumë e mirë, e papërtuar, punëtorë e madhe (për gruan).
- BORË** f. kryes. nj. 2. përd. mb. Shumë i ftohtë, akull. I ishin bërë duart borë.
3. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat «i bardhë», «i pastër»). Qeleshe e bardhë borë (borë e bardhë). Borë e pastër.
- BORËPASTRUES** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë për të pastruar borën. Lopatat e borëpastrueses.
- BOSHT** m. 9. përd. mb. Qendror, kryesor; drejtues. Problem bosht. Fjalë bosht.
- BOZHURE** f. 3. përd. mb. Që nuk është pjellor, i varfër (për një lloj toke në ngjyrë të kuqërreme).

- BRESHËR** m. 3. përd. ndajf. Shumë, dendur e me vrull. I binin lotët breshër.
- BRESHËRIMË** f. 5. përd. mb. I shkoqur e kokrra-kokrra si breshër. Dhe (tokë) breshërimë.
- BRISK** m. 3. përd. mb. Shumë i mprehtë; shumë i ftohtë. I ka dhëmbët brisk. Uji është brisk.
4. përd. ndajf. Përdoret së bashku me disa mbiemra për të treguar shkallën e lartë të cilësisë që shprehin ata, me kup-timin «shumë, jashtëzakonisht». I mprehtë brisk.
- BUBULAK** mb. 3. përd. ndajf. Me vrull, me flakë të madhe e duke kërcitur, brambull (për zjarrin). Digjet bubulak.
- BUF** m. 4. përd. mb. bised. I plogët e i trashë nga mendja, matuf, torollak.
- BUFNJAK** m. 3. përd. mb. I butë dhe i shkrifët (kryesisht për dheun, për tokën).
- BUJKROBËRUES** mb. hist. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Feudal bujkrobërues. Pushteti i bujkrobëruesve. Përmbysja e bujkrobëruesve.
- BUKËVALE** f. 3. përd. mb. I butë e i shkrifët. Dhe (tokë) bukëvale.
- BUKURI** ndajf. bised. 2. përd. pasth. Mrekulli, shumë mirë.
- BUKUROSH** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT zool. Bishtatundës.
- BULLAMAÇ** m. krahin. 3. përd. mb. I qullët. Bukë bullamaç.
- BULLETËR** f. 2. përd. mb. Shumë i thartë. Kumbull bulletër. Kos bulletër. Narden bulletër.
- BUM** onomat. 4. përd. ndajf. Befas, papritur; drejtpërdrejt, copë. Ia tha bum. Më erdhi bum. Ia zuri derën bum.
- BUNACË** f. 5. përd. mb. Shumë i errët, i zi sterrë. Qiell bunacë. Natë bunacë.
- BURIM** m. 10. përd. ndajf. Çurg, rrëke. I shkonte gjaku (djersa) burim. I vinin lotët burim.
- BURNOT** m. 2. përd. mb. fig. keq. Që s'ka asnjë vlerë, që nuk shërben për asgjë; që s'di asgjë, i pazhvilluar nga mendja. Ishte burnot fare.
- BURRACAK** mb. keq. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Ai që nuk ka guxim, që ka shumë frikë, frikacak. Sjellje (qëndrim) prej burracaku.
- BURREC** m. mospërf. 4. përd. mb. Burracak.
- BURRË** m. 5. përd. mb. Trim, fisnik, i fjalës e i besës. Grua më burrë se burrat.
- BUSHIQ** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Flluskë, fshikë. Bushiqi i peshkut.
- BUZAGAZ** m. 2. si mb. ~, ~E. Që e mban gjithnjë buzën në gaz, i buzëqeshur; i qeshur. Vajzë buzagaze. Fytyrë buzagaze.
3. përd. ndajf. Me buzë në gaz, me buzëqeshje, me gëzim. I foli (iu përgjigj, e vështroi) buzagaz. E priti buzagaz.
- BUZËÇARË** mb. 4. si em. BUZËÇAR/Ë, ~I m. ~Ë, ~ËT. Lepuri (si figurë në përrallat për fëmijë).
- BUZËKYÇUR** mb. 3. përd. ndajf. Pa folur fare, pa hapur gojën, gojëkyçur.
- BUZËQESHUR** mb. 2. përd. ndajf. Me buzë në gaz, me gëzim. Të pret buzëqeshur.
- BUZËVARUR** mb. 2. përd. ndajf. Me buzë të varura, me të keq, pa dëshirë. Të pret buzëvarur.
- BUZOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Tingull buzor.
- BYK** m. 4. përd. mb. Që është bërë copë e çikë, që është si pluhur. Copë e byk. E bëj byk e bëj copë-copë, e bëj pluhur.
- C.
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja c. C-ja e madhe (e vogël). C-ja e dorës

- CA** I pakuf. bised. 4. përd. pj. Përdoret përpara emrit të një frymori ose të një sendi, kur folësi shpreh një farë habie, admirimi a përçmimi ose kur atij i duket se dikush a diçka ngjan me një tjetër. Kishte ca dhëmbë të bardhë si rruaza. Atje tej u dukën ca si njerëz.
- CAKËRR** ndajf. bised. 3. përd. mb. fig. I zbrazët, bosh; mendjelehtë. E ka kokën cakërr.
- CAMËRDHOK** m. 2. si mb. ~, ~E. I Vogël, vocërrak.
- CANGË** f. krahin. 2. përd. mb. I papjekur dhe i fortë (zakonisht për pemët). Fik cangë. Dardhë (pjeshkë, qershi) cangë.
- CARAN** m. 6. përd. mb. I fortë si gur, gur. Ishte buka caran.
- CENTIGRADË** f. spec 2. përd. mb. shih NJËQINDGRADËSH, ~E. Termometër centigrade termometër Celsius. Grade centigrade.
- CIKLAMIN** m. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të kuqe në vjollcë, si ajo e luleve të kësaj bime. Ngjyrë ciklamin. Bluzë ciklamin.
- CIPAL** m. 2. përd. mb. Shumë i hollë e i brishtë, fare i dobët. U bë cipal.  
3. përd. ndajf. Shumë (i hollë, i dobët, i tretur).
- CIRKATË** f. 3. përd. ndajf. Si curril i fortë. Rrjedh cirkatë.
- CUFËL** f. 3. përd. ndajf. Pezull në erë, si pendë, si pupël (kur ngremë diçka lart me lehtësi).
- CURRIL** m. 3. përd. ndajf. Duke rrjedhur çurg e me forcë. Shkon curril. Del curril. Rrjedh curril. Bie curril (shiu).  
4. përd. ndajf. Fill, drejt (në...). Curril pas tij. Curril e mbi to. Curril te dera.  
Ç.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja ç. Ç-Ja e madhe (e vogël). Ç-ja e dorës  
Ç? përem.
10. përd. ndajf. bised. Përse, për cilin qëllim; për ç'shkak, pse. Ç?të duhet? Ç?më rri aty? Ç?ta marr kot? Ç?e kërkon? Ç?është nevoja? E ç?të vete? Ç?të ta them kot! Çi ke ato para? Ç?më je nxirë ashtu? Ç?e do! është e kotë tashmë, nuk vlen, nuk duhet.
- ÇAKALLOZ** m. 3. si mb. ~, ~E. Që flet e vepron si i marrë; kokë krisur. Djalë çakalloz. Grua çakalloze.
- ÇALLATË** f. 3. përd. ndajf. Thellë dhe duke i hequr një copë. E preu çallatë. Ia hoqi gishtin çallatë.
- ÇALLË** I f. 2. përd. mb. I papjekur, i pabërë (për kokrrat e disa pemëve). Fik (dardhë, bajame) çallë. I ka çalla kokrrat.
- ÇAPSHPEJTË** mb. 2. përd. ndajf. Me hapa të shpejtë. Erdhi (hyri) çapshpejtë.
- ÇARK** m. 10. përd. ndajf. Si hark. Me vetullat çark.
- ÇARTAQEJF** m. 2. përd. ndajf. Çartaqejfas.
- ÇATALL** m. 8. përd. ndajf. Si bigë, duke u hapur anash me dysh. I vë çatall. I ngre çatall.  
9. përd. ndajf. Duke i hedhur këmbët anash e shtrembër. Eci çatall.
- ÇEHRENGRYSUR** mb. bised. 2. përd. ndajf. Me shprehje të vrenjtur në fytyrë; në mënyrë jo të butë, me zemërim. Hyri çehrengrysur. E vështroi çehrengrysur. Rrinte çehrengrysur.
- ÇEHREVRARË** mb. bised. 2. përd. ndajf. Me pamje të vrarë në fytyrë nga një fatkeqësi ose nga sëmundjet; fytyrëvlarë. Rrinte çehrevrarë.
- ÇELIK** m. 2. përd. mb. fig. Shumë i fortë, i çeliktë. Gur çelik. Grusht çelik. Rini çelik. E bëj çelik.
- ÇENGEL** m. 8. përd. mb. fig. Shumë i fortë, që nuk lodhet kurrë (për njerëzit). Burrë çengel.
- ÇEREKORE** f. 2. si mb. f. Që nxë një çereke drithë. Kusi çerekore.



- ÇFARËDO** pakuf. 2. përd. mb. I çfarëdoshëm. Një libër çfarëdo. Një këngë çfarëdo. Në një mënyrë çfarëdo.
3. si em. Çdo gjë, çdo send. Ha çfarëdo. Bëj çfarëdo. Çfarëdo qoftë. Çfarëdo që t'i thonë.
- ÇIKË** I f. 11. përd. mb. fig. Shumë i mirë, i zoti e trim, që i ka të rrallë shokët. Atë çikë vëlla.
12. përd. mb. fig. mospërf. Përdoret pranë një emri për të treguar se një njeri a një send është i vogël, i parëndësishëm, pa ndonjë vlerë të madhe. Ajo çikë letërsie. Atë çikë grua që kishte.
13. përd. ndajf. Në copa a në pjesë shumë të vogla, çika-çika. E bëri çikë e copëtoi shumë, e griu imët.
- ÇIP** m. 4. përd. ndajf. Me majë të hollë e pak të kthyer përpjetë. E ka hundën çip.
- ÇIPËS** mb. 2. si em. Lloj fiku që bën kokrra të tilla; kokrrat e këtij fiku. Çipësi është i ëmbël.
- ÇKA** II ndajf. bised. 2. përd. pj. S'ka gjë, nuk prish punë; njësoj është. Çka, e pranoj. Çka, çka, i vogël është ai.
- ÇOKOLLATË** f. 3. përd. mb. Që ka ngjyrë kafe të mbyllur në të kuqe.
- ÇOKSIDUES** mb. tek. 2. si em. ~, ~I m. -, -IT. Lëndë a tretësirë që i heq ndryshkun diçkaje. Çoksidues i fortë. Çoksiduesi i metaleve.
- ÇURG** m. 3. përd. ndajf. Duke rrjedhur shumë e me forcë; curril. Shkon (rrjedh, derdhet, del) çurg. I vete gjaku çurg. I binin lotët çurg. I rridhte djersa çurg.
- D.
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja d. D-ja e madhe (e vogël). D-ja e dorës
- DAC** m. 3. përd. ndajf. Lakuriq, zhveshur; pa asnjë gjë, pa asnjë plaçkë (për shtëpinë); bosh. U zhvesh dac. Ishte (mbeti) dac fare. E lanë dac. E kishte kuletën dac.
- DAFRUNGË** f. 2. përd. ndajf. Me qejfe e me gosti; shumë mirë, s'ka më mirë. E ka çuar jetën dafrungë. Ia çuan (e kaluan) dafrungë.
- DAHUK** m. bised. 4. si mb. ~, ~E. I gjatë e me majë. Qeleshe dahuke.
- DASHUR** 2. si ndajf. Dashur pa dashur ... me dashje ose pa dashje, me hir a me pahir; sidoqoftë.
- DASHURUES** mb. I dashuruar (edhe si em. m. e f.). Zemër dashuruese. Me shpirt dashurues. Me sy dashurues. Dashurues i zjarrtë. Dashurues i së vërtetës. Dashurues i natyrës (i librave, i pikturës, i sportit). Dashuruese e muzikës (e artit).
- DEBITOR** m. fin. 2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me debinë ose me debitorin; që është debitor; kund. kreditor. Ndërmarrje debitoare. Marrëdhënie debitoare. Xhiro debitoare.
- DEBUTUES** m. libr. 2. si mb. ~, ~E. Që debuton në një fushë veprimtarie. Skuadrat debutuese. Lojtarë (shkrimtarë) debutues.
- DECIGRADË** f. spec. 2. përd. mb. Që ka dhjetë nënndarje (për shkallën e termometrit dhe për gradët e këndeve gjeometrike). Termometër decigradë. Gradë decigradë.
- DEGË** f. 9. përd. ndajf. Drejt, qiri; si i ngrirë, akull. Rrinte degë në këmbë. I rrinë rrobat degë.
- DEKADENT** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ithtar i dekadentizmit, përfaqësues a përkrahës i dekadentizmit. Veprat e dekadentëve.
- DEKOLTE** f. 2. si mb. I prerë me jakë shumë të hapur që i lë të zbuluar qafën, shpatullat dhe një pjesë të gjoksit të asaj që e vesh (për një fustan a bluzë); e veshur me një fustan ose me bluzë që e ka jakën shumë të hapur (për një vajzë a grua). Fustan (bluzë) dekolte.

- DELI** mb. bised. 3. si em. ~, ~U m. ~NJ, ~NJTË. Trim i madh, trim i marrë. Çohu, deliu i nënës!
- DELL** m. 7. përd. ndajf. Si i ngrirë, akull. I rrinë rrobat dell.
- DENBABADEN** ndajf. bised. 2. përd. mb. Që është prej kohësh i tillë; vendës brez pas brezi. Fshatar denbabaden. El-banasan denbabaden.
- DENG** m. 4. përd. ndajf. Plot e përplot, buzë me buzë, dengëza. E mbushi deng. E ngarkoi (kalin) deng. U kthyen deng nga fusha. E ka shtëpinë deng.
5. përd. ndajf. Baras, barabar. Jam deng me të. Vijnë deng janë të barabartë, janë njësoj. S'e ka deng nuk është barabar me të, nuk është i denjë për të.
- DERËHAPUR** mb. 2. përd. ndajf. Me përzemërsi, si mik të shtëpisë. E priti derëhapur.
- DERI** 4. përd. pj. Përdoret bashkë me parafjalët në, me, mbi, nga, te(k), ndaj etj. dhe formon me to lokucione që së bashku me emrat e ndajfoljet tregojnë cakun më të tejme të një vendi a të një kohe ose shkallën më të tejme në të cilën arrin një veprim a një gjendje. Shkoi deri në Tiranë. U përkul deri në tokë. E preu deri në rrëzë. Duron deri në gjashtë muaj. Bari ishte deri në gju. Deri në mëngjes. I vendosur deri në fund. Besnik deri në vdekje. I kërkoi llogari deri në një (në pikën e fundit). I shfrytëzonin deri në palcë. I armatosur deri në dhëmbë. Deri më sot. Deri mbi çati. Arriti deri nën dritare. Deri te porta. Nga peri deri te gjilpëra. Deri ndaj të gdhirë. Shkoi deri te ministri.
5. përd. pj. Përdoret përpara parafjalëve në (më) e në bashkëvajtje me parafjalën nga dhe formon me to lokucionin lidhëzor nga... deri në (më), që, së bashku me emrat, tregon kufijtë e një periudhe të caktuar kohe ose caqet e një vendi, të një hapësire a largese. Nga mëngjesi deri në darkë. Nga shtata deri më dymbëdhjetë.
6. përd. pj. Përdoret bashkë me lidhëzat ku a kur dhe formon me to lokucione që shërbejnë për të lidhur fjali të varura, të cilat shprehin marrëdhënie vendore a kohore. E përcolli deri ku fillonte rruga. E prita deri kur mbaroi.
- DERR** m. 5. përd. mb. bised. Shumë i madh; shumë i rëndë; alamet, goxha. Një derr lopatë.
- DET** m. 5. përd. ndajf. Me shumicë, shumë, pa fund; plot e përplot. U bë gurri det. Rrjedh det. Ishte det ara me misër. Det është pazari.
- DEVOLLIÇE** ndajf. 2. përd. mb. Që këndohet a që luhet sipas mënyrës së devollinjve; që është karakteristik për krahinën e Devollit, që është krijuar nga devollinjtë, e Devollit. Valle devolliçe. Këngë devolliçe.
- DËFTOR** mb. gjuh. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Përemri dëftor. Dëftorët e shqipes. Lakimi i dëftorëve.
- DËFTUES** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Gishti dëftues. Vuri dëftuesin mbi hartë.
- DËM** m. 3. përd. ndajf. Kot më kot, pa asnjë dobi; humbur. Shkoi (vajti, iku) dëm. E çoi
- DËMTUAR** mb. 2. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që ka pësuar dëmin, ai që është dëmtuar; i plagosuri. Të dëmtuarit nga lufta (nga tërmeti). Me kërkesën e të dëmtuarit.
- DËNUAR** mb. 2. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që është dënuar me vendim gjyqi. I dënuar politik. Riedukimi i të dënuarve.
- DËRMON** m. krahin. 3. përd. ndajf. Vrima-vrima, shoshë. Iu bë këmisha dërmon.
- DËRRASË** f. 5. përd. mb. fig. bised. I sheshtë, i rrafshët; petë. E ka gjoksin dërrasë (zakonisht për një vajzë a grua me gjoks të pazhvilluar).
6. përd. mb. fig. bised., keq. I trashë nga mendja, budalla; që s'di gjë fare. Është fare dërrasë. Ishte dërrasë në aritmetikë.

- DËRRMAK** m. 2. përd. mb. Shumë i vogël e i mbledhur si topt, i vogël sa një thërrime (sidomos për fëmijët). Ka mbetur dërrmak.
3. përd. ndajf. Kruspull, lëmsh. U mbloodh dërrmak. Mbeti (rri) dërrmak në shtrat.
4. përd. ndajf. Pa e kryer tërësisht, pa e rregulluar a pa e çuar deri në fund, përgjysmë, në mes të udhës. E la dërrmak punën. I mbeti dërrmak misri i mbeti misri në arë, pa e ngritur e pa e futur në koçek. I mbeti bari dërrmak i mbeti bari i kositur në livadh, pa e vënë mullar.
- DIBRANÇE** ndajf. 2. përd. mb. Që bëhet, që këndohet, që luhet etj. sipas mënyrës së dibranëve; që e mbajnë a e veshin dibranët. Valle (këngë) dibrançe. Veshje dibrançe.
- DIELL** m. 6. përd. mb. fig. Shumë i bukur, që i ndriçon fytyra, që ndrit i tëri. Nusja hënë e djali diell.
- DIMËR** m. 4. përd. ndajf. (në rasën dhanore të numrit njëjës të shquar). Gjatë dimrit, në dimër. Dimrit shtegtonin (zbritnin) në fusha.
- DISA** pakuf. 4. përd. pj. shih CA I,4.
- DISK** m. 7. përd. mb. Që ka trajtën e një pjate ose të një sferë të shtypur nga të dyja anët. Sharrë disk. Bombë disk. Krehër disk. Gërshërë disk.
- DITË** f. 10. si mb. DITËS (i,e). Që i përket pikërisht kohës sonë, që lidhet me periudhën kur jetojmë; që ka rëndësi tashti, që vlen a përdoret tashti ose që duhet zgjidhur sa më parë; që është bërë brenda ditës e që është caktuar për atë ditë. Çështje e ditës. Detyrë e ditës. Këngë të ditës. Gjellë të ditës. E vlerësonte si problem të ditës.
- DJALL** m. 5. përd. mb. thjeshtligj. Që të mundon shumë, që të mërzit, që të pëlçet shpirtin; shumë i keq; drej. Djall punë. Djall kohë. Djall fëmijë.
- DJATHTIST** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ndjekës e përkrahës i djathtizmit, oportunist i djathtë.
- DOKUDO** ndajf. 3. përd. mb. Që s'dallohet nga të tjerët; që s'ka ndonjë rëndësi, që është fare i rëndomtë; i parëndësishëm; çfarëdo. S'është njeri dokudo ai. S'është detyrë (punë) dokudo.
- DOMOSDOSHËM** mb. 3. si em. ~ME, ~MJA (e) f. ~ME, ~MET (të). Diçka që duhet patjetër, diçka që është shumë e nevojshme. Përmendi (theksoi) vetëm të domosdoshet. Dallon gjënë e rastit nga e domosdoshmja.
- DORËJASHTË** mb. 2. përd. ndajf. Pa u përzier në një punë, në një çështje, në një ngatërresë etj. Qëndroi (mbeti) dorëjashtë.
- DORI** m. 2. përd. mb. Që ka qime të kuqërreme, qimekuq (për kuajt). Kalë (pelë) dori.
- DOSIDO** ndajf. 2. përd. mb. I dosidoshem. Punë dosido. Nuk është dosido.
- DRE** m. 2. përd. mb. fig. Shumë i shpejtë e i shkathët (për një djalë). Ishte dre.
- DREJT** ndajf. 11. përd. pj. Përdoret për të përcaktuar a për të saktësuar më mirë drejtimin e lëvizjes, me kuptimin «mu». E shikoi (e vështroi) drejt në sy.
- DREJTPËRDREJT** ndajf. 3. përd. pj. Përdoret për të përforcuar kuptimin e fjalës a të fjalisë me të cilën lidhet. Punon drejtpërdrejt në prodhim. Varet drejtpërdrejt nga ajo.
- DREKË** f. \* Drekën e mirë! përd. pasth. përdoret si përshëndetje kur njerëzit ndahen nga njëri-tjetri pak para drekës. I ngrënça drekën! mallk. shih te HA. Ku e zë dreka, s'e zë darka udhëton a bredh shumë nga një vend në tjetrin, nuk rri në një vend.
- DRENUSHË** f. 2. përd. mb. fig. E urtë dhe e butë (për një vajzë a nuse).

- DREQ** m. 5. përd. mb. thjeshtligj. Që të mundon shumë, që të pëlçet shpirtin; shumë i keq; djall. Një dreq kollë. Ajo dreq sëmundje.
- DRITË** f. 9. përd. mb. fig. Shumë i pastër, që shkëlqen, pasqyrë. E bëri dritë shtëpinë (oborrin). I mban dritë rrobat.
- DRITËGJATË** mb. mjek. 2. si em. DRITËGJAT/Ë, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri dritëgjatë.
- DRITËHEDHËS** mb. usht. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat a mjet që hedh dritën në largësi të madhe. Dritëhedhës i fuqishëm. Është pajisur me dritëhedhës.
- DRUDHË** f. 2. përd. mb. Shumë i dredhur, me kaçurrela (për flokët). Flokë drudhë. Lesh drudhë.
- DRUNGRËNËS** mb. zool. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kandërr a vemje drungrënëse.
- DUAJLIDHËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë duajlidhëse ose grua a vazjë që merret me lidhjen e duajve pas korjes.
- DUDËSH** m. 2. si mb. ~, ~E. Dhëmbërënë.
- DUET** m. muz. 3. përd. ndajf. Bashkë me një tjetër, me dy zëra. Këndojnë duet.
- DUHI** f. 3. përd. mb. fig. I fortë, i fuqishëm. Trim duhi.
- DUMAN** m. vjet. 2. përd. ndajf. Si re e dendur tymi, pluhuri etj.; gjithë tym a pluhur. Ngrihet duman tymi (pluhuri). E lëshon (e nxjerr) tymin duman. E çonte dëborën duman. Ishte bërë dhoma duman. E bëri vendin duman.
- DUMDUM** mb. usht. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Fishek dum-dum.
- DUMKË** f. 2. përd. mb. I shëndoshë si top. Djalë (vajzë) dumkë.  
3. përd. ndajf. Plot me diçka. E kishte kuletën dumkë me para.
- DYBUZOR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET gjuh. Bashkëtingëllore dybuzore. Dybuzoret e shqipes (p, b).
- DYFAQËSH** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT gjeom. Figurë dyfaqëshe; kënd dyfaqësh. Dyfaqësja të barabartë. Dyfaqësja të kundërt dyfaqësja me faqe që shtrihen njëra pas tjetrës. Dyfaqësja të bashkëmbështetur dyfaqësja që kanë një faqe të përbashkët dhe të tjerat që shtrihen njëra pas tjetrës. Faqet e dyfaqëshit. Brinja e dyfaqëshit.
- DYLLË** m. 6. përd. ndajf. Shumë (për shkallën më të lartë të ngjyrës së verdhë). Dyllë i verdhë ë(i verdhë dyllë).
- DYMBËDHJETËRROKËSH** mb. let. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Varg me dymbëdhjetë rrokje. Përdorimi i dymbëdhjetërrrokëshit.
- DYNJA** f. bised. 3. përd. ndajf. Në sasi të madhe, me shumicë, shumë. U bë tym (pluhur) dynjaja.
- DYSOR** m. gjuh. 2. si mb. ~, ~E. Që është formuar nga dy pjesë, që ka dy pjesë përbërëse; që lidhet nga kuptimi, nga funksioni etj. me një tjetër dhe krijon me të një çift; dylojësh. Format dysore të fjalëve (të trajtave gramatikore).
- DYST** ndajf. bised. 5. përd. mb. I dystë. Vend dyst. Rrugë dyst. Arë (fushë) dyst.
- DYTHUNDRAK** mb. 2. si em. ~Ë, ~ËT m. vet. zool. Kafshët përtypëse, si lopa, derri, dreri etj., që e kanë thundrën të çarë me dysh. Rritja e dythundrakëve.
- DYZETË** num. rresht. 4. si em. f. vet. DYZETAT (të). Periudhë prej dyzet vjetësh si moshë. I kaloi të dyzetat.  
5. si em. f. vet. DYZETAT (të) fet., vjet. Dita e dyzetë pas vdekjes së dikujt, që përkujtohej nga të afërmit; dreka a darka që shtrohej me këtë rast (sipas besimeve të kota). Mbushi (kishte, i bënë) të dyzetat.
- DH** 2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja dh. Dh-ja e madhe (e vogël). Dh-ja e dorës (e shtypit).
- DHANORE** mb. gjuh. 2. si em. DHANORE, ~JA f. Rasa dhanore. Dhanore e shquar (e pashquar).

- DHE** I lidh. 8. përd. pj. Përdoret në fillim të një togfjalëshi a të një fjalie për të përforcuar ose për të theksuar kuptimin që shprehet prej tyre ose për t'i dhënë gjallëri e bukuri ligjërimin a për të rritur fuqinë shprehëse të tij. Dhe pranvera erdhi. Dhe sot fshati lulëzon. Dhe lindi te ne jeta e re.
9. përd. ndajf. Përdoret përpara mbiemrave dhe ndajfoljeve në shkallën krahasore me kuptimin «në një shkallë me të lartë, me shumë, me tepër, ca».
- DHENOR** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Dhi që rri e kullot bashkë me dhentë, dhi në tufën e dhenve.
- DHËMBOR** mb. 3. gjuh. si em. ~ E, ~JA f. ~E, ~ET. Tingull dhëmbor.
- DHIRTË** mb. 3. si em. DHIRT/Ë.-A (e) f. -A. -AT (të). Dhia ose cjapi. Të leshtat dhe të dhirtat dhentë e dhitë. E dhirta nuk bëhej kurban.
- DHJETË** mb. 5. si em. f. vet. DHJETAT (të). Periudhë prej dhjetë vjetësh si moshë. I mbushi të dhjetat.
- DHJETËDITËSH** mb. 2. si em. ~,1 m..~A, ~AT. shih DHJETËDITOR,-I. Dhjetëditëshi i parë (i dytë, i tretë) i muajit. Në dhjetëditëshin e fundit.
- DHJETËDITOR** mb. 2. si em. m.~I -Ë, ËT. Njësi kohe e barabartë me dhjetë ditë; dhjetë ditë rresht duke i numëruar nga një ditë çfarëdo. Dhjetëditori i parë (i dytë, i tretë).
- DHJETËKËMBËSH** mb. zool. 3. si em. vet. -A, -AT. Klasë që përfshin një varg kafshësh të tilla.
- DHJETËLEKËSH** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Kartëmonedhë me vlerë dhjetë lekë. Dhjetëlekëshe e re. I dha një dhjetëlekëshe.
- DHJETËQINDARKËSH** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ ET bised. Monedhë dhjetëqindarkëshe
- DHJETËSH** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Një radhë (sendesh, njerëzish etj.) që përbëhet nga dhjetë njësi, tërësi e përbëre nga dhjetë njësi, grup i përbërë nga dhjetë qenie ose sende. Dhjetëshja e parë. Dhjetëshja më e mirë.
4. si em. f. vet. ~E, ~ET shtypshkr. Shkronja dhjetëshe. Dhjetëshe të drejta (të holla).Dhjetëshe të zeza.
- DHJETËVARGËSH** mb. let. 2. si em. ~, ~I m.~A, ~AT. Strofë me dhjetë vargje. Dhjetëvargëshi i parë.
- DHJETËVJEÇAR** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kohë e barabartë me dhjetë vjet; dhjetë vjet rresht të numëruar që nga një vit çfarëdo. Dhjetëvjeçari i parë (i dytë, i fundit)i shekullit. Gjatë disa dhjetëvjeçarëve.
- DHJETËVJETËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A,~AT. shih DHJETËVJEÇAR,~I.
- E. I
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja e. E-ja e madhe (e vogël). E-ja e dorës (e shtypit).
- E IV lidh.
5. përd. pj. Përdoret në fillim të një togfjalëshi a të një fjalie për të theksuar kuptimin që shprehet prej tyre. E sot fshati duket si në festë. E u nis pastaj tërë gëzim.
- EDHE** II lidh. 8. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË mat. Shenja e mbledhjes (+); plus.
- EGËR** mb. 11. si em. ~, ~IT (të) as. Egërsi në sjellje e në fjalë; kund. butësi. Me të egër me të keq, duke u grindur. Foli me të egër. Sillej me të egër. E qortoi me të egër. E mori me të egër. Herë me të butë e herë me të egër.
- EGOIST** mb. 2. si em. ?, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri egoist. Egoist i madh.
- EJA** 2. përd. pasth. Përdoret kur e thërrësim, kur e ftojme a kur e nxitim dikë për të nisur një punë, për të bërë diçka së bashku etj.; hajde. Eja të dalim! Ejani të këndojmë!

- EKLEKTIK** mb. libr. 2. si em. ~, ~U m, ~Ë, ~ËT. Pasues, ndjekës a zbatues i eklektizmit në ideologji, në politikë, në art, në shkencë etj.
- EKSIQ** ndajf. bised. 2. përd. mb. I mangët; i metë. Njeri eksiq. E la sëmundja eksiq.
- EKSPRES** mb. libr. 4. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Mjet transporti (tren, aeroplan etj.) ekspres; kafe ekspres. Udhëtoj me ekspres. Pi një ekspres.
- EKUIVALENT** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~E, ~ET. Diçka që ka vlerë të barabartë me një tjetër, diçka e barasvlerëshme; barasvlerës. Ekuivalent i fjalës.
- ELBASANÇE** ndajf. bised. 2. përd. mb. E ulët, njëkatëshe (për shtëpinë). Shtëpi elbasançe.
- EMËRORE** mb. gjuh. 2. si em. EMËROR/E, ~ JA f. Rasa emërore. Emërore e shquar (e pashquar).
- ENTUZIAST** mb. 2. si em. ~I m. ~Ë, ~ËT. Ai që vepron e punon me entuziazëm; ndjekës e përkrahës i zjarrtë i diçkaje. Entuziast i artit (i shkencës, i muzikës, i sportit). Vepër entuziastësh. Është entuziast i madh.
- EPIK** mb. 3. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Krijues i veprave epike.
- EPILEPTIK** mb. mjek. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Ai që vuan nga epilepsia.
- ESENCIAL** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. Ajo që është thelbësore a e qenësishme; pika thelbësore a më e rëndësishme, e qenësishmja. Dalloj esencialen.
- ESHKË** f. 3. përd. mb. I tharë shumë, i eshkosur; i thatë e i rrudhur. Barutin e mbajmë eshkë.  
4. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i thatë, i rrudhur). Ishte bërë eshkë e thatë.
- EVGJIT** m. 2. si mb. Që i përket kësaj popullsie; që është krijuar nga ajo popullsi, që është veti e saj.
- Ë** I 2. si em. f. Zanorja dhe shkronja ë. Ë-ja e madhe (e vogël). Ë-ja e dorës (e shtypit).
- ËMBËLSIQ** mb. 2. si em. f. ~E, ~JA ~E, ~ET. Ëmbëlsirë me fare pak sheqer ose që ka sheqer shumë me pak nga ç'duhet; gatesë e ëmbël, por jo e shijshme.  
F.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja f. F-ja e madhe (e vogël). F-ja e dorës
- FAQEHËNË** mb. poet. 3. si em. FAQEHËN/Ë, ~A f. ~A, ~AT. Grua a vajzë me fytyrë të rumbullakët, të mbushur e të bukur. Erdhi faqehëna.
- FAQEMOLLË** mb. 2. si em. FAQEMOLL/Ë, ~A f. ~A, ~AT. Vajzë a grua me faqe të kuqe si molla; vajzë a grua e bukur dhe plot shëndet.
- FAQESHGË** mb. 2. si em. FAQESHGË/Ë, ~A f. ~A, ~AT. Vajzë a grua me faqe të kuqe si shegë.
- FAQEZA** ndajf. 5. përd. parafj. Në prani të dikujt, në sy të dikujt, faqe. Faqeza prindërve.
- FARË** f. 13. përd. mb. bised. Shumë i mirë, aq i mirë (vihet para emrit). Ai farë djali! Ajo farë vajze! Ai farë trimi! Ai farë gruri!  
14. përd. mb. Përdoret së bashku me emra për të shënuar njerëz ose sende me mospërfillje, me përçmim, me përbuzje, me ironi etj. Ai farë shkrimtari! Mos u bëj merak për atë farë burri!  
16. përd. ndajf. Aspak, fare. Pa farë frike.
- FARËGJATË** mb. 2. si em. FARËGJAT/Ë, ~I m. Misër farëgjatë.
- FARËMADH** mb. 2. si em. FARËMADH, ~I m. Misër me kërcell të lartë, dhe me kalli e me kokrra të mëdha, që piqet vonë; misër farëgjatë.
- FARËSHKURTËR** mb. 2. si em. FARËSHKURT/ËR, ~ RI m. Misër farëshkurtër. Farëshkurtri piqet në gusht.

- FARFURI** f. 3. përd. mb. Që është i bardhë e i shkëlqyeshëm, që të merr sytë. E ka gushën farfuri.
- FARMAK** m. bised. 2. përd. mb. Shumë i hidhur, shumë i kripur; helm. Qenka bërë farmak gjella. E kam gojën farmak. 3. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i kripur, i hidhur). Farmak i kripur. Farmak i hidhur.
- FASHË** II f. 2. përd. ndajf. Në qetësi. Bie fashë pushon, qetësohet, fashitet.
- FATALIST** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri fatalist.
- FATRRËFYES** m. 2. përd. mb. Që gjoja parashikon a parathotë diçka.
- FATTHËNËS** m. 2. përd. mb. Që gjoja parashikon a parathotë diçka.
- FEMËR** f. 5. përd. mb. I gjinisë femërore, femëror. Kafshë femër. Viç femër. Peshk femër. Lule femër. 6. përd. mb. Që është e futur a e theluar dhe hyn a mbërthehet në të pjesa tjetër. Kopsë (mbërtheckë) femër.
- FËRGUIAR** mb. 2. si em. ~, ~A (e) f. kryes. ~A, ~AT (të). Gjellë a ushqime të fërguara. Nuk i ha të fërguarat.
- FËRKIMOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Tingull fërkimor.
- FËRTELE** f. 2. përd. ndajf. Në shumë copa, copa-copa. E bëri fërtele.
- FËRTYMË** f. krahin. 3. përd. ndajf. Me shpejtësi dhe me forcë të madhe, si veriu. Iku fërtymë.
- FIÇOR** m. 4. përd. ndajf. Luaj fiçor: luaj duke vendosur një guralec në mes të një rrethi në tokë e duke e gjuajtur me gurë të tjerë.
- FIDAN** m. 2. përd. mb. fig. I drejtë e i gjatë në trap, filiz. Djalë fidan. Me trupin fidan.
- FIJE-FIJE** ndajf. 5. përd. mb. Që ka disa fije. Tel fije-fije. 6. përd. mb. Që është copëtuar a është shqyer në disa pjesë. Këmishë fije-fije.
- FIKS** mb. libr. 2. përd. ndajf. Pikërisht në kohën e caktuar, as me herët as me vonë; pikërisht Doli fiks në orën pesë. Erdhi në orën tetë fiks.
- FILAN** pakuf. 2. si em. m. ~, ~I dhe f. ~E, ~IA. Një njeri (grua a burrë), të cilit s' duam t'ia përmendim emrin. Ma tha filani. Erdhi filania.
- FILISTIN** m. libr. 2. si mb. ~, ~E. Që ka horizont kulturor të ngushtë e botë shpirtërore të vogël dhe që sillet në mënyrë hipokrite, shpirtvogël e me dy faqe; mikroborgjez. Sjellje (frymë) filistine. Vetëkënaqësi filistine.
- FILIZ** f. 5. përd. mb. fig. I drejtë e i gjatë (në trap). E ka shtatin filiz. 6. përd. mb. fig. Shumë i ri në moshë, i mitur, i njomë. Është ende (fare) filiz.
- FILTRUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat me filtër.
- FILLESTAR** mb. 5. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT, Ai që sapo ka filluar të punojë në një fushë a në një profesion, ai që është në hapat e parë; ai që nuk ka shumë përvojë në një punë. Fillestar në punë. Libër për fillestarët.
- FILLOR** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. bised. Shkollë fillore. Nxënës (mësues) i fillores. Mbaroi filloren.
- FINOK** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Njeri i hollë nga mendja e dinak; njeri dhelparak e i djallëzuar. Finok i madh.
- FIRË** f. 2. si ndajf. bised. Pa gjë brenda, bosh. E kish barkun firë. Bëhet firë humbet, zhduket; Vdes. Shkon (vete) firë shkon kot, vete dëm.
- FISKAJË** f. 3. përd. mb. I hollë e i drejtë si bisk. E kishte vetullën fiskajë.
- FISHEK** m. 4. përd. ndajf. bised. Menjëherë, shpejt e shpejt, pa e zgjatur. Shkoi (iku, vajti, u nis) fishek. E nxori fishek përjashta. Doli fishek nga dera.
- FISHKËLLIMË** f. 3. përd. ndajf. Me shpejtësi të madhe, me vrull. Vinin plumbat fishkëllimë.

- FISHKËLLOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Tingull fishkëllor.
- FJOLLË** f. 3. përd. ndajf. Si shtëllungë, shtëllunga-shtëllunga. E nxirrte tymin fjollë.
- FJONGO** f. 3. përd. ndajf. Vjegëz. E lidh fjongo gjalmin.
- FLAKADAN** m. 4. përd. ndajf. Si zjarr i madh me flakë, si flakë e madhe. Digjet flakadan.
- FLAKË** f. 4. përd. mb. fig. Shumë i ndritshëm, që shkëlqen nga në është fare i ri a ngaqë ka ngjyra të ndezura (për një rrobë, për një send prej metali etj.); fare i ri. E kishte fustanin flakë. Me pushkët flakë.
5. përd. mb. fig. Që shkëlqen si zjarri, që shpreh një ndjenjë të zjarrtë; i zjarrtë.
6. përd. ndajf. Shumë, fare (zakonisht me mbiemrat i kuq, i ri). Flakë i kuq. E kuqe flakë. E re flakë (për një rrobë etj.).
7. përd. ndajf. Krejt, tërësisht; menjëherë. E mori flakë.
- FLAKËRIM** m. 4. përd. ndajf. shih FLAKËRIM/Ë, ~A 6.
- FLAKËRIMË** f. 4. përd. mb. I përskuqur. Me sytë flakërimë. U bë flakërimë u përskuq, u skuq.
5. përd. mb. Shumë i shpejtë, vetëtimë. Është flakërimë nga këmbët.
6. përd. ndajf. Shumë shpejt, menjëherë, vetëtimthi. Iku (shkoi) flakërimë.
- FLAMË** f. 7. përd. mb. bised. Shumë i keq, shumë i mërzitshëm. (vihet para emrit). Një flamë kollë. Ajo flamë sëmundje.
- FLAMOSUR** mb. 3. si em. f. Sëmundje e keqe, e rëndë; e mallkuara. E zuri e flamosura.
- FLAURI** f. 2. përd. ndajf. Ashtu si pluhuri kur e merr era, duke u ngritur e duke u sjellë përpjetë në ajër; fluturimthi. Vjen (ngrihet) flauri. Sillej flauri.
- FLEGMATIK** mb. 3. si em. ~, ~U m. ~Ë ~ËT. Njeri me temperament të qetë e të ngadalshëm.
- FLETË** II f. 7. përd. mb. Që ka trajtën e një cope letre a të një pllake të hollë. Duhan fletë. Bakër fletë.
- FLETË-FLETË** mb.
2. përd. ndajf. Në trajtën e fletëve; duke a ndarë në shumë fletë. Palos fletë-fletë.
- FLETOR** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Dru me fletë të gjera. Lloje fletorësh.
- FLORI** m. 5. përd. mb. Që është bërë prej ari, i florinjte. Para flori.
6. përd. mb. fig. Që ka veti a cilësi shumë të mira; shumë i mirë, i mrekulueshëm; shumë i çmueshëm, i shtrenjtë. Grurë flori. I ka duart flori bën çdo gjë që i sheh syri, është shumë i zoti. E ka zemrën flori. Koha është flori.
7. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i verdhë, i pastër, i kulluar). Flori i verdhë. Flori i pastër (i kulluar).
- FLUTUR** f. 5. përd. mb. Që ka pamjen a trajtën e një kandre të tillë ose që lëviz si ajo. Kollare (kravatë) flutur. Stil flutur. sport, mënyrë notimi me trup të shtrirë, me kokë të zhytur në ujë e me të dy krahët të hapur, që lëvizen në të njëjtën kohë.
6. përd. mb. Shumë i shpejtë e i shkathët; shumë i lehtë. Grua (nuse, vajzë) flutur. Është flutur.
7. përd. ndajf. Me shpejtësi, shpejt. Të shkosh e të vish flutur.
8. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i lehtë, i shpejtë). Flutur i lehtë. Flutur e shpejtë.
- FLUTURAK** mb. 4. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Zog; kandërr që fluturon. Fluturak i bukur. Lloje fluturakësh. Emra fluturakësh.
- FLUTURIM** m. 2. përd. ndajf. Fluturimthi. Sulet fluturim.



- FLLAD** m. 3. përd. ndajf. Freskët. Është (bën) fllad.
- FORCË** f. 11. përd. pasth. Përdoret për të nxitur dikë në një punë, a në një veprim.
- FRESK** m. 4. si ndajf. Freskët. Është (bën) fresk.
- FRESKËT** mb. 7. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që rilexon i fundit lëndën e një gazete përpara se të shtypet përfundimisht.
- FRIKACAK** mb. 2. si em. ~U m. ~E, ~ET. Ai që ka shumë frikë.
- FRINGO** mb. 2. përd. ndajf. Veshur me rroba shumë të mira e të pastra; me rroba krejt të reja. Ishte veshur fringo. Rrinte fringo.
- FRUTOR** mb. 2. si em. f. vet; ~E, ~ET përmb. Drurët frutorë, pemët.
- FRYMËZUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që frymëzon dikë për të bërë një punë, ai që të ngjall frymëzim. Frymëzues i zjarritë. Frymëzuesi e drejtuesi i veprës.
- FRYTJE** mb. 2. si em. FRYTJ/E, ~A f. ~E, ~ET bot. Fryzë.
- FUGË** III f. krahin. 3. përd. ndajf. bised. Menjëherë, shumë shpejt, fluturimthi. U nis fugë për në shtëpi. Erdhi fugë.
- FUKARA** m. bised. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit.
- FULLTAKA-FULLTAKA** mb.  
2. përd. ndajf. Në trajtë fulltakash, duke i dalë fulltaka. Iu ngrit lëkura fulltaka-fulltaka.
- FUNDOR** mb. libr. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET gjuh. Rrokje, grup tingujsh a tingull në fund të fjalëve. Fundorja e fjalëve. Fundorja -ë (-e, -at, -më, -izëm...).
4. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. gjuh. vjet. Prapashtesë.
- FUQIMADH** mb. 2. si em. ~, ~I m. Zoti (sipas botëkuptimit fetar).
- FUQIPLOTË** mb. 2. vjet. si em. FUQIPLOT/Ë, ~I m. Zoti (sipas botëkuptimit fetar).
- FURTUNË** f. 3. përd. mb. Shumë i shpejtë e i shkathët. Djali ishte furtunë.
- FURRË** f. 5. përd. mb. Shumë i nxehtë; që ka zjarrmi të madhe. Është furrë djali. Ishte furrë dita dje.
- FUTË** f. 3. përd. mb. Shumë i zi. Ishte bërë futë në faqe ishte nxirë shumë, ishte vrarë keq në faqe. U bë futë u nxi me bojë; u nxi (nga një sëmundje a plagë).
- FYELL** m. 5. përd. mb. bised. I drejtë si fyell. Trup fyell.  
6. përd. mb. bised. Bosh. Është fare fyell. E ka mendjen fyell.  
7. përd. ndajf. bised. Shumë (zakonisht me mbiemrin i drejtë). E kishte shtatin fyell të drejtë.
- FYT** m. 7. përd. mb. bised. I zbrazët, bosh. Fyelli është fyt. E ka barkun fyt.  
8. përd. ndajf. bised. Pa gjë, zbrazët, bosh. E lë fyt. Mbeti fyt.  
G.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja g. G-ja e madhe (e vogël). G-ja e dorës (e shtypit).
- GABIM** m. 3. përd. ndajf. bised. Shtrembër, jo drejt, në mënyrë të gabuar; jo si duhet ose jo ku duhet; gabimisht. Flet gabim. E bëri (e dërgoi) gabim. E kuptoi gabim. E mori gabim. E ka gabim. Hyri gabim.
- GACË** f. 4. përd. mb. fig. Që shndrit a duket sikur lëshon xixa, i ndezur, i zjarritë, plot guxim e zgjuarsis. I ka sytë gacë.
- GAGAÇ** m. 2. si mb. ~, ~E. Që i merret goja, i belbër. Djalë gagaç.
- GAJASUR** mb. 3. si em. ~, ~A (e) f. ~A, ~AT (të). Zëri që nxjerr dikush kur meket së qeshuri ose së qari. U dëgjuan të gajasura.
- GAJTAN** I m. 2. përd. mb. poet. I hollë e i drejtë (zakonisht për vetullat). E ka vetullën gajtan.

- GALACU** m. 2. përd. ndajf. Kruspull, lëmsh. U mblodh galacu.  
3. përd. ndajf. Ulur me njëren këmbë nën vete dhe me tjetrën të thyer në gju e me shputë në tokë. Rri galacu.
- GALAMSH** m. 2. përd. ndajf. Kruspull, lëmsh. U mblodh galamsh.
- GALË** f. 3. përd. mb. Që i ka qimet të zeza (për lopën a delen). Dele (lopë) gale.
- GALOP** m. 3. përd. ndajf. Me shpejtësi e duke kërcyer. Vrapon (rend) galop.
- GARBË** f. 4. përd. mb. I çjerrë, i ngjirur (për zërin). Iu bë zëri garbë.
- GARROQ** m. 6. përd. mb. I zgavërt; i prishur, i shkatërruar. Lis garroq.
- GASTARE** f. 4. përd. mb. fig. I pastër dhe i ndritshëm si qelq; i kulluar, i kthjellët. E ka fytyrën gastare. U bë qielli gastare
- GATITOR** mb. 3. si em. -E, ~JA f. ~E, ~ET vjet. Shkollë ose klasë gatitore.
- GATITU** pasth. 2. përd. ndajf. Në drejtqëndrim e pa lëvizur. Qëndron (rri) gatitu. Jam (në) gatitu.
- GAZAVAJ** m. 2. përd. mb. Që shpreh gëzim dhe vajtëm. Iso gazavaj.  
3. përd. ndajf. Me të qeshur e me të qarë, me gëzim e me hidhërim njëkohësisht.
- GAZEP** m. bised. 3. përd. ndajf. Jashtë mase, tepër, shumë. Gazep i madh (i fortë). Gazep i bukur.
- GËRDEC** II m. 2. përd. mb. I ngurtë e i fortë si i ngrirë; i pazier ose i papjekur mirë (për mishin).
- GËRDHELE** f. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Tokë (arë) gërdhele.
- GËRFYELL** m. krahin. 2. përd. mb. fig. Që e ka kokën bosh, budalla. E paska kokën gërfyell.
- GËRHALË** f. 2. përd. mb. Që e ka sipërfaqen të palëmuar ose me të thelluara e me të ngritura; i ashpër. Gurë gërhalë. Lëkurë gërhalë. Fytyrë gërhalë.
- GËRMADHË** f. 5. përd. mb. I shkretë, i gJORË. Gërmadha plakë! Ç?e gjeti, gërmadhën!
- GËRMAJË** II f. krahin. 2. përd. ndajf. Në sasi të madhe, plot e përplot; grumbull. U mblodhën gërmajë.
- GËRMUQ** mb. bised. 3. përd. ndajf. Me trup të kërrusur, gërmuqas. Rri gërmuq. Shkonte gërmuq.
- GËRQINJË** mb. 2. si em. GËRQINJ/Ë, ~A f ~A, ~AT. Kumbull gërqinjë; fryti i kësaj peme.
- GËRSHET** m. sh 4. përd. ndajf. Në trajtë të një tufe a të një vargu të përbërë nga tri pjesë të thurura bashkë. Thur (bëj) gërshet flokët (hudhurat, qepët, zorrët).
- GËRSHËRË** f. 6. përd. mb. sport. Që bëhet duke kryqëzuar këmbët ose duart. Stil gërshërë mënyrë kërcimi së larti që bëhet duke kryqëzuar këmbët në ajër. Not gërshërë lloj noti që bëhet duke u shtrirë gjysmë anash e duke kryqëzuar duart dhe këmbët.
- GËRXH** m. 3. përd. mb. Që është plot me shkëmbinj të mprehtë e të thepisur; shkëmbor. Vend gërxh.
- GËRXHALL** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Duhan gërxhall.
- GËRR** onomat. bised. 2. përd. ndajf. Menjëherë, shpejt e shpejt, aty për aty; në mënyrë të pandërprerë, njëri pas tjetrit, çurk. Gërr paratë. Gërr fjalët. Gërr lotët.
- GËSHTENJË** f. 2. përd. mb. bised. Që ka ngjyrë kafe të errët në të kuqërreme si ajo e lëkurës së hollë që mbështjell thelbin e gështenjës. Sy gështenjë. Flokë gështenjë. Ngjyrë gështenjë.
- GLOBAL** mb. libr. 3. si em. ~, ~I m. Shuma e përgjithshme e diçkaje; sasia e përgjithshme. Globali i të ardhurave. Realizimi i globalit.  
4. si em. ~, ~I m, keq. Realizimi i planit vetëm në sasi, pa pasur parasysh ose duke

- shkelur kërkesat për cilësi të mirë të prodhimit e për të gjitha asortimentet; globalizëm. Në global. Si global. Rendja pas globalit.
- GOJËHAPUR** ndajf. 2. edhe përd. mb. fig. Në gjendje të tillë kur jemi shumë të çuditur a të mahnitur. Mbeti gojëhapur. E la gojëhapur. Rrinte (dëgjonte) gojëhapur.
- GOJËMBYLLUR** mb. 2. përd. ndajf. Me gojën të mbyllur, pa folur. Rri gojëmbyllur.
- GOJËPASHMAGJE** mb. 2. si em. GOJËPASHMAGJ/E, ~JA f. ~E, ~ET. Grua a vajzë që flet shumë, llafazane.
- GOJËTHATË** mb. 2. përd. ndajf. Pa shtënë gjë në gojë. E la gojëthatë.
- GOLLE** f. 4. si mb. ~, ~E. Bosh, i zbrazët, që s'ka gjë brenda. Arrë golle. Vend goll.
- GORRICË** f. 3. përd. mb. fig. bised. I papjekur, axhami.
- GOXHA** bised. 2. përd. mb. Përdoret zakonisht para një emri për të treguar një tipar cilësor në shkallë të lartë me kuptimin «mjaft a shumë i madh (i gjatë, i mirë, i bukur, i rëndësishëm...)». Goxha burrë (djalë). Goxha grua (vajzë). Ka goxha trup. Goxha shtëpi. Goxha shkrimtar. Goxha vepër. Goxha luftë.
- GRANATAHEDHËSE** f. usht. 2. si mb. Që shërben për të hedhur granata. Armë (mortajë) granatahedhëse.
- GRANIT** m. 2. përd. mb. fig. Shumë i fortë; i paepshëm, i pamposhtur. Grusht granit. Rini granit.
- GRAZHDAR** m. 3. si mb. ~, ~E. Që ushqehet rregullisht në grazhd, që mbahet e rritet me kujdes (zakonisht për kuajt). Kalë grazhdar.
- GREKOMAN** m. hist. 2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me grekomanët, i grekomanëve. Borgjezia grekomanë. Kleri grekoman. Agjentët grekomanë.
- GRESË** f. 3. përd. mb. Që nuk ka arritur ende kohën e përshtatshme për t'u mbjellë (për tokën). Tokë gresë.
- GRETH** m. zool. 3. përd. ndajf. Plot e përplot, mbushur plot. Është greth hardhia. Janë greth degët me kokrra.
- GRI** mb. 2. si em. ~, ~JA. Ngjyra gri.
- GRIGJË** f. 3. përd. ndajf. Tufë; me shumicë. U bënë grigjë limonët sivjet.
- GRIMCË** f. 5. përd. ndajf. (së bashku me numërorin një). shih GRIM/Ë, ~A 2.
- GRIMË** f. 2. përd. ndajf. Shumë pak, një thërrime, një fije (përdoret së bashku me numërorin një). Një grimë. Për një grimë 3. përd. ndajf. Fare, aspak (përdoret zakonisht së bashku me përemrin asnjë). S'frynte asnjë grimë erë. S'kishte asnjë grimë shpresë. S'hëngri asnjë grimë.
- GROPË** f. 5. përd. mb. Që është i thelluar si gropë. Vend gropë.
- GRUMBULL** m. 3. përd. ndajf. Në grup, mbledhur bashkë, si tufë, së toku, tok; mbledhur shuk, si grusht. Ecin (rrinë, mblidhen) grumbull. Fluturojnë grumbull. U bë grumbull u mblodh shuk, u mblodh grusht.
- GRUP** m. 6. përd. ndajf. Si një tufë e vetme, grumbull. Dolën grup.
- GRUPASH** m. keq. 2. përd. mb. Që sillet e vepron sipas frymës së grupeve fraksioniste, që është karakteristik për grupe të tilla, fraksionist. Element grupash.
- GRUSHT** m. 7. përd. ndajf. fig. Me radhë të ngjeshura e të shtrënguara, shtrënguar si grusht, duke qenë i bashkuar fort me të tjerë. Jemi grusht. Bëhemi grusht. 8. përd. ndajf. Kruspull, lësh. U mblodh (u bë) grusht.
- GRYKË** f. 15. përd. ndajf. Fytafyt, grykas; në grindje të vazhdueshme njëri me tjetrin.
- GRYKËNGUSHTË** mb. 3. si em. GRYKËNGUSHT/Ë, ~A f. ~A, ~AT euf. Pushkë. I shkëlqente grykëngushta.

- GRYKËPËRPJETË** mb. 2. përd. ndajf. Me grykë të drejtuar lart (për armët, enët etj.). E ktheu grykëpërpjetë.
- GRYKËPOSHTË** mb. 2. përd. ndajf. Me grykë të drejtuar poshtë (për armët, enët etj.). E mban grykëposhtë.
- GRREMÇ** m. 6. përd. ndajf. Si çengel, si grremç. E bëj grremç.
- GUFE** f. 3. përd. mb. Që ka shumë pendë zakonisht në kokë. Pulë gufe gufkë.
- GUFKË** f. 4. përd. mb. Që ka një xhufkë pendësh në kokë, gufe. Pulë gufkë.
- GUNGË** f. 8. përd. mb. Që ka lëvozhgë të fortë, që mezi çahet e që nuk i del thelbi lehtë (për arrat). Arrë gungë.
9. përd. mb. Që ka gjinj të vegjël, të fortë e me pak qumësht (për bagëtitë). Lopë (dele, dhi) gungë.
10. përd. mb. edhe fig. I fortë, i fuqishëm; që ka kockë të fortë, që nuk nënshtrohet, i papërkulur. Njeri gungë.
11. përd. mb. fig. keq. Kokëfortë.
12. përd. mb. Që nuk dëgjon mirë, i rëndë nga veshët.
- GUR** m. 12. përd. mb. Shumë i fortë e i ngjeshur. Buka ishte gur. Ka ngrirë dheu, është bërë gur. I ka faqet gur i ka faqet të shëndosha, të ngjeshura. E ka mishin gur.
13. përd. mb. Shumë i rëndë. Thesi qenka gur.
14. përd. ndajf. Shumë (me disa mbiemra). Gur i fortë. Gur i rëndë. Gur i ftohtë.
- GURAÇOK** m. 2. përd. ndajf. Guraçokthi. Luaq guraçok.
- GURKALI** m. kim. 2. përd. mb. I kaltër në të gjelbër, që e ka ngjyrën si të gurkalit. Ngjyrë gurkali. Rroba gurkali.
- GURTHËRRMUES** m. 2. si mb. ~, ~E. Që thërrmon gurë (për punëtorët e për makinat).
- GURRË** f. 4. përd. ndajf. Me shumicë, shumë, rrëke, çurkë. I shkonin lotët gurrë.
- GUSHËKUQ** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT vjet., përçm. Xhandari (kështu e quante populli me përçmim xhandarin në kohën e regjimit antipopullor të Zogut, sepse kishte një copë cohë të kuqe në jakën e xhaketës). U përleshën me gushëkuqët.
- GJ.
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja gj. Gj-ja e madhe (e vogël). Gj-ja e shtypit (e dorës). Gj-ja nistore.
- GJAK** m. 9. përd. mb. I gjakosur. E kish këmbën gjak. U bë gjak.
10. përd. mb. Shumë i kuq. I kish duart gjak. I janë bërë faqet gjak i janë skuqur shumë.
11. përd. ndajf. Shumë (për shkallën më të lartë të ngjyrës së kuqe të ndezur).
- GJAKBËRËS** m. 2. si mb. ~, ~E. Gjakderdhës.
- GJAKDERDHËS** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Gjakbërës, vrasës.
- GJAKOSHAR** mb. bot. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Portokall me tul të kuq, portokall me shegë.
- GJASHTËDHJETË** num. rresht. 4. si em. f. vet. ~AT (të). Periudhë prej gjashtëdhjetë vjetësh si moshë. I mbushi të gjashtëdhjetat.
- GJASHTËMBËDHJETËRROKËSH** mb. let. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Varg që ka gjashtëmbëdhjetë rrokje. Përdorimi i gjashtëmbëdhjetërrrokëshit. Vjershë në gjashtëmbëdhjetërrrokështa.
- GJASHTËMUAJSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Gjashtëmujor. Gjashtëmujsh i parë (i dytë) i vitit.
- GJASHTËRROKËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Varg që ka gjashtë rrokje. Theksat e gjashtërrrokëshit. Vjershë në gjashtërrrokështa.
- GJASHTËVARGËSH** mb. let. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Strofë prej gjashtë vargësh. Gjashtëvargëshi i parë.

- GJASHTORËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Periudhë kohe që vazhdon a zgjat gjashtë orë; e drejta për të punuar gjashtë orë në ditë, që u jepet nga komisioni mjekësor atyre që vuajnë nga sëmundje të caktuara. Gëzon të drejtën e gjashtorëshit.
- GJATOSH** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Gishti më i gjatë i dorës, gishti i mesëm.
- GJETH** m. 5. përd. mb. Që është fletë e plotë, i papërpunuar ose i pagrirë. Duhan gjeth.
- GJEVREK** m. 2. përd. mb. bised. Që thyhet lehtë, që shkërmoqet; i brishtë (edhe fig.) Dru gjevrek. Fiku është gjevrek.
- GJEZAP** m. bised. 2. përd. mb. Që të djeg shumë. Qepët ishin gjezap.
- GJINORE** mb. gjuh. 2. si em. GJINOR/E, ~JA f. Rasa gjinore. Gjimore e shquar (e pashquar). Gjinatorja e njëjësit (e shumësit). Nyja (mbaresa) e gjinores.
- GJITAR** m. zool. 3. si mb. f. ~E. Që ka gjinj të mëdhenj dhe që jep shumë qumësht; qumështore. Lopë gjitare. Dhi gjitare.
- GJITHASHTU** ndajf. 3. përd. lidh. Përdoret së bashku me disa lidhëza në togje këpujore e kundërshtore. Gjithashtu edhe... E gjithashtu... Por gjithashtu...
- GJITHË** pakuf. 7. përd. pj. Krejt, njësoj si dikush tjetër (nga vetitë trupore a morale), gjallë, tërë. Ishte gjithë i ati (i vëllai). Ishte gjithë e ëma (e motra). 8. përd. pj. Pikërisht; po. Gjithë aty (atje). Gjithë në ato vite (në atë ditë).
- GJITHFARËSOJ** pakuf. 2. përd. ndajf. bised. Në mënyra nga më të ndryshmet. Gjithfarësoj mund të ndodhë.
- GJITHMONË** ndajf. 3. përd. pj. Gjithnjë. Gjithmonë po aty. Gjithmonë e më mirë.
- GJITHNDUERSH** ndajf. 2. përd. mb. Gjithfarësh. Plaçka gjithnduersh. Pemë gjithnduersh.
- GJITHNJË** ndajf. 4. përd. pj. Përdoret me shkallën krahasore të mbiemrave e të ndajfoljeve për të treguar një tipar që përforcohet me kalimin e kohës ose nga një shkallë në tjetrën. Gjithnjë e më i bukur. Gjithnjë e më mirë. Gjithnjë e më shumë (më tepër). Gjithnjë e më lart (më poshtë, më thellë, më tej).
- GJITHQYSH** ndajf. 3. përd. lidh. Ashtu si, si. Punonte gjithqysh i vinte për dore.
- GJITHSEJ** ndajf. 3. përd. pj. Vetëm, vetëm e vetëm. E ka fjalën gjithsej te puna.
- GJOK** m. 2. përd. mb. I bardhë nga thinjat. Koka gjok e mendja zog. fj. u.
- GJUHËLIDHUR** mb. 2. përd. ndajf. Pa folur, gojëmbyllur. Rrinte gjuhëlidhur.
- GJUHOR** mb. 4. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET gjuh. Tingull gjuhor.
- GJUMËDHËNËS** mb. 3. si em. ~, I m. ~, ~IT. Bar, ilaç që të vë në gjumë, gjumës. Pi një gjumëdhënës.
- GJYNAH** m. fet. vjet. 5. përd. pasth. bised. Përdoret për të shprehur keqardhje për dikë a diçka; sa keq. Gjynah, e shkreta! Sa gjynah!
- GJYNAHQAR** m. 3. si mb. ~, ~E. Që ka bërë gjynah sipas dogmës myslimane; që lidhet me një gjynah, që është gjynah. Njeri gjynahqar. Dëshirë gjynahqare.
- GJYRYK** m. 2. përd. ndajf. Me rrymë të fortë, me shumicë e me forcë (për erën, tymin). Frynte era gjyryk. E nxirrte tymin gjyryk.
- GJYSMAK** mb. 5. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT vjet. shih GJYSMATAR, ~I 2.
- GJYSMË** f. 7. përd. ndajf. Në një farë mase, jo plotësisht, jo i tërë ose deri në fund; përgjysmë. Gjysmë i hapur (i mbyllur). Gjysmë i gatshëm (i përgatitur). Gjysmë i zhveshur. Gjysmë i fjetur (i dehur). Gjysmë i egër. Gjysmë i leshtë (i mëndafshhtë, i pambuktë). Gjysmë i mekanizuar. Gjysmë me shaka. Gjysmë me të qeshur.

8. përd. ndajf. Përgjysmë, në njërën nga dy pjesët e barabarta (zakonisht e përsëritur). Gjysma lesh, gjysma pam-buk. Gjysma ujë, gjysma verë. Gjysma e zezë, gjysma e bardhë.
- GJYSMËFINALE** f. sport. 2. si mb. ~, ~E. Që bëhet për të nxjerrë finalistët. Ndeshje gjysmëfinale.
- GJYSMËNJERI** m. 3. përd. mb. I dobësuar e pa fuqi, i ligur.  
4. përd. mb. I metë nga mendja ose që ka filluar ta humbasë gjykimin.
- GJYSMËPËRÇUES** m. fiz. 2. si mb. ~E. Që ka përcueshmëri elektrike të dobët ndër-mjet përcuesve dhe izoluesve. Lëndë gjys-mëpërcues.
- GJYSMËZANORE** f. gjuh. 2. si mb. ~, ~E. Që mund të shqiptohet si gjysmëzanore. Tingull gjysmëzanor.
- GJYSMOKAR** mb. vjet. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Enë që nxë gjysmë oke. Mat me gjysmokare.  
H  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja h. H-ja e madhe (e vogël). H-ja e dorës
- HABERTAR** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT vjet. Lajmëtar.
- HAJVAN** m. bised. 4. si mb. ~, ~E thjeshtligj. I trashë nga mendja, budalla. S'kishte njeri më hajvan se ai. Paska qenë fare hajvan (hajvane).
- HALË** f. 6. përd. mb. Shumë i mprehtë (edhe fig.). I ka dhëmbët halë. E mprehu briskun e bëri halë. E ka gjuhën halë.
- HALIJER** m. vjet. 2. përd. mb. Që ishte brak-tisur, që ishte lënë pas dore, i shkretë. Vend (tokë) halijer. Mali halijer.
- HALL** m. bised. 4. përd. ndajf. Keq. Hall kështu, hall ashtu. Hall ta marrësh, hall ta lësh. Hall me të, hall pa të. Hall me buaj, hall me qe. fj. u.
- HALLALL** m. bised. 3. si mb. ~, ~E. I mirë, i drejtë, i mbarë. Djalë hallall. Vajzë hallalle.
- HALLDUPÇE** ndajf. bised., mospërf. 4. përd. mb. E tillë, siç e këndonin a e kërcenin halldupët. Këngë (valle) halldupçe.
- HARAM** m. bised. 3. përd. mb. I prapë, i keq; që s'vlen, i padobishëm. Djalë haram. Gjë harame.
- HARDALL** m. 4. përd. mb. I trashë nga mendja; budalla. Njeri hardall.
- HARK** m. 8. përd. mb. I përkulur, i lakuar. I ka vetullat hark.  
9. përd. ndajf. Rrotull, rreth, qark. U mbloodhën (u vunë) hark. I vuri gurët hark.
- HARKAT** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. Vel prej mëndafshi të përzier me pambuk. E mbuloi fytyrën me harkate.
- HATA** f. bised. 3. përd. ndajf. Shumë. Ishte e bukur hata. Ishte lodhur hata. I pëlqeu hata.  
4. përd. ndajf. thjeshtligj. Shumë mirë. E kaluan kohën hata. Punon hata.
- HEKUR** m. 8. përd. mb. Shumë i fortë. Është hekur. E ka zemrën hekur. Është bërë hekur është forcuar shumë.
- HELM** m. 4. përd. mb. Shumë i hidhur. Është helm. E kam gojën helm. Helm e ka fjalën. Është bërë helm gjella është bërë shumë e kripur, pothuajse e hidhur nga kripa e tepërt, është bërë aq e kripur sa s'vihet në gojë.  
5. përd. mb. fig. Shumë i hidhëruar, i pikëlluar. Helm e pikë (helm e vrer).
- HELL** m. 3. përd. ndajf. Drejt e pa lëvizur. Qëndroi hell. Rrinte hell në këmbë.
- HERË** f. sh 4. përd. ndajf. Përdoret e përsëritur në kuptimin «një kohë, një çast; një rast».
- HERGJELE** f. 3. përd. mb. Që kullot e mba-het jashtë në gjendje gjysmë të egër; që nuk është shaluar a nuk është vënë në

- punë ende (zakonisht për kuajt). Kalë (mushkë) hergjele.
4. përd. ndajf. Në tufa që kullotin e mba-hen jashtë në gjendje gjysmë të egër; në gjendje të lirë, pa zot e pa erë (edhe fig.). I mbajnë hergjele. Mos e lësho hergjele.
- HEROIK** mb. 4. si em. ~E, ~JA. shih HEROIK/Ë,~A. Heroikja e ditëve tona. Heroikja në këngët popullore (në letërsinë e realizmit socialist).
- HË** pasth. bised. 6. përd. pj. Përdoret kur shprehim një veprim që shtyhet, që pritet të ndodhë nga dita në ditë a nga një çast në tjetrin; përdoret kur shprehim një veprim që mezi bëhet. Hë sot, hë nesër. Hë ta kap këtu, hë të kap atje. Hë të bjerë an-dej e hë të bjerë këtej. Hë aty, hë këtu.
7. përd. ndajf. Përdoret e përsëritur me kuptimin «ca nga ca» (sidomos në tregimet e përrallat popullore). Hë, hë, arritën. Hë, hë, shkuan vite.
8. përd. lidh. krahin. Ose... ose, ja... ja. Hë e bëka, hë s'e bëka, ata nuk e be-sojnë më. Hë vjen, hë nuk vjen, ai duhet lajmëruar.
- HIÇ** pakuf. 2. si mb. ~E. Bosh. Gjë (punë) hiçe.
- HIDHUR** mb. 7. si em. f.~, ~A (e). Diçka që ka shije të pikët si të helmit, të pelinit etj.; shija që na jep ajo; hidhësirë. E hidhura e kastravecit. Nuk i ha fare të hidhurat.
- HIPNOTIK** mb. 4. si em. ~, ~U m.~Ë,~ËT. Bar (ilaç) që të vë në gjumë.
5. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Njeri i hipnotizuar, njeri që ndodhet në gjendje hipnoze.
- HITHËR** f. 3. përd. mb. Që të ngacmon e të shqetëson me fjalë, që të djeg me fjalë, piperkë.
- HOKATAR** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Plak hokatar. Grua hokatare. Me fjalë hokatare.
- HOMONIM** m. 2. përd. mb. libr. Që ka të njëjtin emër a titull me një tjetër. Drama homonime.
- HON** m. 4. përd. mb. I zbrazët, bosh. I mbeti barku hon.
- HORË** II f. bised. 4. përd. ndajf. Si zjarr, si flakë; me flakë të madhe. U dogj horë shtëpia. U ndez horë zjarri. U ndez horë fëmija. E kishte horë trupin.
- HOSHAF** m. 2. përd. mb. bised. I thatë e i fishkur (zakonisht në fytyrë). Iu bë fytyra hoshaf.
- HOVARDA** mb. bised. 2. si em. HOVAR/DA, ~DAI m. ~DHENJ, DHENJTË. Njeri zemërbardhë e dorëlëshuar. Hovarda i madh.
- HU** m. 3. përd. mb. fig. I trashë e i pagdhen-dur, budalla. Është hu (nga mendja).
- HUADHËNËS** m. 2. si mb. ~, ~E. Që i jep dikujt hua (zakonisht para). Vendi (shteti) huadhënës.
- HUALL** m. 2. përd. mb. Shumë i ëmbël, mjaltë. Ky rrush ishte huall.
- HUAMARRËS** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ka marrë hua prej dikujt (zakonisht para). Pala huamarrëse. Vendet huamarrëse.
- HUDHËR** f. 3. përd. ndajf. Shumë. Është hudhër i keq (i thartë, i egër).
- HULUMTUES** m. 2. përd. mb. Që ka të bëjë me hulumtimin, që i shërben hulumtimit të diçkaje, kërkimor. Puna hulumtuese.
- HULLI** f. 5. përd. mb. I zbrazët. Mbeti shtëpia hulli.
- HUNDOR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET gjuh. Zanore ose bashkëtingëllore hundore. Hundoret e shqipes.
- HUQ** ndajf. bised. 3. si em. ~, ~I m. Lëvizje bosh kur qëllojmë dikë a diçka. Çfarë huqi i doli kur gjuajti topin!
- HURBË** f. 2. përd. mb. Që është zier pak dhe mund të pihet, surbull. Vezë hurbë.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja i. I-ja e madhe (e vogël). I-ja e dorës (e shtypit). I-ja nistore (fundore). I-ja gojore (hundore).
- IKI** jokal. 13. përd. pasth. bised. Ashtu, vërtet, jo more! Ikë more! Ikë, se tallesh!
- IKONË** f. 2. përd. mb. bised. I zbehtë e i tretur në fytyrë, i ngrirë e pa gjallëri, i pajetë.
- INFEKTIV** mb. 2. si em. ~, ~f m. mjek. bised. Reparti i sëmundjeve ngjitëse në një spital. Të sëmurët (mjekët) e infektivit. U shtrua në infektiv. Punon në infektiv.
- INICIATOR** m. 2. si mb. ~, ~E. Nismëtar. Komiteti (vendi) iniciator.
- INSEKTEMBYTËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Insektevrasës.
- INTRIGANT** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit.  
J.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja j. J-ja e madhe (e vogël). J-ja e dorës
- JAHNI** f. gjell. 2. përd. mb. Që është gatuar në këtë mënyrë. Fasule (thjerrëza, bamje, presh) jahni.
- JANKI** m. përb. 2. përd. mb. Amerikan (si imperialist, pushtues e shfrytëzues). Agresorët janki. Imperializmi janki.
- JAR** m. 2. përd. mb. fig. Që është i shndritshëm a i kulluar si ari. Burime me ujë jar.
- JARGËMADH** mb. 2. si em. ~, ~I m. Plak i rrëgjuar.
- JASHTË** 6. përd. mb. Që ka dalë nga vendi i vet, që nuk është në vendin e vet; i zbuluar, i zhveshur. Me këmishë jashtë. Me xhepat jashtë. Me kokën (me këmbët, me barkun) jashtë.
- JESHIL** mb. bised. 2. si em. ~E, ~JA f. bised. Ngjyra e gjelbër. Jeshile e hapur (e çelur, e fortë, e thellë, e mbyllur). Veshur në jeshil.
3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET dhe ~I m. ~E, ~ET. Tërësia e bimëve të gjelbra, e barishteve të njoma etj.; vend me këto bimë a barishte, vend i gjelbëruar. Në jeshile të fshatit. E lëshoi (kalin) në jeshile. Ra në jeshil bagëtia.
- JETËKËPUTUR** mb. 2. si em. ~I euf. I vdekuri. Shkoi jetëkëputuri vdiq i shkreti djalë!
- JOFRYMOR** mb. 3. si em. ~ I m. kryes. sh ~E, ~ET. Send, gjë jo e gjallë. Klasa e jofrymorëve.  
K.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja k. K-ja e madhe (e vogël). K-ja e dorës
- KABA** mb. bised. 5. përd. ndajf. Pa gjykuar thellë, pa menduar shumë, pa i peshuar mirë fjalët; rëndë.
- KABA** f. muz. 3. si mb. I trashë, që i ngjet basit. Zë kaba.
- KACAGJEL** m. 3. përd. ndajf. mospërf. Si gjel, kacagjelthi. Rri (ecën) kacagjel.
- KAÇAKÇE** ndajf. bised. 3. përd. mb. I tillë siç e bënin a siç e mbanin kaçakët. Rroba (veshje) kaçakçe.
- KAÇE** f. bot. 4. përd. mb. Që ka ngjyrë të bardhë në të verdheme. Dele kaçë.
- KAÇI** f. 2. përd. ndajf. Duke e mbajtur në shpinë me duar për kofshësh, kaliboç.
- KAÇUBAN** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT zool. Çafkëlore.
- KADIFE** f. 2. përd. mb. Shumë i butë; i lëmuar e i ndritshëm, i kadifenjtë (zakonisht për pëlhurat, stofin e lëkurën).
- KAFE** f. 4. përd. mb. Që ka ngjyrë të errët si ajo e kokrrave të pjekura të kësaj shkurreje.
- KAFSHUAR** mb. 2. si em. ~, ~A (e) f. ~A. ~AT (të). Copë a pjesë sa mund të kafshojë njeriu njëherësh, kafshatë; vendi që është kafshuar. Tri të kafshuara e ka atë copë. Kishte dy të kafshuara në krah.



- KAIKE** f. 2. përd. mb. Që ka trajtë vezake ose është e cekët (për enët). Tavë (pjatë, tenxhere) kaике.
- KAKI** f. bot. 2. përd. mb. Që është midis ngjyrës së barit e të dheut, i verdhë i errët e pak në të kuq. Ngjyrë kaki. Stof kaki. Rroba kaki. Uniformë kaki. Kasë kë të kaki.
- KAKRRUK** m. 4. përd. ndajf. Si lëmsh, kruspull. Është mbledhur kakrruk.  
5. përd. ndajf. Pa gjë brenda, bosh. Mbeti kakrruk.
- KALAMA** m. bised. 3. përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit. Kalama njeri.
- KALIVARE** m. 5. përd. ndajf. Rrëkajë. Rrjedh (derdhet) kalivare.
- KALORE I** f. 2. përd. mb. fig. E hollë e truphedhur, e hajthme; që ngrefoset e kapardiset, që ecën me kokën përpjetë (për vajzat e gratë).
- KALORE II** f. 6. përd. mb. Qepje kalore: mënyrë qepjeje me zigzage duke e hedhur perin sipër buzëve të copës; qepje jo e kujdesshme; qepje e përkohshme me dorë, mbi të cilën shkohet një tegel me makinë.  
7. përd. ndajf. në vijë të drejtë, me zigzage; jo me kujdes; përkohësisht (kur qepin); kaluar. Qep kalore.
- KALTËR** mb. 2. si em. ~ËR, ~RA (e) f. Ngjyra e kaltër. E kaltër e mbyllur. Ngjyesh me të kaltër.
- KALTËRUAR** mb. 3. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të) euf. Kufomë trupi i të vdekurit, i vdekuri.  
4. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të) fig. Ai që pëson një fatkeqësi të madhe a që goditet nga një e keqe e madhe. I kaltëruari! i ziu, i shkreti, i mjeri! Ç'e gjeti, të kaltëruarin!
- KALTHEDËR** f. 2. përd. mb. fig. I dobët e i brishtë, thatim, shkarpë (nga trupi).
- KALUAR** mb. 5. si em. ~, ~I (i) m. kryes. ~, ~IT (të). Ai që ka filluar të plakët, ai që ka një moshë të thyer. Nderimi për të kaluarit (nga mosha).
- KALLAM** m. 8. përd. ndajf. fig. bised. Pa gjë, bosh përbrenda; pa një lek në xhep.
- KALLËP** m. 6. përd. ndajf. Ashtu siç është, në trajtën e vet; tamam siç duhet; pas trupit.  
7. përd. ndajf. keq. Ashtu siç duket nga jashtë a siç thuhet, pa u përpjekur t'i zbërthejë e t'i kuptojë gjërat, pa hyrë në brendinë e gjërave, jo në mënyrë krijuese, shabllon. Mos e zbato kallëp! I merr punët (gjërat) kallëp.
- KALLËZORE** mb. f. gjuh. 2. si em. KALLËZORE, ~JA f. Rasa kallëzore. Kallëzorja e shquar (e pashquar). Kallëzorja me parafjalë (pa parafjalë). Përdorimi i kallëzores. Emër në kallëzore.
- KAMBANË** f. 4. përd. mb. Që lëshon një tingëllim të fortë e me oshtimë, shumë i fuqishëm (për zërin e për mjetet tingëluese). E ka zërin kambanë.
- KAMËS** m. 2. si mb. ~, ~E. I pasur, i kamur. Shtresat kamëse të popullsisë. Klasat kamëse.
- KAMPION** m. 4. si mb. ~, ~E. Që ka zënë vendin e parë në kampionat a në një garë sportive.
- KANALGËRMUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kanalhapës.
- KANAT** m. 4. përd. ndajf. Krejt, plotësisht (për derën kur hapet). U hap dera kanat.
- KANDËRRNGRËNËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kafshë a bimë kandërrngrënëse; emërtim i përgjithshëm për atë rend të gjitarëve, ku hyjnë edhe iriqi, urithi, lakuriqi i natës etj., që ushqehen me kandrra.
- KAPICË** f. 3. përd. ndajf. Grumbull, njëri mbi tjetrin në mënyrë të çrregullt; plot e përplot. Vë kopicë. Ishin hedhur kopicë. Ishin mbushur kopicë. E ngarkoi kopicë.

- KAPPROÇ** m. 2. përd. mb. I shëndoshë, i fuqishëm dhe i shkathët. Djalë (burrë) kaproç.
- KARAVELE** f. vjet. 2. përd. mb. I lehtë, i kollajshëm. S'është karavele.
- KARDIAK** mb. mjek. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Njeri që vuan nga një sëmundje e zemrës.
- KARKACUL** mb. bised., keq. 3. përd. ndajf. Pa asnjë rrobë në trup, lakuriq. Mbeti karkacul.
- KARVAN** m. 4. përd. ndajf. Si varg, njëri pas tjetrit, në radhë për një. U radhitën karvan.
- KARRAPUC** m. 3. përd. ndajf. Si lëmsh, shuk; gërmuq, kruspull. Ishte mbledhur karrapuc.
- KASTRAVEC** m. bot. 3. përd. mb. fig. keq. I papjekur dhe pa përvojë në jetë; budalla. Ishte fare kastravec.
- KATAC** m. 2. përd. mb. I ngathët.
- KATALLAN** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ka trup shumë të madh, vigan. Burrë katallan. Grua katallane.
- KATANA** f. 2. përd. mb. Që ka trup tepër të madh e jo të lidhur mirë; që ka vëllim të madh, por pa mbështetje të shëndoshë. Burrë katana. Kalë katana. Shtëpi katana.
- KATËRFAQËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT gjeom. Trup gjeometrik, që ka katër faqe trekëndëshe.
- KATËRGRYKËSH** mb. usht. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Mitraloz i rëndë kundërror me katër gryka zjarri. Qitje me katërgrykëshin.
- KATËRKËMBËSH** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Emërtim për kafshë gjitare, që kanë katër këmbë (për t'i dalluar nga kafshët me më shumë këmbë).
- KATËRVARGËSH** mb. let. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Strofë e përbërë nga katër vargje të lidhura ndërmjet tyre me rimë të puthur, të kryqëzuar, të mbyllur etj.; katërshe.
- KATËRROKËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT let. Varg prej katër rrokjesh, me theks zakonisht në rrokjen e tretë.
- KATRAN** m. 3. përd. mb. bised. Që ka ngjyrë të zezë, shumë i zi, i zi sterrë. Me flakë katran.
4. përd. mb. bised. Shumë i fëlliqur, i nxirë nga të palarët. Me duart katran.
5. përd. mb. fig. keq., bised. Shumë i keq, zemërlig, shpirtkazmë. Njeri katran. Me zemrën katran.
6. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin «i zi, e zezë»). Katran i zi.
- KAUÇUK** m. 2. përd. mb. Që ka tiparet a vetitë e kësaj lënde.
- KEP** m. 5. përd. mb. fig. I zgjuar, i shkathët e thumbues. Djalë kep.
- KËLLIRË** f. 5. përd. mb. edhe fig. I papastër, i ndyrë; i turbullt (për ujin etj.). Këmishë këllirë. Ujë këllirë. Njeri këllirë. U bë këllirë.
- KËMBËÇALË** mb. 2. përd. ndajf. Duke ecur me një këmbë, duke u hedhur me një këmbë, hopthi; me njëren këmbë në tokë dhe me tjetrën të ngritur; këmbëcingthi. Luajmë këmbëçalë luajmë duke kërcyer me një këmbë dhe duke shtyrë me të një rrasë të vogël guri brenda disa katrorëve të vizatuar në tokë (lodër fëmijësh).
- KËMBËKIZË** mb. 2. përd. ndajf. Duke u hedhur me një këmbë, hopthi; këmbëçalë. Luajmë këmbëkizë luajmë këmbëçalë.
- KËMBËKUQ** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET zool. Thëllëzë.
3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET euf. Dhelpër.
- KËPUCËGRISUR** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~, ~IT keq., vjet. Spiun.
- KËRBIHTOR** mb. zool. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kafshë kërbishtore.
- KËRCE** f. 3. përd. mb. fig. I ngrirë; krejt i ri dhe i pastër, akull. I rrinë rrobat kërcë. E ka kostumin kërcë.

- KËRCU** m. 3. përd. mb. fig. keq. I trashë nga mendja, kokëtrashë, kokëgdhe; që rri i hutuar e si i ngrirë; që nuk lëviz nga vendi ku është ulur. Ishte (fare) kërcu.  
4. përd. mb. I vetmuar, pa njeri dhe pa ndihmë; i mjerë, i shkretë. Mbeti kërcu.
- KËRÇEP** m. 5. përd. mb. fig. keq. shih KËRCU, ~RI. E ka kokën kërcëp. Është kërcëp nga mendja është kokëtrashë, e ka kokën gdhe.
- KËRMËZ** m. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të kuqe të errët dhe të ndezur, që ka ngjyrën e trëndafilut të kuq të errët. Fustan (mëndafsh) kërmëz.
- KËRMILL** m. 3. përd. mb. Që është i përdredhur si spirale. Makarona kërmill.
- KËRNALLE** f. 2. përd. mb. Që nuk ka gjë brenda, bosh; i shkretë. Shtëpi kërnalle.
- KËRPIÇË** f. 2. përd. ndajf. Plot e përplot. Dhoma ishte kërpicë me njerëz.  
3. përd. ndajf. Njëri mbi tjetrin, si kapë, si mullar.
- KËRTHAZI** ndajf. 4. përd. parafj. Anës dikujt a diçkaje. Kërthazi shtëpisë.
- KËRTHI** m. 5. përd. mb. I porsalindur, i vogël, i parritur; fig. i papjekur. Qengj (kec) kërthi. Misër kërthi bimë misri e vogël, që nuk është zhvilluar sa duhet. I ka fëmijët kërthinj. Mbeti kërthi (nga mendja).
- KËSODORE** pakuf. 2. përd. ndajf. Në këtë mënyrë.
- KIAMET** m. bised. 4. përd. ndajf. Shumë, krejt. I ngjan kiamet.
- KOBAR** m. 2. përd. mb. Që ruan çastin të vjedhë ose të rrëmbejë diçka, që kobit, kobash
- KOBASH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. shih KOBAR, ~I 1.
- KOÇAN** m. 3. përd. mb. fig. I ngrirë nga të ftohtët. Me këmbë (me duar) koçan.
- KOKËPËRPJETË** mb. 2. përd. ndajf. Me hundën përpjetë, me mendjemadhësi; kacagjelthi. Rri (mbahet, flet) kokëpërpjetë.
- KOKËRDHAK** mb. 2. përd. ndajf. Sy ndër sy, faqeza; haptas, pa fshehur asgjë, copë. Ia tha (ia kallëzoi) kokërdhak.
- KOKËRDHOK** m. 2. përd. ndajf. Me kokrën e syrit jashtë; sa kokra e syrit. I hapi (i nxori) sytë kokërdhok.
- KOKORRETH** m. 3. përd. ndajf. Në trajtën e një rrotullameje, si rreth, kutullaç. Ishte mbledhur kokorreth. E lidhi shaminë kokorreth.  
KOKRRA-KOKRRA ndajf.  
2. përd. mb. Që ka shumë kokrra; që është ndarë në shumë pjesë të veçanta e pa lidhje njëra me tjetrën.
- KOKRRIZË** f. 4. përd. mb. Kokrrizor. Borë kokrrizë.
- KOKULUR** mb. 5. përd. ndajf. Pa bërë fjalë, duke u përqendruar në punën e vet. Punonte kokulur.
- KOLONIZUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kolonizator.
- KOMBËTAR** mb. 4. si em. ~E, ~JA f. Të qenët kombëtar, karakteri kombëtar, veçoria kombëtare. Kombëtarja në art (në letërsi).
- KOMIK** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. let., art. Veçori e botës emocionale që përshkon një vepër letrare ose artistike dhe që buron nga mospërputhja ndërmjet asaj që paraqitet dhe së vërtetës, ndërmjet fjalëve dhe veprave etj., duke krijuar pamje e situata qesharake. Tragjikja dhe komikja. Pasqyrimi i komikes në art.
- KOMUNAL** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. bised. Ndërmarrja e shërbimeve komunale. Komunalja e qytetit. Tekniku (inxhinieri) i komunales. Punëtorët e komunales.
- KONFORMIST** mb. libr. keq. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri konformist. Qëndrim prej konformisti.

- KONKRET** mb. 5. si em. ~E, ~JA f. Tërësia e sendeve dhe e dukurive konkrete, si edhe e vetive reale e të kapshme të tyre ose e lidhjeve të gjithanshme objektive ndërmjet tyre, realiteti objektiv; tërësia e dijeve të plota e të thella për sendet e dukuritë konkrete të jetës; ajo që është konkrete, diçka konkrete; kund. abstrakte. Nga konkretja tek abstraktja.
- KONTRABANDË** f. 2. përd. mb. Që është futur fshehurazi nëpër kufirin shtetëror, pa kaluar nëpër doganë, duke përdorur mënyra të jashtëligjshme; që shitet e blibet fshehurazi për t'i shpëtuar kontrollit shtetëror. Mall kontrabandë.
4. përd. ndajf. edhe fig. Në mënyrë të fshehtë e të jashtë ligjshme.
- KOPAN** m. 5. përd. ndajf. Kopanec. E lidhi fëmijën kopan.
- KOPANEC** m. 3. përd. ndajf. sipas kuptimit 1 të emrit. E lidhi (e mbështolli) fëmijën kopanec.
- KOPRRAC** m. 2. si mb. ~, ~E. Që kursen tej masës, dorështrënguar. Njeri koprrac.
- KORB** m. 4. përd. mb. I zi, i zi sterrë. I ka vetullat (qimet) korb.
5. përd. ndajf. Shumë (për ngjyrën e zezë). Me vetulla korb të zeza. I ka sytë (flokët) korb të zezë. Është bërë qielli korb i zi.
- KORBË** f. 3. si mb. f. E shkretë, e vetmuar e pa njeri. Kishte mbetur korbë.
- KORITH** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Rrush korith.
- KRAHASOR** mb. gjuh. 4. si em. ~E, ~JA f. Shkalla krahasore.
- KRAHOSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Burrë a djalë krahosh.
- KREDITOR** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me kredinë ose me kreditorin; që është kreditor; kund. debitor. Ndërmarrje kreditore.
- KREM** m. 4. përd. mb. Që ka ngjyrë të bardhë në të verdhë si ajka e qumështit. Këpucë (pallto, triko, fustan) krem.
- KRESHMOR** mb. fet. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Gjellë pa mish e pa bulmet, e gatuar për kreshmë vetëm me vaj, gjellë kreshmore.
- KRISTAL** m. 3. përd. mb. Shumë i pastër, shumë i kthjellët, fare i kulluar; shumë i shndritshëm; i kristaltë. Ujë kristal. Qielli ishte kristal. Me sytë kristal.
- KRISHTERË** mb. fet. 3. si em. KRISHTER/Ë, ~I (i) m. ~Ë, ~ËT(të). Pases a ithtar i krishterimit
- KRYEKËPUT** ndajf. 2. përd. pj. Krejt, fare. Kryekëput i ri. Kryekëput të ndryshme. Kryekëput i pavlefshëm.
- KRYQ** m. 4. përd. mb. Që është si kryq; i kryqëzuar. Rrugë kryq kryqëzim rrugësh, udhëkryq.
5. përd. ndajf. Në trajtë kryqi; tërthorazi, kryqaz. Vë kryq diçka i kryqëzoj.
- KSENOFOB** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit.
- KUACË** f. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Dele kuacë.
- KUCKË** f. 2. si mb. I ngushtë; që të shtrëngon (zakonisht për këpucët). Këpucë kucka.
- KUFKË** f. 2. përd. mb. edhe fig. I zbrazët, pa gjë brenda, bosh. Lajthi kufkë. E ka kokën kufkë.
- KUJDESTAR** m. 4. si mb. Që është ngarkuar të kujdeset në mënyrë të veçantë për sjelljen e mbarëvajtjen e nxënësve të një klase ose të studentëve të një grupi a të një kursi.
- KUJRI** f. hist. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Tokë kujri.
- KUKUDH** m. 4. përd. mb. I shkretë, i mjerë, fillikat i vetëm e pa njeri. Mbeti kukudh.
- KUKUVRIQ** m. 4. përd. ndajf. Kruspull, lëmsh. U mblodh kukuvriq.
- KULAÇ** m. 6. përd. ndajf. Me trup të mbështjellë rrumbullak, si lëmsh, kutullaç.

- KULAÇE** f. kryes. 3. përd. mb. Që e ka kokrën të rrumbullakët dhe palë të shtypur si kulaç (për disa pemë). Dardhë (mollë) kulaçe.
- KULAR** m. 8. përd. mb. I lakuar, i harkuar, i përkulur. E bëj kular. Vjen kular. I ka krahët (këmbët qafën) kular.  
9. përd. ndajf. Me kokë e këmbë bashkë, si lësh, kutullaç. U mblodh kular.
- KULIM** m. 2. si mb. ~, ~E. Rrugaç; dinak. Djalë kulim. Vajzë kulime.
- KULM** m. 5. përd. ndajf. Plot e përplot. Shtëpia u mbush kulm me njerëz.
- KULMOR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET gjeom. Vijë që zbret nga kulmi i një figure gjeometrike. Heq një kulmore.
- KULL** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Kalë kull.
- KULLOSHTËR** f. 2. përd. mb. I trashë e i lyrshëm (për qumështin etj.). Është fare kulloshtër.
- KUM** m. 2. përd. mb. Që është mbuluar me rërë, që ka rërë; ranor. Tokë (vend) kum.
- KUNGULL** m. 6. fig. përd. mb. sipas kuptimit 5 të emrit. Qenka kungull fare!
- KUNGULLAÇ** m. 4. fig. përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit. Qenka fare kungullaç!
- KUNGULLOR** mb. bot. 2. si em. ~E, ~ET kryes. familje bimësh që bëjnë kokrra të tilla.
- KUNJ** m. 5. përd. ndajf. thjeshtligj. Në këmbë, si qiri; pa lëvizur e si i shastisur (për njerëz). Rrinte kunj.
- KUR** 5. përd. pj. bised. Përdoret në fjalitë thirrmore, kur shprehin një ndjenjë të fortë, habi etj. Kur u bë dhe ai! Kur e pranuan edhe atë!
- KURSIV** mb. shtypshkr. 2. si em. ~, ~I m. kryes. ~E, ~ET. Shkronja shtypi të pjerrëta e të holla si ato të dorës; shkrim shtypi i pjerrët si ai i dorës. Shembujt janë bërë me kursive.
- KURRIZO** mb. 2. si em. ~, ~JA m. ~, ~T. Njeri me gungë në kurriz; njeri me kurriz të dalë.
- KUSUR** m. 5. përd. ndajf. E më shumë, e ca. Tridhjetë e kusur vjeç. Njëzet e kusur vjet më parë.
- KUSHEDI** ndajf. 2. përd. pj. Përdoret për të shprehur dyshim, mosbesim a pasiguri, me kuptimin «vallë, pse vallë, për çfarë arsye». Kushedi pse s'erdhi. Kushedi pse iku. Kushedi pse i mbeti qejfi. Kushedi si do të jetë.
- KYÇ** m. 4. përd. mb. Kryesor, më i rëndësishëm, i tillë, nga i cili varet zgjidhja e çështjeve të tjera. Problem kyç. Detyrë (çështje) kyç. Pikë kyç. Vende (pozita) kyç.
- L**  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja l. L-ja e madhe (e vogël).
- LACËR** f. 3. përd. mb. fig. Që është kockë e lëkurë, shumë i dobët. Lacër ishte bërë djali.
- LADUT** mb. bised. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Llupës, grykës, makut.
- LAGATERË** f. 4. përd. mb. I lagatershëm. Moti (mars, vjeshta) është lagaterë.  
5. përd. mb. fig. bised. Që është me dy faqe a me dy fytyra, shtiracak.
- LAGJIN** m. 4. përd. mb. Që ka ngjyrë shumë të kuqe, që është në të kuqe të ndezur. U bë lagjin në fytyrë.  
5. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin «i kuq»). Ishte lagjin i kuq.
- LAK** m. 11. përd. ndajf. Luajnë lak: një grup fëmijësh vrapojnë duke bërë dredha, ndërsa njëri i ndjek për të prekur dikë prej tyre.
- LAPIDAR** m. 2. përd. mb. fig. libr. I skalitur mirë, lakonik, por i lidhur mirë, i qartë e i bukur.
- LARË** f. 7. përd. mb. I larmë. Dhi (dele, lopë) larë.

- LARË** mb. 10. si em. LAR/Ë,~A (e) f. dhe LARË,~T (të) as. Larje me ujë e me sapun etj. e trupit a e një pjese të tij, e një rrobe pse e diçkaje tjetër, zakonisht duke e fërkuar. Një e larë vlen sa një e ngrënë. fj.u. E lara dhe e ngrëna shkojnë bashkë. fj.u.
11. si em. LARË,~A (e) f. dhe LARË,~T (të) as. Larja e një detyrimi, sasia e një huaje a e një detyrimi tjetër që duhet shlyer. Kishte edhe një të larë për të dhënë. S'kam të larë me të nuk lahem kurrë me të, nuk kam mundësi t'ia kthej kursesi të mirën që më ka bërë, nuk jam në gjendje t'i bëj një të mirë aq të madhe sa më ka bërë ai.
- LAROSH** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET shih LAR/Ë,~A.
- LASHTËRISHTE** mb. vet. f. 2. si em. LASHTËRISHT/E,~JA f. ~E, ~ET. Ndodhi e kohëve të lashta; këngë shumë e vjetër për ngjarje të kohëve të lashta. Kujtonin lashtërishtet.
- LAVAÇ** m. krahin. 2. përd. ndajf. Në trajtë rrethi, si lak, rumbullak. I ka brirët lavaç. E mbështolli kulmakun (zhukën) lavaç.
- LAVARE** f. 12. përd. ndajf. Në trajtë rrethi, si lak, rumbullak. U kthye (u bë) lavarë.
- LAVDI** f. 3. përd. pasth. Përdoret si thirrje për të shprehur mirënjohje e nderim të thellë dhe urime të zjarra. Lavdi popullit tonë heroik! Lavdi të përjetshme dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare!
- LECKA-LECKA** mb.
2. përd. ndajf. Në shumë lecka, copë-copë. E griu (e grisi, e bëri) lecka-lecka.
- LEQE-LEQE** mb.
2. si ndajf. Me shumë kthesa a dredha, me shumë leqe. Ecte leqe-leqe.
- LERË** I f. 7. përd. ndajf. Tërë, krejt (kur dikush a diçka fëlliqet shumë). U bë lerë me gjak.
- LESKRA-LESKRA** mb.
3. përd. ndajf. Në shumë leskra a petëza. I hiqej (i binte) lëkura leskra-leskra.
- LESHKO** f. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit.
- LESHPRERË** mb. 2. vjet. si em. LESHPRER/Ë,~A f.~A, ~AT. Leshkorre.
- LË** kal. 22. përd. pj. Përdoret në mënyrën urdhërore; kur flasim për diçka, të cilën nuk duam ta zëmë në gojë. Lere, ç'ka për të thënë me vonë! Lëre, lëre se ç'e ka gjetur!
- LËFYT** m. 3. përd. ndajf. Curril, çurg. I vajti gjaku lëfyt.
- LËKURË** f. 9. përd. mb. Shumë i dobët (për mishin). Mishi ishte lëkurë.
- LËKURËPUNUES** m. 3. përd. mb. sipas kuptimeve të emrit. Punëtorë lëkurëpunues.
- LËMË** m. 12. përd. ndajf. bised. Plot; grumbull. E gjeti të shtruar lëmë. U mbush vendi lëmë.
- LËMSH** m. 5. përd. ndajf. Në trajtë të rumbullakët, si top, shuk. E mblodhi sham-inë (peshqirin) lëmsh.
6. përd. ndajf. Menjëherë e pa jetë, si i vdekur, në vend, top. Ra lëmsh në tokë.
- LËMUQ** m. 2. përd. ndajf. Në trajtë rruzulli, si top, lëmsh shuk. E mblodhi shaminë lëmuq.
3. përd. ndajf. Njëri mbi tjetrin, grumbull mbi njëri-tjetrin. Ranë lëmuq.
4. përd. ndajf. Menjëherë e pa jetë, si i vdekur, në vend, top, lëmsh. Ra lëmuq në tokë (në shtrat). E la lëmuq përdhe e goditi dhe e la në vend të vdekur a pa ndjenja, e la top në vend.
- LËVOREBREJTËS** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kandërr a krimb që bren lëvoren e drurëve.
- LËVORENGRËNËS** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT zool. Lloj zhuzhaku që ha lëvoren e drurëve a të pemëve.
- LIG** mb. 12. si em. LIG,~U (i) m. bised. Djalli, i paudhi, qoftëlargu.

- LIGAVEC** m. 3. përd. mb. ~, ~E mospërf. Jargavec.
- LIK** m. 2. si ndajf. Rrafsh. E preu lik me dheun barin (misrin, grurin). U bë lik me tokën.  
4. përd. parafj. Rrëzë; afër. E korri grurin (misrin) lik tokës.
- LIKUIDATOR** m. libr. 3. përd. mb. sipas kuptimeve të emrit. Grup likuidator. Veprimtari likuidatore.
- LIMIT** m. libr. 2. si mb. ~, ~E. Që është brenda kufirit të caktuar ose të pranuar; që është në cakun më skajor, më të fundit. Çmimi limit. Vlefta limite. Pikë limite.
- LIMON** m. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të verdhë të çekur si ajo e limonit të pjekur. Ngjyrë limon. Fustan limon. Ka limon.  
3. përd. mb. Shumë i verdhë; shumë i thartë. U bë limon në fytyrë. Supa ishte limon.  
4. përd. ndajf. Shumë. Limon i verdhë. Limon i thartë.
- LINDËS** mb. 2. si em. f. ~E, ~JA f. sh ~E, ~ET. Nënë, mëmë. Lindësja e jetës.  
3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT vjet. Prind. Nuk i ka lindësit.
- LINDOR** mb. 5. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Banori i pjesës lindore të një vendi; banor i vendeve të Lindjes.
- LINDUR** mb. 4. si em. ~, ~I (i) m. ~IT (të). Fëmijë që ka dalë në jetë nga barku i nënës.
- LING** m 3. përd. ndajf. Me ngut, me nxitim; lingthi. E mori ling punën.
- LIRIK** mb. 3. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT let. Ai që krijon vepra lirike, poet lirik.  
4. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT muz. Këngëtar lirik.
- LIRIPRURËS** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Çlirimtar.
- LIRISHKELËS** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Shkelës i lirisë, shtypës, tiran.
- LIRISHTYPËS** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Shtypës i lirisë, tiran.
- LIRUAR** mb. 10. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që është liruar nga burgu; ai që është liruar nga shërbimi ushtarak etj. Emrat (lista) e të liruuarve.
- LIS** m. 4. përd. mb. Me trup të gjatë, të drejtë e të fuqishëm (për njerëzit). Ishte lis.
- LITAR** m. 4. përd. ndajf. Me pika të trasha, të dendura dhe pa ndërprerje, me rrëshekë.  
5. përd. ndajf. Shumë. Dita është litar e gjatë kur s'ke punë.
- LITROSH** m. bised. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Shishe që nxë një litër. Litroshja e rakisë.
- LOGJIK** mb. 4. si em. ~E, ~JA f. filoz. Pasqyrimi i sendeve e i dukurive nga pikëpamja e ligjeve të tyre të zhvillimit, e domosdoshmërisë së tyre historike. Logjikja e historikja.
- LOT** m. kryes. 5. përd. mb. Shumë i kthjellët. Koha (qielli) ishte lot.
- LUBRIFIKUES** mb. tek. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Vaj a lëndë tjetër e butë, që përdoret për lubrifikim. Lyej me lubrifikues.
- LUFTUES** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. shih LUFTËTAR, ~I.  
LUGË-LUGË ndajf.  
2. përd. mb. I ndarë copa-copa me lugë; me shumë gjurma lugësh. E ndau hallvën lugë-lugë. E bëri kaçamakun lugë-lugë.
- LUKS** m. 2. përd. ndajf. bised. Me sende, veshje e stoli tepër të shtrenjta, që bien në sy me shkëlqimin, madhështinë e bukurinë e tyre. Ishte veshur luks. E kishte pajisur shtëpinë luks.
- LUM** mb. 3. si em. ~E, JA (e) f. euf. Lia. I doli e lumja. E preu e lumja.
- LUMË** m. 4. përd. ndajf. Në sasi shumë të madhe e pa pushim, si lumë. U derdh vera (rakia) lumë pinë verë (raki) pa kufizim, pinë shumë e sa deshën (në një dasmë a gosti).

- LUZMË** f. 3. si ndajf. Grumbull. U mblohdhën luzmë.
- LYERËS** f. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që merret me lyerjen e diçkaje; ngjyrues; bojaxhi.
- LYM** m. 2. përd. mb. Që është krijuar nga grumbullimi i baltës së lumenjve a të përrenjve. Tokë (arë) lym.
- LL.
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja ll. LI-ja e madhe (e vogël).
- LLAJË** I f. 2. përd. mb. Që e ka qimen të zezë (për delet dhe lopët).
- LLAJUSH** m. 2. përd. mb. Që është krejt i zi (për dashin, për demin a për kaun).
- LLAPA** f. 3. përd. mb. I qullët e i trashë. U bë gjella llapa. U bënë llapa fasulet.
- LLAPADAN** mb. 2. si em. ~, ~I m. Fik llapadan.
- LLËRËPËRVESHUR** mb. 2. si ndajf. fig. Me vrull e pa u kursyer. Punonin llërëpërveshur.
- LLËRËZHVESUR** mb. 2. si ndajf. Llërëpërveshur.
- LLOÇ** m. 3. si mb. ~, ~E. I pjekur shumë, i s?qullët; i ndulkët. Dardhë (mollë) lloçe.
- LLOJ-LLOJ pakuf.
2. përd. mb. I ndryshëm; i çdollojshëm. Me ëndrra lloj-lloj.
- LLOKUM** m. 3. përd. mb. Shumë i butë; shumë i majmë. Tokën e kemi llokum. Mishi ishte llokum.
- LLOKUME** f. 3. përd. mb. Shumë i butë; shumë i majmë. Tokën e kemi llokum. Mishi ishte llokum.
- LLOME** f. 4. përd. mb. fig. Që është përgatitur nga të tjerët e që dikush e gjen të gatshme, i shtruar nga të tjerët. E gjeti llome e gjeti gati, e gjeti sofrën të shtruar.
- LLONXHË** I f. 2. përd. mb. fig. I mbushur plot, që ka të gjitha të mirat. Llonxhë e kishte shtëpinë.
3. përd. ndajf. fig. Me të ngrëna me të pira. Është mësuar llonxhë. Ia kaluan llonxhë.
- LLONXHË** III f. 4. përd. ndajf. fig. Pa rregull, rrëmujë, plot zhurmë. Shkoi puna llonxhë.
- LLULLAQ** m. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë blu të errët; i kaltëruar e i nxirë. Fustan llullaq.
- M.
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja m. M-ja e madhe (e vogël).
- MACE** f. 3. përd. mb. Shumë i dobët nga shëndeti, i thatë, thatim (zakonisht për gratë e vajzat). Është bërë mace fare.
- MADH** mb. 15. si em. ~E, ~JA (e) f. Diçka që është në shkallë të lartë; diçka që shfaqet me shumë forcë; gjë kryesore a e rëndësishme. Qeshi (thirri) me të madhe.
- MADHËRISHËM** mb. 3. si em. ~ME, ~MJA (e) f. vet. nj. filoz. Vetë e cilësi e sendeve a e dukurive të natyrës e të shoqërisë, që u përgjigjen në mënyrën më të plotë, në shkallën më të lartë ose me përmasa e me forcë të jashtëzakonshme idealeve tona shoqërore e estetike; të qenët i madhërishtëm. E madhërishtëmja dhe e bukura. E madhërishtëmja dhe heroikja.
- MADHËSHTOR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. Të qenët madhështor; diçka madhështore; madhështi. Madhështorja dhe heroikja. E zakonshmeja dhe madhështorja.
4. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT keq., vjet. Ai që mbahet më të madh, kryelarti. Qëndrim prej madhështori.
- MAGJIBËRËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Magjistar.
- MAJTIST** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ndjekës e përkrahës i majtizmit, oportunist i majtë.
- MAJUC** m. 2. si mb. ~, ~E. Që është me majë të mprehtë. Gjemb majuc.



- MAKSIMAL** mb. libr. 2. si em. ~E, ~JA f. Caku më i lartë i diçkaje, kufiri më i sipërm; kund. minimale. Maksimalja e të ardhurave. Nga maksimalja te minimalja.
- MAKSIMUM** m. libr. 4. përd. ndajf. Të shumtën; shumë-shumë (me fjalë që shënojnë sasi).
- MAKUT** mb. keq. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT dhe ~ËR, ~ËRIT. Grykës i madh; lakmitar i madh. Makut i madh.
- MAL** m. 6. përd. ndajf. Shumë. Mal i fortë.
- MALLKUAR** mb. 3. si em. ~I (i) m. euf. Djalli, shejtani.
- MASHALLA** pasth. bised. 2. përd. ndajf. Shumë mirë; shumë. Me shëndet ishte mashalla.
- MASHKULL** m. 6. përd. mb. I gjinisë mashkullore, mashkullor. Fëmijë mashkull. Qefull mashkull. Misër mashkull.
7. përd. mb. fig. Që hyn në diçka tjetër për t'u mbërthyer etj. Kopsë (sustë) mashkull. Çelës mashkull.
- MAVI** mb. bised. 2. si em. ~, ~A f. Ngjyra mavi. Mavi e hapur.
- MBIUJËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Mjet a diçka tjetër që lundron mbi ujë ose që vepron duke lundruar mbi ujë. Lundrimi i mbiujëseve.
- MBURRACAK** m. keq. 2. si mb. ~, ~E. Që mburret tepër.
- MBYLLTOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Bashkëtingëllore mbylltore. Mbylltore shpërthyesë. Mbylltore anësore. Mbylltore grykore (prapagjuhore, buzore).
- MEDET** pasth. bised. 2. si em. m. E keqe e madhe, fatkeqësi, mjerim, hata. Ç'është ky medet që i gjeti!
3. si em. ~, ~I m. Ndhimë, shpëtim; derman. I sëmuri kërkonte medet. Gjeti medet.
- MERINOS** m. 2. si mb. Që është i kësaj race. Dele merinos.
- MERMER** m. 3. si mb. fig. I ftohtë; i ngrirë. Me fytyrën (me ballin) mermer.
- MESËM** mb. 8. si em. ~ME, ~MJA (e) f. Mesatare.
- MESGJUHOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Bashkëtingëllore mesgjuhore.
- METALURGJIK** mb. 2. si em. ~, ~U m. bised. Kombinatat a uzinë ku prodhohen metalet e lidhjet e tyre dhe ku bëhet përpunimi i tyre. Metalurgjiku i Elbasanit. Punëtorët e metalurgjikut.
- MË** II përem. 4. përd. pj. Përdoret para foljeve për t'i dhënë më shumë gjallëri dhe shprehësi ligjëritimit. Më t'u ngrit në këmbë. Më ta bëri copë-copë. Më t'ia nisi këngës. Hë, më të lumtë!
- MËMË** f. 11. përd. mb. fig. Që luan rolin e femrës në kryqëzimin për të nxjerrë një lloj të ri. Bimë (farë, rrënjë) mëmë.
12. përd. mb. fig. Që është burimi a shkaku i diçkaje, zanafilla e një qenieje a e një dukurie, që na ushqen e na mban gjallë. Natyra mëmë. Toka mëmë.
13. përd. mb. fig. Që qëndron mbi të tjerat (nga vlera, nga rëndësia etj.); që është krijuar përpara të tjerave, që ka ndihmuar për krijimin e të tjerave, e parë, pas së cilës vijon të tjerat. Anija mëmë.
- MËNDAFSH** m. 3. përd. mb. fig. bised. Shumë i butë e i lëmuar. Me flokët mëndafsh. I kishte faqet mëndafsh.
- MËNGËGJATË** mb. 2. si em. MËNGËGJAT/Ë, ~I m. ~Ë, ~ËT tall. Prift.
- MËNGËPËRVESHUR** mb. 2. përd. ndajf. Duke i përveshur mëngët, me mëngë të përveshura. Punonin mëngëpërveshur. Doli mëngëpërveshur.
- MËSHIRËMADH** mb. lart. 2. si em. ~, ~I m. fet. vjet. Zoti.

- MI** pron. 2. si em. ~TË (të). Njerëzit e mi të afërt, me të cilët kam lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njerëz, të cilët i dua dhe të cilëve u besoj shumë. Erdhën (ikën) të mitë. Nuk ka asnjë nga të mitë.
- MIA** pron. 2. si em. ~T (të). Vajzat a gratë, me të cilat kam lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; shoqe a mike, të cilat i dua dhe të cilave u besoj shumë. Për të miat kujdesem unë.
- MIC** m. 2. përd. mb. I vogël nga shtati. Kalë mic.
- MILIARDER** m. 2. si mb. ~, ~E. Që zotëron pasuri me vlerë prej disa miliardësh. Shoqëri miliardere. Shtet miliardar.
- MILIONER** m. 2. si mb. ~, ~E. Që zotëron pasuri me vlerë prej disa milionësh.
- MINAHEQËS** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Anije minaheqëse.  
3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Specialist që heq minat në vendet e minuara.
- MINAKËRKUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat minakërkues.
- MINAMBAJTËS** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Anije minambajtëse.
- MINAMBJELLËS** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë minambjellëse.
- MINAMBLEDHËS** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Anije minambledhëse.
- MINAPASTRUES** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Anije minapastruese.
- MINAVËNËS** mb. usht. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Anije minavënëse.
- MINIMAL** mb. libr. 2. si em. ~E, ~JA f. Caku më i ulët i diçkaje, kufiri më i poshtëm; kund. maksimale. Minimalja e të ardhurave (e shpenzimeve). Minimalja absolute e temperaturës. Nga minimalja te maksimalja.
- MINIMUM** m. libr. 4. përd. ndajf. Të pak-tën; jo më pak se (me fjalë që shënojnë sasi). Kishte minimum treqind vetë.
- MINUS** m. 7. përd. lidh. Pa këtë, hiq edhe... pa. Shpenzimet minus mundimi.
- MISTREC** m. 3. si mb. ~, ~E. Shtatvogël e i pazhvilluar, i rrëgjuar e i dobët (zakonisht për kafshët e për bimët). Dem (dash, kalë) mistrec. Lopë (dele) mistrece. Gjel mistrec. Misër mistrec misër të cilit nuk i është rritur kokrra. Fëmijë mistrec.
- MISHMASH** m. 2. përd. ndajf. Lesh e li, rrëmuje. E bëri mishmash.
- MIZAMBYTËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. Bar a helm për të shfarosur mizat. Mizambytës i fuqishëm.
- MIZAVRASËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Përdorëse e përbërë nga një shkop që kanë majë një copë lëkurë të hollë a lastikë dhe që shërben për të vrarë miza.
- MIZËRI** f. përmb. 2. përd. ndajf. Shumë, plot; me shumicë. Erdhën mizëri. Kishte mizëri.
- MJALTË** m. 3. përd. mb. Shumë i ëmbël. Pjepri ishte mjaltë. Është pjekur rrushi e është bërë mjaltë.  
4. përd. ndajf. fig. Shumë mirë; pa halle e pa brenga, ëmbël. E shkon jetën mjaltë.  
5. përd. ndajf. Përdoret me mbiemrin «i ëmbël» për të treguar shkallën më të lartë të ëmbëlsirës së diçkaje (me kuptimin «shumë»). Ishte mjaltë i ëmbël.
- MJEDËR** f. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të kuqe të mbyllur, si kokrrat e pjekura të kësaj shkurreje. Ngjyrë mjedër.
- MOBILIZUAR** mb. 3. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të) usht. Ai që është thirrur nën armë pas shpalljes së mobilizimit, ai që është mobilizuar. Rreshtimi i të mobilizuarve.
- MODERNIST** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ithtar, pasues i modernizmit. Modernistët borgjezë.

- MOJ** pasth. bised. 2. përd. pj. Përdoret pranë një thirrori, të përfaqësuar nga një emër i gjinisë femërore, për të përforcuar shprehjen e thirrjes, të ndjenjës etj. a për t'u dhënë këtyre një ngjyrim afrie. Ah, moj kokë! Moj nënë! Si je, moj gjyshe? Moj shtëpi! Moj e mira! Moj e mjera!
- MOLLË** f. 3. përd. ndajf. Shumë, si molla (zakonisht me mbiemrin i kuq). Ishin mollë të kuqe.
- MOLLOK** m. 2. si mb. ~, ~E. Trupmadh, i bëshëm (për njerëzit); me vëllim të madh, me trup të madh (për sendet). Grua molloke.
- MORALIZUES** mb. keq. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. shih MORALIST, ~I 2. Moralizues i mërzitshëm (i thatë).
- MORE** pasth. bised. 2. përd. pj. Përdoret pranë një thirrori, të përfaqësuar nga një emër i gjinisë mashkullore, për të përforcuar shprehjen e thirrjes, të ndjenjës etj. a për t'u dhënë këtyre një ngjyrim afrie. Ah, more djalë! More shokë! Si je, more burrë? Si shkoni, more djem? Ç'thoni, more vëllezër? Ah, ti more i mjerë!
- MOSKURRË** 2. si em. MOSKURR/Ë, ~I m. Dita e moskurrit: një ditë që s'ka për të ardhur kurrë. E shtynë për ditën e moskurrit.
- MOTËR** f. 5. përd. mb. Që ka prejardhje të përbashkët me një tjetër dhe ngjan shumë me të, që bën pjesë në një familje a në një grup me të (zakonisht për gjuhët). Gjuhë motra.  
6. përd. mb. fig. Që është e lidhur ngushtë me një tjetër, që ka qëllime e interesa të përbashkëta dhe bashkëpunon ngushtë me të. Kooperativa motër. Fabrikat motra.
- MREKULLI** f. 3. përd. ndajf. bised. Shumë mirë, shumë bukur. Punon mrekuilli. Shpëtoi mrekuilli.
- MUFKË** mb. 6. si em. MUFK/Ë, ~A f. ~A, ~AT keq. Fjalë, punë etj. që nuk është menduar mirë, diçka e pa pjekur. Ç'janë këto mufka që thua (që bën)!
- MUNDEM** I vetv. 4. vet. veta III përd. pj. Ndoshta. - Kështu ka ndodhur? - Mundet.
- MUNDSHËM** mb. 3. si em. ~ME, ~MJA (e) f. Diçka që mund të bëhet, e mundura. Bëri të mundshmen dhe të pamundshmen bëri përpjekje të jashtëzakonshme, bën gjithçka që mund të bëhej.
- MURG** m. 3. përd. mb. fig. (zakon. përpara emrit) bised. I mjerë, i shkretë, i zi. Murgu baba! Murgu plak! Murgu ai! E pësoi murgu djalë!
- MUSAKA** f. gjell. 2. përd. mb. Që gatuhet zakonisht me mish të grirë, me qepë, me erëza e me vezë dhe që piqet në furrë. Patate (kungulleshka, patëllxhanë) musaka.
- MYS** m. 3. si mb. I mysët. Kapele mys. Është mys.
- MYSHK** II m. 3. përd. mb. Që ka erë të mirë. Rrush (kumbulla) myshk. Sapun myshk. N.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja n. N-ja nistore. N-ja e madhe (e vogël). N-ja e shtypit (e dorës).
- NATË** f. 5. përd. mb. Shumë i errët; i ngrysur, i nxirë. U bë natë në fytyrë.
- NDONJË** pakuf. 2. përd. pj. Afro, gati, pothuajse. Kam ndonjë orë që po pres. Ndonjë kilometër larg.
- NDRYSHË** ndajf. 2. përd. lidh. Në rastin e kundërt, përndryshe. Shpejto, ndryshe do të vonohesh! Thuaj të vërtetën, ndryshe nuk të del mirë! Ndrequ, ndryshe do ta pësosh!
- NEVOJTAR** mb. 3. si em. ~, ~ I m. ~ Ë, ~ËT. I varfër; ai që ka nevojë për diçka, që ka një nevojë të paplotësuar. Ndihmuan nevojtarët.
- NËNTËDHJETË** num. rresht. 4. si em. f. vet. ~ AT (të). Periudhë prej nëntëdhjetë vjetësh si moshë. I mbushi të nëntëdhjetat.

- NËNTËRROKËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A ~AT let. Varg që ka nëntë rrokje. Nëntërrokëshat e një vjershe.
- NËNUJËS** mb. 3. si em. ~, ~I m. sh, ~, ~IT usht. Detar i reparteve të flotës ushtarake, i pajisur me mjete të posaçme për të qëndruar dhe për të vepruar nën ujë. Kursi i nënujësve.
- NGADALË** ndajf. 3. përd. pasth. Përdoret për t'i prerë hovin ose për t'i tërhequr vëmendjen dikujt që ecën, që bën një punë a që flet. Më ngadalë, ju lutem!
- NGUSHËLLIMTAR** mb. lart. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ai që iu sjell ngushëllim të tjerëve; ai që shkon për ngushëllim te një tjetër, ngushëllues.
- NGUSHËLLUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që i sjell ngushëllim një tjetri.
- NISHAN** m. bised. 7. përd. mb. Që shquhet për bukuri, për sjellje të mirë, për zgjuarsit etj.; i shquar. Është një djalë (vajzë) nishan. Nishan ndër shokë (shoqe).
- NJ** 2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja nj. Nj-ja e madhe (e vogël).
- NJERINGRËNËS** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ha mish njeriu, që ha njerëz (për njerëzit dhe për kafshët).
- NJË** 2. përd. mb. Po ai, po ajo gjë, i njëjtë. Thotë gjithnjë një fjalë. Rri në një vend. Arritën në një kohë. Janë në një klasë. Banojnë në një lagje. Janë në një moshë. Jemi në një mendje. Ligji është një për të gjithë. Flasin një gjuhë. Kanë një ideal. Luftojnë për një qëllim. Këto rrugë në një qafë dalin.
3. përd. mb. I vetëm, i tërë e i pandashëm; i bashkuar në diçka të vetme. Janë bërë një trup. Dy fshatra u bënë një. Vullnetarët u bënë një me kooperativistët. U bashkuan e u bënë një kooperativë.
3. përd. mb. I tillë (si kallëzues emëror, i ndjekur nga një fjali rrjedhimore). Është një që s'e ka shokun. Është një që s'bëhet dy është i tillë, që s'gjen të dytë si ai.
4. përd. pj. Përdoret para emrit të një frymori ose të një sendi kur folësi shpreh një farë habie, admirim a përçim. Kishte një kalë të shpejtë, që s'e kishte askush. Është një dhelpër ai, që s'e ka shokun.
- NJËBRIRËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. mit. Kafshë me një bri.
- NJËDYNAMËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. Ngastër toke që i lihet në fshat një familjeje kooperativiste si truall për përdorim vetjak.
- NJËFARË** pakuf. 3. përd. pj. Përdoret para një emri që shënon një njeri, kur e përmendim për ta cilësuar me përçmim a me përbuzje; një. Është njëfarë gënjeshtari (rugaçi, matrapazi) ai, që s'e ka shokun.
- NJËJËS** mb. gjuh. 2. si em. ~, ~I m. Numri njëjës. Njëjësi i shquar (i pashquar). Mbaresat e njëjësit.
- NJËLEKËSH** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Monedhë ose kartëmonedhë me vlerë një lek.
- NJËMBËDHJETËRROKËSH** mb. let. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Varg që ka njëmbëdhjetë rrokje. Mjeshtëri i njëmbëdhjetërrokëshit. Përdorimi i njëmbëdhjetërrokëshit.
- NJËMIJËLEKËSH** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Kartëmonedhë që e ka vlerën një mijë lekë, mijëshe. I dha dy njëmijëlekëshe. Theu (shkoqi) njëmijëlekëshen.
- NJËQELIZOR** mb. biol. 2. si em. ~I m. zakon. ~Ë, ~ËT. Tërësia e kafshëve ose bimëve që përbëhen vetëm nga një qelizë. Shumëzimi i njëqelizorëve.
- NJËQINDLEKËSH** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Kartëmonedhë me vlerë njëqind lekë, qindëshe. Katër njëqindlekëshe. Nxori një njëqindlekëshe.

- NJËQINDTË** num. rresht. 5. si em. f., vet. ~AT (të). Periudhë prej njëqind vjetësh si moshë. I mbushi (i ka kaluar) të njëqindtat.
- NJËQINDVJEÇAR** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Periudhë prej njëqind vjetësh, qindvjeçar, shekull.
- NJËSHE** mb. 2. si em. NJËSH/E, ~JA f. ~E, ~ET. Enë që nxë një njësi; dhomë me një shtrat për një njeri; këngë në një zë. E bëri kafën në njëshe. Njëshet janë zënë. Ia mori një njësheje.
- NJËTHELBOR** mb. bot. 2. si em. ~E, ~JA f. zakon. ~E, ~ET. Klasë bimësh, që i kanë farat me një thelb; bimë që bën pjesë në këtë klasë.
- NJËTHUNDRAK** mb. zool. 2. si em. ~, ~U m. zakon. ~Ë, ~ËT. Familje kafshësh, ku hyjnë kali, gomari, mushka e zebra, që kanë në secilën këmbë vetëm një thundër. Rritja e njëthundrakëve. Shtimi i njëthundrakëve.
- NJËZETDITOR** mb. 2. si em. ~, ~I m. Njëzet ditët e para të çdo muaji. Plani i njëzetditorit.
- NJËZETË** num. rresht. 4. si em. f. vet. ~AT (të). Periudha prej njëzet vjetësh si moshë. I mbushi të njëzetat.
- NJËZETQINDARKËSH** mb. 3. si em. ~E, JA f. ~E, ~ET bised. Monedhë me vlerë njëzet qindarka.
- NJËZETVJEÇAR** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Periudhë prej njëzet vjetësh. Njëzetvjeçari i parë i këtij shekulli. Njëzetvjeçari 1950-1970.
- NJOMËS** mb. spec. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Vegël njomëse.
- O I**  
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja o. O-ja e madhe (e vogël). O-ja e shtypit
- OBJEKTIV** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. filoz. Bota e jashtme, që ekziston jashtë ndërgjegjes dhe pavarësisht prej saj, ajo që nuk varet nga ndërgjegjja dhe që është parësore kundrejt saj; ajo që është objektive. Objektivja dhe subjektivja.
- OKAR** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. shih OKJE, ~A 2.
- OKUPATOR** m. 2. përd. mb. shih PUSHTUES, ~E. Ushtri okupatore. Shtet okupator.
- OPERATIV** mb. 7. si em. ~I m. ~Ë, ~ËT bised. Punëtori ose oficeri operativ. Operativi i repartit. Operativi degës së Punëve të Brendshme. Operativi i zonës.
- OPTIMIST** m. 2. si mb. ~, ~ E. Që është plot optimizëm, që është karakteristik për optimizmin e për optimistin që është plot gjallëri e gëzim. Njeri optimist. Qëndrim optimist.
- ORËBARDHË** mb. 2. si em. ORËBARDH/Ë, ~A f. ~A, ~AT mit. Ora e bardhë.
- OXHAK** m. 7. përd. ndajf. Në sasi të madhe, fjollë, si oxhaku. I shkonte tymi oxhak.  
P  
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja p. P-ja e vogël (e madhe).
- PA** III lidh. bised. 8. si em. ~, ~ JA f., ~, ~TË mat. Shenja e zbritjes (-); minus; kund. edhe. Vëri panë!
- PABESË** mb. 8. si em. ~, ~T (të) as. Pabesi. Ia bëri me të pabesë.
- PABËRË** mb. 2. si em. PABËRË, ~A (e) f. ~A, ~AT (të) bised. Diçka që nuk ka ndodhur ose që nuk ta merr mendja se mund të ndodhë, që nuk është bërë a nuk është parë e dëgjuar ndonjëherë; vepër a sjellje e keqe që nuk pajtohet me normat e moralit dhe me kërkesat e me rregullat e shoqërisë, që nuk duhet bërë. Të bëra e të pabëra. Bënte të pabëra. Ia numëruan të gjitha të pabërat.
- PADREJTË** mb. 4. si em. PADREJT/Ë, ~A (e) f. Diçka e padrejtë; padrejtësi. U soll me të padrejtë. Të dallohet e drejta nga e padrejta.
- PAFTË** f. 5. përd. mb. Që ka trajtën e një petle. Sheqer paftë.

- PAKTA** f. 2. përd. ndajf. bised. Jo më pak se..., të paktën. E pakta njëzet metra. E pakta disa ditë. E pakta deri në Durrës. PALA-PALA ndajf.
2. përd. mb. Që ka shumë pala. Fustanellë pala-pala. Qafë pala-pala.
- PALAPETË** f. 2. përd. mb. I rrafshët e i shtypur si petë, rrasik, petashuq. Gur palapetë. Shishe palapetë.
- PALCË** f. 7. përd. mb. Shumë i njomë e i butë (për bimët, perimet); i paarrirë, i papjekur (për disa fruta); ushtër. Gjetthet e qepës ishin palcë.
8. përd. mb. fig. Që është ende i paritur, që e ka trupin ende të njomë (për njerëzit).
9. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrat i njomë, i butë). Është palcë i njomë (i butë).
- PALË** I f. 6. përd. ndajf. Më dysh a më trish; njëri mbi tjetrin, palë-palë, stive. E bëj palë e palos. Vë palë dy thekët (jorganët). Mbledh palë.
- PALË-PALË I ndajf.
2. përd. mb. Që ka shumë pala njëën pas tjetrës a që ka disa shtresa a palë njëën mbi tjetrën. Fustan palë-palë fustan me pala. Dhjamë palë-palë.
- PAMBUK** m. 3. përd. mb. Shumë i butë. Me duar (me llërë) pambuk.
4. përd. mb. fig. Shumë i urtë e i butë, që nuk e ngre zërin për asgjë (për njeriun); i butë e i ëmbël (për zërin, për fjalët). Është pambuk. E ka zërin pambuk.
- PAMBUKTË** mb. 2. si em. PAMBUKTË, ~A (e) f. kryes. ~A, ~AT (të). Stof a pëlhurë pambuku; rrobë e bërë me stof a pëlhurë pambuku. Reparti i të pambuktave. Larja e të pambuktave. Mban të pambukta.
- PAMUNDSHËM** mb. 3. si em. ~ME, ~MJA (e) f. E pamundura.
- PANGJARË** mb. 2. si em. PANGJAR/Ë, ~A (e) f. kryes. ~A, ~AT (të). Diçka e paparë a e padëgjuar, e pabërë. U ndodhi një e pangjarë.
- PANTOMIMË** f. 3. përd. mb. Që shprehet a që shoqërohet vetëm me lëvizje të trupit dhe me mimikë. Valle pantomimë. Lëvizje pantomimë.
- PAPASTËR** mb. 9. si em. PAPAST/ËR, ~RA (e) f. Fletë në të cilën është shkruar diçka në dorë të parë dhe me gabime e ndreqje. E dorëzoi në të papastër. E kishte në të papastër.
- PAPJEKUR** mb. 5. si em. ~, A (e) f. zakon. ~A, ~AT (të). Fjalë të pamenduara dhe të papeshuara mirë. Thoshte të pjekura e të papjekura.
- PAQENË** mb. 2. si em. PAQEN/Ë, ~A (e) f. kryes. A, AT (të). Diçka e trilluar, ndodhi a gjë e shpikur nga mendja. Ka shpifur të paqena. Thoshte të qena e të paqena.
3. si em. PAQEN/Ë, ~I (i) m. bised. euf. Djalli, qoftëlargu, i papjesi.
- PARAGJUHOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Tingull paragjuhor. Paragjuhoret t, d, c etj.
- PARALAJMËRUES** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Paralajmëtar. Paralajmëruesi i furtunës.
- PARALEL** mb. 6. si ndajf. Paralelisht. Punojnë paralel. I bën dy punë paralel. Ecin (shkojnë) paralel.
- PARALITIK** mb. 4. si em. ~, ~U m. ~Ë ~ËT mjek. Ai që është goditur nga paraliza, ai që është paralizuar pjesërisht a tërësisht. Paralitikut kanë nevojë për shumë shërbime.
- PARAZIT** m. 3. si mb. ~, ~E. Që jeton si parazit; që përbëhet prej parazitësh (edhe fig. keq.). Krimba parazitë. Kërpudha parazite. Njeri parazit. Klikë parazite.
- PASNESËRM** mb. 2. si em. ~E, ~JA (e) f. Dita që vjen menjëherë pas së nesërme. Të pasnesërmen në mbrëmje.

- PASQYRË** f. 5. përd. mb. Shumë i pastër e shumë i ndritshëm. U bë pasqyrë. E kishte dyshtemenë pasqyrë. I bëri këpucët pasqyrë.  
6. përd. ndajf. Shumë (me mbiemra si i pastër, i ndritshëm, i shkëlqyer etj.).
- PASTËR** mb. 16. si em. PAST/ËR, ~RA (e) f. Fletë e bardhë, në të cilën është shkruar përfundimisht diçka pa gabime e pa ndreqje. E hedh në të pastër.
- PASH** m. 2. si mb. Not pash sport: stil notimi duke shtrirë përpara herë njërin krah e herë tjetrin e duke lëvizur këmbët.
- PAT** ndajf. 3. si em. ~, ~I m. shah. Gjendja kur mbreti në lojën e shahut nuk ka ku të bëjë lëvizjen e radhës dhe loja përfundon me barazim. Në pozicion pati.
- PATËLLXHANËS** mb. vet. m. 2. si em. ~, ~ m. ~, IT. Fik patëllxhanës. Patëllxhanësit piqen në shtator.
- PATOGJEN** mb. mjek. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Bakter a mikrob që shkakton sëmundje.
- PEDAGOGJIK** mb. 3. si em. PEDAGOGJIK/E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Shkollë e mesme pedagogjike. Mbaroi pedagogjiken.
- PEDANT** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ka tipare pedanti; që karakterizon një njeri të tillë. Njeri pedant. Mësues (nëpunës) pedant. Sjellje pedante.
- PEDIATËR** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Mjek pediatër.
- PEGELË** f. 2. përd. mb. I dobët, i hequr shumë në fytyrë, i ligur. Fëmijë pegelë.
- PELIN** m. 3. përd. mb. Shumë i hidhur, helm (edhe fig.). E kam gojën pelin. I kishte fjalët pelin.  
4. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin «i hidhur»). Pelin i hidhur (i hidhur pelin).
- PENDË** I f. 5. përd. mb. Shumë i lehtë. Ishte pendë.  
6. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin «i lehtë»). Pendë i lehtë (i lehtë pendë).
- PERGAMENË** f. 3. përd. mb. Që është e trashë dhe e marrët si pergamenë dhe që nuk përshkohet nga uji etj. (për një lloj letre). Mbështjellë me letër pergamenë.
- PERIODIK** mb. 3. si em. vet. nj.~, ~ U. bised. Shtypi periodik.
- PERONË** f. bised. 2. përd. mb. Shumë i ftohtë (për ujin). Më thau duart ky ujë, qenka peronë.
- PESËDITOR** mb. 2. si em. m. Periudha kohe prej pesa ditësh. Plani i pesëditorit. Në fund të çdo pesëditori.
- PESËDHJETË** numr. rresht. 4. si em. f. vet. PESËDHJETAT (të). Periudhë prej pesëdhjetë vjetësh në jetën e njeriut. I mbushi të pesëdhjetat.
- PESËLEKËSH** mb. 3. si em. ~E,~ JA f. ~E, ~ET bised. Kartëmonedhë me vlerë pesë lekë. I dha dy pesëlekëshe.
- PESËVARGËSH** mb. 2. si em. ~,~I m. ~AT. Strofë me pesë vargje.
- PESIMIST** m. 2. si mb. ~, ~E. Që është gjithë pesimizëm, që është karakteristik për pesimistin; që është i mbushur me mërzë e me parandjenja të këqija, që e sheh çdo gjë me pesimizëm; kund. optimist. Njeri pesimist. Qëndrim pesimist. Parashikime pesimiste. Ishte shumë pesimist për të ardhmen.
- PESTIL** m. 2. përd. mb. fig. I hollë në trup, i dobësuar e i tretur; i, shtypur si petë. Ishte bërë pestil.  
PETË-PETË ndajf.  
2. përd. mb. I ndarë në shtresa të holla njëra mbi tjetrën. Bakllava petë-petë.
- PETULLICË** f. 3. përd. mb. Që është si petull, petullak. Enë petullicë. Bukë petullicë.
- PËR** 22. si ndajf. Në anën e dikujt a të diçkaje, në të mirë të dikujt, pro; kund. kundër. Votuan për 98
- PËRDREDHËS** mb. bot. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Lastar i hollë te disa bimë, që kapet e dridhet pas bimëve të tjera, dredhe, dredhkë.

- PËRDHES** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Shtëpi përdhese; dhomë përdhese. Banonte në një përdhese. Shkuan nga përdhese në shtëpitë me shumë kate.
- PËRFTUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, IT. Lëndë, send, mjet a organ që krijon a prodhon diçka të re. Përfutues energjie. fiz.
- PËRGATITOR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET vjet. Shkollë përgatitore.
- PËRHIMË** mb. 2. si em. ~E, ~JA (e) f. folk. Hirushe, e përhitura.
- PËRHITUR** mb. 3. si em. ~, ~A. (e) f. folk. Hirushe.
- PËRJASHTA** 2. përd. pasth. Largohu! Dil jashtë! Përyashta, të thashë!
- PËRMBYSËS** m. 3. si mb. ~, ~E. Që bëhet a që shërben për të përmbysur diçka.
- PËRPARA** 10. përd. mb. I përparmë. Ndodhet në pjesën (në radhën) përpara.
11. përd. pasth. Përdoret si thirrje për të nxitur dikë që të hidhet në sulm, të ndërmarrë diçka a të kapërcejë një pengesë me përpjekje e me guxim etj. Përpara partizanë! Përpara për fitore të reja!
- PËRPARIMTAR** mb. 3. si em. ~E, ~JA. Diçka që lidhet me përparimin politik, shoqëror e ekonomik të shoqërisë, diçka që përpiqet dhe lufton për zhvillimin e mëtejshëm të vendit e të popullit.
- PËRPIRËS** m. 4. si mb. ~, ~E. Që të push-ton plotësisht, që të thith tërësisht, që të përpin; që shpreh një ndjenjë të fuqishme dëshire, lakmie etj. Një ankth përpirës. Shikim (vështtrim) përpirës.
- PËRQESHËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që përqesh a që e ka zakon të përqeshë të tjerët. Përqeshës i padurueshëm.
- PËRSE** ndajf. 2. përd. lidh. Përdoret përpara fjalive të varura kryefjalore ose kundri-nore me nuancë shkaku. Nuk e di përse u gëzua (përse u zemërua). Ata kishin përse të krenoheshin (të qëndronin bal-lëlart).
3. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË. Shkaku, arsyeja, pse. Kërkonte (gjeti) përshenë.
- PËRTROLLËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. euf. Gjarpri, tokësi.
- PIKA-PIKA** ndajf.
2. përd. mb. Që është me pika, që ka pika; i mbushur me pika në fytyrë e në trup; pikalosh. Shami pika-pika. Faqe pika-pika. Gjarpër pika-pika.
- PIKË** f. 26. përd. ndajf. bised. Shumë mirë, për bukuri; tamam pas trupit (për rro-bat) ose pas këmbës (për këpucët). Ishte veshur pikë. Jemi pikë. Ia çojmë pikë. E ka punën
27. përd. ndajf. bised. Përdoret kur flasim për të shprehur një mendim a vendim të prerë, që nuk duam ta diskuto-jmë më. Nuk vij dhe pikë. Nuk dua dhe pikë.
- PILË** I f. 7. përd. ndajf. Njëra mbi tjetrën, në dy shkallë (për arrat kur luajnë fëmijët); njëri mbi tjetrin. Pilë më pilë njëri mbi tjetrin dhe pa rregull. I vuri arrat pilë.
- PISË** f. 3. përd. mb. I zi, shumë i zi.
4. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin i zi, e zezë). Pisë i zi (e zezë).
- PITËR** f. krahin. 2. përd. ndajf. Plot e përplot, mbushur. Ishte vendi pitër me njerëz.
- PIZGË** f. 3. përd. mb. I ngjashëm me tingujt që nxjerr fyelli a bilbili prej kallami ose prej lëkurës së shelgut të njomë; i hollë e i mprehtë. E ka zërin pizgë.
4. përd. ndajf. Si curril. I shkote (i dilte) gjaku pizgë.
- PJERGULL** f. 2. përd. mb. fig. E hajthme dhe e bukur (zakonisht për një vajzë ose nuse).
3. përd. ndajf. fig. Plot, mbushur. Erdhi vajza pjergull me lule.



- PJESËTUESHËM** mb. 2. si em. ~ËM, ~MI (i) m. ~ËM, ~MIT (të) mat. Numri që ndahet në pjesë të barabarta me një numër tjetër, numri që pjesëtohet. I pjesëtueshmi dhe pjesëtuesi.
- PJESSHËM** mb. 2. si em. f. ~ME, ~MJA (e) filoz. Secili nga sendet ose elementet, secila nga anët ose dukuritë që përbëjnë një të tërë të pandarë; pjesë; e veçantë. Nga e pjesshmja tek e përgjithshmja.
- PLAGË** f. 5. përd. mb. I plagosur, me plagë; si plagë. E ka kurrizin plagë. I kishte këmbët plagë, ia bëri trupin plagë.
- PLAKAREC** mb. mospërf. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Plak me trup të imët, i fishkur e i shëmtuar nga pleqëria.
- PLANDËR** f. 2. përd. mb. I rëndë. Barrë plandër. Shqyt plandër.
- PLEH** m. 5. përd. mb. I vrarë, i dërrmuar; shumë i lodhur. I kam shpatullat pleh. Iu bë këmba pleh. U bënë pleh nga rruga.
6. përd. ndajf. Shumë (me disa mbiemra). Pleh i zi (i zi pleh). Pleh i rëndë (i rëndë pleh).
- PLENG** I m. 2. përd. ndajf. Si plumb. Më ra buka pleng në bark.
- PLEP** m. 2. përd. mb. Që ka trup të drejtë, të hajthëm e të gjatë (për njerëzit). Ishte nusja plep.
- PLËNDËS** m. 5. përd. ndajf. bised. Menjëherë dhe pa lëvizur; top në vend, vdekur. Ra plëndës në tokë.
- PLIM** m. krahin. 2. përd. ndajf. Në tufë; varg. Vinin zogjtë plim.
- PLIS** I m. 2. përd. ndajf. Si plëndës, pa lëvizur; si lëmsh, shuk. Ra plis në tokë. Më ra buka plis në stomak më ra buka si gur në stomak e më rëndoi shumë. Mbeti plis përdhe.
3. përd. ndajf. Plot, mizë. U mbush sheshi plis me nxënës.
4. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin i rëndë). Ishte plis i rëndë (i rëndë plis).
- PLOT** ndajf. 8. përd. pj. Pikërisht, tamam. Plot dy orë. U mbush plot një vit. Qëndroi plot një muaj. E them me plot të drejtë. Plot në orën nëntë.
- PLOTFUQISHËM** mb. 2. si em. ~ËM, ~MI (i) m. ~ËM, ~MIT (të). Punëtor i policisë sonë popullore në një sektor, lagje etj. I plotfuqishmi i policisë. I plotfuqishmi i zonës (i krahinës, i rajonit, i qytetit, i lagjes).
- PLOTOR** mb. vjet. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Shkollë që kishte gjashtë klasa.
- PLOTPJESËTUESHËM** mb. mat. 2. si em. ~ËM, ~MI (i) m. Numri që pjesëtohet nga një tjetër pa lënë mbetje, numër që plotpjesëtohet.
- PLUHUR** m. 5. përd. mb. Që është në trajtë mielli a hiri, i thërrmuar. Qumësht pluhur. Sheqer (kafe, piper) pluhur. Bar (ilaç) pluhur. Qymyrguri pluhur. Barut pluhur. Pleh pluhur.
- PLUMB** m. 8. përd. mb. Që ka ngjyrën e këtij metali, në ngjyrë të hirit. Toka plumb e qielli flakë.
9. përd. mb. edhe fig. Shumë i rëndë. U bë plumb diçka u rëndua shumë. E ka dorën plumb. I kam qepallat plumb nga pagjumësia. E kam kokën plumb e kam kokën shumë të rëndë, më dhemb koka shumë. E ka fjalën plumb e ka fjalën shumë të rëndë; të vret me fjalë.
10. përd. ndajf. edhe fig. Shumë, si plumb (me mbiemrin i rëndë ose me foljen rëndon etj.). Është plumb i rëndë. Gjumë i rëndë plumb. Çaste të rënda plumb.
11. përd. ndajf. Shumë shpejt, ashtu siç ikën plumbi shigjeta, si vetëtima, fluturimthi. Iu sul plumb. Fluturoi plumb.
- PLUS** m. 7. përd. mb. Që është si shtesë mbi diçka të parashikuar; tjetër. Shpenzime plus.
8. përd. lidh. Përveç kësaj, edhe ..., si edhe ... Shpenzimet plus mundimi. Puna brenda tetorëshit plus puna shoqërore.

- PLLAKAT** m. 2. përd. mb. Që është e thjeshtë, e qartë e që bie në sy menjëherë (për pikturën). Pikturë pllakat.
- PLLAKË** f. 7. përd. mb. Që ka trajtën e një rrase a pete. Xham pllakë xham i trashë në trajtë fletësh, që përdoret për dritare, pasqyra etj.  
 PLLANGA-PLLANGA ndajf.  
 2. përd. mb. Me njolla, tërë njolla. E kishte fytyrën pllanga-pllanga.
- PLLOÇË** f. krahin. 3. përd. mb. I rrasur, i ngjeshur; i shkelur; i sheshtë. Ishte toka plloçë. E bëni arën plloçë.  
 4. përd. mb. fig. I zbrazët, pa ngrënë asgjë; petë, rrasë. E kishte barkun plloçë.
- PO** II pj. 12. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË. Pohim; miratim, pranim. Bëri «po» me kokë. Shqiptoi një po nëpër dhëmbë. Ponë e ka po.
- POÇ** m. 5. përd. mb. I shëndoshë dhe i rrumbullakët në trup e në fytyrë; buçkan. Ishte poç.
- POGONISHTE** mb. 2. si em. POGONISHT/E, ~JA f. Valle pogonishte. Kërcejnë (heqin) pogonishten.
- POHOR** mb. 4. si em. ~E, ~JA f. gjuh. Shkalla pohore.
- PORTOKALL** m. 2. si mb. ~, ~E. Që është i verdhë në të kuq, si i verdhë, që ka ngjyrën e lëkurës së portokallit të pjekur. Ngjyrë portokalle. Fustan (dok) portokall. Dritë portokalle.
- POSAÇËRISHT** ndajf. 2. përd. pj. Përdoret për të përforcuar, për të kufizuar a për të veçuar kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi ose të një fjalie me kuptimet «sidomos; veçanërisht». Me rëndësi posaçërisht të madhe. Ata ishin posaçërisht të kënaqur, që merrnin pjesë në këtë gëzim të përbashkët.
- POZITIV** mb. 8. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Diçka që është e dobishme dhe me vlerë; diçka që jep përfundime të dëshirueshme, ndihmon zhvillimin ose ndikon për të mirë; e mira, e dobishmja. Pozitivja në art. Tregojnë (përgjithësojnë, mbrojnë, përhapin) pozitiven. Sundon pozitivja te ne.  
 9. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT elektr. Poli pozitiv; kund. negativ. Pozitivi e negativ.
- PRAKTIKISHT** ndajf. 2. përd. pj. Në të vërtetë, në fakt, realisht. Praktikisht s'e marrim dot. Praktikisht doli që..
- PRANDAJ** lidh. 2. përd. ndajf. edhe iron. Për këtë shkak, për këtë arsye. Ishte më i madh, prandaj! Aha, s'i pëlqeu, prandaj!
- PRANISHËM** mb. 3. si em. ~ËM, ~MI (i) m. kryes. ~ËM, ~MIT (të). Ata që marrin pjesë në një mbledhje, në një takim etj., pjesëmarrësit. Duartrokitjet e të pranishmëve. Përsëndeti të pranishmit. U njoh me të pranishmit.
- PRAPA** 10. përd. mb. I prapmë. Ndodhet në pjesën prapa.
- PRAPAGJUHOR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Bashkëtingëllore prapagjuhore.
- PRAPAKTHEHU** pasth. 2. si em. Kthimi me trup prapa; prapakthim. Një prapakthehu i shpejtë. Bëri prapaktheu. Partizanët e detyruan armikun të bëjë një prapakthehu.  
 3. si em. fig. Ndryshim i menjëhershëm i dikujt në mendime, në veprime dhe në sjellje; kthim në rrugën e mëparshme; pendim, tërheqje; prapakthim. Bëri prapakthehu.
- PRAPAMBETUR** mb. 6. si em. ~, ~A (e) f. ~A, ~AT (të). Diçka që nuk është bërë në kohën e duhur, diçka së cilës i ka kaluar koha; vet. të ardhurat ose shpenzimet që nuk janë nxjerrë ose nuk janë paguar brenda një viti financiar. Volën (shlyen) të prapambeturat.
- PRAPANIK** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Njeri prapanik. Kritikuan prapanikët.

3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Diçka, të cilës i ka kaluar koha, që s'është me normat e moralit tonë e të jetës sonë socialiste. Luftojmë prapaniken, mbrojmë përparimtarën.
4. si em. ~E, ~JA f. bised. Prapanicë.
- PRAPAROJË** f. usht. 2. përd. mb. Që ka për detyrë të ruajë e të sigurojë trupat kryesore, të cilat lëvizin përpara. Njësit praparojë.
- PRERËS** mb. 4. si em. ~, ~I m. kryes. ~, ~IT. Dhëmbët e përparmë që shërbejnë për të prerë, për të këputura për të brejtur diçka. Prerësit e kalit (e lepurit).
- PRES** II kal. 14. përd. pj. Dale. Prit ta shoh! Prit se s'e mora vesh. Prit t'ia tregoj.
- PRIVAT** mb. 5. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ai që nuk është punonjës i ndonjë ekonomie shtetërore ose anëtar i ndonjë ekonomie të përbashkët, ai që ushtron një zeje a mjeshtëri më vete për të nxjerrë fitime. Dyqanet e privatëve.
- PRONOR** mb. gjuh. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Përemri pronor. Pronorët e gjuhës shqipe. Pronorët e vetës së parë.
- PROTOZOAR** mb. zool 2. si em. ~, ~I m. kryes. ~Ë, ~ËT. Njëqelizorët.
- PRUSH** m. 6. përd. mb. fig. Që duket sikur lëshon shkëndija; i gjallë e i papërmbajtur në punë, në luftë etj.; i zjarrtë, zjarr. Është prush. I ka sytë prush.
7. përd. ndajf. Përdoret për të dhënë shkallën më të lartë të tiparit cilësor (të shprehur me një mbiemër) ose të veprimit (të shprehur nga një folje); zjarr. Prush i kuq. Prush i nxehtë. Digjet prush.
8. përd. ndajf. Plot; shumë. Qielli ishte prush me yje. U mbushën pemët prush.
- PSE** ndajf. 2. përd. lidh. shih PËRSE 2. S'ke pse të mërzhitesh.
3. përd. pj. Përdoret në fjali pyetëse për të shprehur qëndrimin e folësit (zakonisht kundërshtimin, mospëlqimin etj.) kundrejt veprimeve a fjalëve të dikujt, në fjali pyetëse retorike ose me ngjyrimë habie etj. Pse, të lë ai?! Pse, ç'të duash ti do të bëjmë?! Pse, rri i qetë ai?! Pse, i mbushet mendja atij?! Pse, lë dy gurë bashkë ai?! Pse, vetëm ty do të të dëgjojmë!?
4. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË. Shkaku, arsyeja; përse. Nuk i dihet (nuk iu gjend) pseja. Kërkonte psenë. Nuk e kuptoi psenë. Ua tha psenë. Psenë e di vetëm ai.
- PUFKË** f. bised. 9. përd. mb. I fryrë si fluskë. I ka sytë pufkë.
- PULLA-PULLA** mb.
2. përd. ndajf. Me pulla, tërë pulla. Duket pulla-pulla.
- PUNËKEQ** mb. 3. si em. ~, ~I m. vet. nj. euf. Djalli, i paudhi.
- PUPËL** f. 3. përd. mb. Shumë i lehtë (edhe fig.). Është pupël fare. E ka gjumin pupël. Është pupël nga mendja. I ka mendtë pupël.
4. përd. ndajf. (me një mbiemër). Shumë. I lehtë pupël. E ndjente veten pupël (të lehtë).
- PUS** m. 5. përd. mb. Shumë i thellë; shumë i errët, shumë i zi, shumë i nxirë (edhe fig.). Errësirë pus. Nata ishte pus. Qielli ishte pus. U bë pus koha (qielli, nata). Jeta i dukej pus. Ia bëri jetën pus ia nxiu jetën.
6. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemra si i zi, i errët etj.). Re të zeza pus. Nata ishte pus e zezë. Qiell i nxirë pus. Ishte i vrenjtur pus. Vështrimi i qe bërë i errët pus. Ishte errët pus. Është i ditur pus.
- PYLL** m. 3. përd. ndajf. Në sasi të madhe; shumë. Misri (gruri) ishte pyll. I kishte flokët pyll (të dendur).
- Q**
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja q. Q-ja e vogël (e madhe). Q-ja e dorës
- QAFËKËPUTUR** mb. 3. si em. bised., si mallk. Ai që e theftë qafën, qafëthyeri. E këputi qafën, ai qafëkëputuri.

- QAFËLESH** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT keq. Djalë ose burrë që i mban flokët tepër të gjatë mbi zverk dhe që për gjithë paraqitjen e jashtme ndjek një modë të shëmtuar.
- QARKUES** mb. 2. si em. m. Ai që qëndron rreth dikujt a diçkaje; ai që merr pjesë në një rrethim.
- QEFULL** m. 2. përd. mb. fig. bised. I gjatë, i hollë e i hijshëm. E ka trupin qefull.  
3. përd. ndajf. fig. bised. Shëndoshë e mirë. Jam qefull. Ka gdhirë qefull.
- QELEPIR** m. bised. 2. përd. ndajf. Pa paguar gjë, falas në kurriz të të tjerëve, pa punë e pa mund. E ka qelepir diçka. Ha (pi) qelepir. E do (e mori) qelepir.
- QELIBAR** m. 2. përd. mb. Shumë i pastër, i kthjellët, i kulluar. Qielli ishte qelibar. E ka ujin qelibar.  
3. përd. mb. fig. Shumë i pastër nga ana morale, i kulluar; i çiltër. E ka shpirtin (zemrën) qelibar.
- QELQ** m. 6. përd. mb. Shumë i pastër, i kthjellët, i ndritshëm. Qielli ishte qelq. I kishte sytë qelq.
- QENGJ** m. 2. përd. mb. fig. I butë e i urtë (kryesisht për fëmijët). E ka qengj djalin. Është bërë qengj është bërë shumë i butë e i urtë, nuk i ndihet më zëri.
- QEPOR** mb. bot. 2. si em. f. vet. sh ~E, ~ET. Bimë barishtore si zambaku etj. që e kanë pjesën e nëndheshme si kokë qepe.
- QERRATA** m. bised. 4. përd. mb. Që të sjell shqetësime e ngatërresa, që të nxjerr kokëçarje; i keq. Qerrata botë. Qerrata erë. Qerrata moshë. Qerrata duhan.
- QESIM** m. 2. përd. ndajf. vjet. Pa e peshuar ose pa e matur, duke i caktuar një çmim të përgjithshëm mallit (për mënyrën e shitjes e të blerjes). E dha qesim. E bleu qesim. E mori qesim.  
3. përd. ndajf. fig. Pa e menduar a pa e peshuar mirë, në tym, kuturu. Flet qesim.
- QETËSUES** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~, ~IT farm. Bar që shërben për të lehtësuar dhembjen e shkaktuar nga një sëmundje a për të ulur ngacmimin e lartë nervor. Pi një qetësues.
- QETHËM** mb. krahin. 3. si em. ~ËM, ~MI (i) m., ~ME, ~MJA (e) f. I ndjeri. Na e la amanet ai i qethmi.
- QËMOTI** ndajf. 3. si em. m. Kohërat e kaluara, koha e lashtë, vitet e largëta të dikurshme. Trimat e qëmotit. Këngët e qëmotit. Hartë e qëmotit.
- QINDVJEÇAR** mb. 2. si em. ~, I m. ~Ë, ~ËT. shih QINDVJETOR, ~I 1. Në qindvjeçarin e parë. Kaluan disa qindvjeçarë.
- QIQËR** f. 2. përd. mb. fig. I shkathët, i gjatë, i mprehtë. Është qiqër. E ka mendjen qiqër. I ka sytë (veshët) qiqër.  
3. përd. ndajf. fig. Në gjendje shumë të mirë shëndetësore, pa asnjë cen a çrregullim. U bë qiqër (kokërr qiqër). U gdhii qiqër.
- QULL** m. 5. përd. mb. I lëngshëm (për gjellët që duhet të jenë pa lëng); fare i papjekur e i pa kulluar, i qullët (për bukën, byrekun etj.). Është bërë pilafi qull. Ka mbetur buka (byreku) qull.  
6. përd. mb. Shumë i lagur, shumë i njomur, ujë. U bë qull u lag shumë, u bë ujë.
- QUMËSHT** m. 6. përd. ndajf. Shumë (për ngjyrën e bardhë, për diçka të pastër). Qumësht e bardhë. Qumësht e pastër.
- QYMYR** m. 4. përd. mb. Shumë i zi. I kishte flokët (sytë) qymyr. I qe bërë kurrizi (trupi) qymyr i qe nxirë kurrizi (trupi) nga të rrahurit.
- QYPJE** 2. si em. QYPJ/E, ~A f. ~E, ~ET. Dardhë qypje. Qypjet janë të ëmbla e me lëng.

- QYQE** f. 4. përd. pasth. Përdoret nga gratë për të shprehur pikëllim, keqardhje a habi; e mjera, e zeza. Qyqja ç'na gjeti! Qyqja, sa vonë qenka! Qyqja, sa e bukur!  
R.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja r. R-ja e madhe (e vogël). R-ja e shtypit
- RACATOR** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kafshë a shpend race; kafshë a shpend që mbahet për të krijuar raca me veti të mira. Veçimi i racatorëve. Kryqëzimi me racatorë.
- RADHË** f. 13. përd. ndajf. bised. Radhazi. Filloi radhë. Ha radhë. I mori radhë.
- RAGABARDHË** mb. 2. si em. m. Lloj rrushi me kokrra të mëdha e të bardha. Ragabardhi piqet vonë.
- RECIDIV** m. mjek. 4. si mb. ~, ~E. Që rishfaqet, që përsëritet edhe një herë, që del përsëri. Vepra recidive.
- REDAKTUES** mb. 2. si em. ~ I m. ~ IT. Redaktori i një shkrimi a i një vepre.
- REKORD** m. 3. përd. mb. Më i madhi ose më i larti që është arritur ndonjëherë në një fushë, shumë i madh, shumë i lartë. Shifër (numër) rekord. Prodhim (të korrës) rekord. Rendiment rekord. Shpejtësi rekord. Në një kohë (afat) rekord në një periudhë shumë të shkurtër.
- REMI** f. shah. 2. përd. ndajf. Në barazim, pa fituar asnjëri nga lojtarët (në lojën e shahut). Jemi remi. Del (e lë) remi. Përfundon (mbaron, mbyllet) remi.
- RENTIER** m. 2. si mb. ~, ~E. Që jeton me të ardhurat nga renta. Borgjezia rentiere.
- REZERVË** f. 9. përd. mb. Që ndahet mënjatë për ta përdorur kur të jetë e nevojshme. Trupa rezervë. Lojtar (futbollist) rezervë. Fond rezervë. Makinë rezervë. Mjete rezervë.
- REZIL** m. bised. shar. 2. si mb. ~, ~E. I pacipë e i pafytyrë, i poshtër.
- RËNË** mb. 3. si em. kryes. ~T (të) fig. Ata që janë vrarë në luftë a në betejë; dëshmorët. Emrat e të rënëve. Gjaku i të rënëve. Amaneti i të rënëve. Nderimi për të rënë.
- RILEVUES** m. 2. përd. mb. Që bëhet për të rilevuar, që bëhet për rilevim. Punime rilevuese.
- RIPËRTYPËS** mb. zool. 2. si em. kryes. ~, ~IT. Kafshë që e përtypin për së dyti në gojë ushqimin që kanë ngrënë. Plëndësi i ripërtypësve.
- RIPRODHUES** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Kafshë që zgjidhet për riprodhim, që të shtohet më tej tufa e një lloji të caktuar. Riprodhues i ri. Riprodhues race. Zgjedhje e riprodhuesve.
- ROKOKO** f. arkit. 2. përd. mb. Që bëhet sipas këtij stili. Stil rokoko. Art rokoko.
- RR** 2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja rr. Rr-ja e madhe (e vogël). Rr-ja e shtypit (e dorës).
- RRAFSH** ndajf. 4. përd. pj. As më shumë, as më pak, plot, pikërisht. Rrafsh një muaj (dy vjet...). Rrafsh njëqind veta (tridhjetë kilogramë, dhjetë thasë). Mbushi rrafsh gjashtë vjet.
- RRAH** m. 2. përd. ndajf. Shtrirë (për tokë, në shtrat). U rrëzua rrah përdhe. Ishin të gjithë rrah nga gripi.
- RRAHEDERË** m. edhe f. 2. si mb. Që shkon duke lypur, lypës. Plakë rrahederë.
- RRAXHË** I f. 2. përd. ndajf. Plot e përplot, buzë më buzë. U mbush rraxhë.
- RRECKAMAN** m. 3. si mb. ~, ~E. I veshur me rroba të grisura, i rreckosur; fig. shumë i varfër, i këputur.
- RRECKA-RRECKA** mb.  
2. përd. ndajf. Me copëra të grisura e të shqyera që varen (për rrobat); me rroba të vjetra e të grisura në shumë vende, lecka-lecka. Ishte bërë rrecka-rrecka.

- RREMË** mb. 7. si em. ~Ë, ~A (e) f. kryes. ~A, ~AT (të). Fjalë e rreme, gënjeshtër. E rrema dhe e vërteta. Mos thuaj të rrema.
- RRETHUAR** mb. 3. si em. m. kryes. ~, ~IT (të). Ata që janë brenda një vendi, të cilin e ka rrethuar kundërshtari. Të rrethuarit e çanë rrethimin.
- RRETHUES** mb. 3. si em. m. kryes. ~, ~IT. Ata që kanë rrethuar një qendër të banuar a një ushtri kundërshtare për ta detyruar të dorëzohet. Rrethuesit e kështjellës. Ushtria e rrethuesve.
- RREZATUES** mb. 4. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Pajisje e posaçme ose trup që lëshon rreze drite a energjie, të cilat përdoren për një qëllim të caktuar. Rrezatues i fuqishëm. Rrezatues drite (zëri).
- RRËKAJË** f. 2. përd. ndajf. Si rrëke. I shkonin lotët rrëkajë. U derdh gjaku rrëkajë.
- RRËKE** f. 5. përd. ndajf. Me shumicë e me vrull, si përrua. Uji rridhte rrëke. Shiu binte rrëke.
- RRËMET** m. 5. përd. ndajf. Me shumicë, shumë. Vijnë rrëmet. Kishte popull rrëmet. Ishin mbledhur rrëmet.
- RRËMUJË** f. 3. përd. ndajf. Në gjendje të çrregullt; në pështjellim të madh; lëmsh, lesh e li. E bëri shtëpinë rrëmujë. I bëri librat (plaçkat) rrëmujë. I la punët (gjërat) rrëmujë. Shkonte puna rrëmujë. E kam kokën rrëmujë. Iu bë mendja rrëmujë.
- RRËNJËS** m. 2. si mb. Që është prej së lashti në atë vend ku banon, vendës, anës; kund. i ardhur, ardhës. Popullsia rrënjëse.
- RRICË** f. 5. përd. ndajf. Në gjendje shumë të vështirë, pisk, ngushtë. E ka rricë. E pa rricë dhe iku. Ia bëri rricë ia mblodhi keq, e ngushtoi fort. Ra rricë.
- RRILLË** f. bot. 2. përd. mb. Që e ka kokrrën shumë të vogël, kokërrvogël. Mollë rrilë. Groshë rrilë.
- RRIP** m. 7. fig. thjeshtligj. Njeri i trashë nga mendja, njeri që nuk ia pret për asgjë; njeri i humbur që s'është i zoti për asnjë punë (edhe përd. mb. sipas kuptimit të emrit). Është fare rrip nga mendja. Është rrip për të kënduar.
8. përd. mb. fig. Shumë i dobët e i ligur, i hollë e i thatë, kockë e lëkurë. E ka bërë rrip sëmundja.
9. përd. mb. bised. Që është i fortë e nuk zien lehtë; që mezi përtypet, rripak. Ishte mishi rrip e mezi zjeu.
- RRIPË** f. 2. përd. mb. Shumë i pjerrët. E ka çatinë rripë. E ka thikën zdrukthi rripë.
- RRJEPACAK** m. 3. si mb. I leckosur, rreckaman (edhe fig.).
- RROKËS** mb. 2. si em. Zhvatës, grabitës. Ishte rrokës i madh.
- RROKULLIMË** f. 5. përd. ndajf. Shumë keq; në rrëmujë të madhe e jo mbarë. Rrokullimë i shkonin punët. I shkoi jeta rrokullimë.
- RRROL** m. 3. si mb. ~, ~E. I plakur e i rënë, i pazoti për punë.
- RRROTULLAME** f. 4. përd. mb. Që ka trajtën e një rrotulle, rrotullar. Bukë rrotullame.
- RRROZG** m. mospërf. 2. përd. mb. Që është plakur e ka rënë; që nuk ka më asnjë vlerë. Ka rrozg.
- RRROZGË** f. 6. përd. mb. mospërf. Që është plakur e ka rënë; që nuk ka më asnjë vlerë.
- RRUAZË** f. 11. përd. mb. I rumbullakët e i ndritshëm. I ka sytë rruazë. I ka dhëmbët rruazë i ka dhëmbët të vegjël, si të rumbullakët dhe shumë të bardhë e të rregullt.
- RRUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që rruan e qeth, berber.
- RRUFE** f. 3. përd. mb. Që bëhet me shpejtësi shumë të madhe; i menjëhershëm dhe i shkurtër, i rrufeshëm. Mbledhje rufe. Aksion rufe. Vizitë rufe. Pyetje rufe. Ndeshje rufe. Luftë rufe. Grusht rufe.

- Trim rrufe trim që lëshohet si vetëtimë mbi kundërshtarin.
4. përd. ndajf. Me shpejtësi shumë të madhe, vetëtimthi. Ra rrufe mbi armiqtë. Ecën rrufe.
- RRUMBULL** m. 2. përd. ndajf. Si lëmsh. I mbështolli rrumbull plaçkat. E ndau (e preu) rrumbull.
3. përd. ndajf. Plot e përplot; rrumbullak. Ishte mbushur rrumbull. Rruga mban rrumbull katër orë. Peshonte rrumbull pesë kilogramë.
- RRUNGAJË** f. 8. përd. ndajf. Në rrëmujë, në pështjellim. Ecnin rrungajë. Ikin rrungajë.
9. përd. ndajf. Plot e përplot me diçka, zakonisht në pështjellim a të shtrirë. Ishte mali rrungajë me ushtari. U shtrinë njerëzit rrungajë.
- RRYELL** m. bot. 2. përd. mb. Shumë i hidhur, helm. M'u bë goja rryell. U bë buka rryell.
- S
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja s. S-ja e madhe (e vogël). S-ja e dorës
- SABOTUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Sabotator.
- SAFI** mb. bised. 2. përd. ndajf. Thjesht. Safi bukë gruri. Safi raki rrushi.
- SAJ** pron. 7. si em. SAJA (e) f. SAJAT (të). Dëshira a vullneti i saj, diçka që do ose që mendon ajo; diçka që e dallon a që e karakterizon atë; diçka që është veti e asaj a ves i asaj. Bën të sajën. Ngul këmbë në të sajën. S'heq dorë nga e saja. Do t'i shkojë gjithmonë e saja. Ka edhe ajo të sajat. E bëri të sajën (natyra, sëmundja, koha ...) veprimi në një mënyrë të caktuar, siç është e rregull dhe e përhershme për të.
- SAP** m. ndërt. 2. përd. mb. Që është me vrima e me veshë (për tullat). Tulla sap. Trari me tulla sap.
- SAPUN** m. 3. përd. mb. bised. Shumë i dhjamur, shumë i majmë (për kafshët); shumë i shëndoshë e i ngjeshur (për fëmijët). Sapun qenka ky dash (cjap). I doli sapun viçi.
- SARAF** m. vjet. 3. si mb. ~, ~E keq. Dorështrënguar, koprrac. Njeri saraf. Grua sarafe.
- SARHOSH** m. keq. 2. si mb. ~, ~E. Pijanec, pijanik. Burrë sarhosh.
- SATRAP** m. 3. përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit. Mbreti satrap.
- SEMIT** m. 2. si mb. ~, E. Semitik. Gjuhë Semite. Fiset Semite.
- SERBES** ndajf. bised. 2. përd. mb. Që flet a që vepron pa druajtje e me krenari; që mbahet me kokën lart. Njeri serbes.
- SIDOKUDO** ndajf. 3. përd. mb. Që nuk është i cilësisë së mirë ose nuk ka ndonjë vlerë, fare i zakonshëm, i rëndomtë, çfarëdoshëm. Punë sidokudo. Nuk është njeri sidokudo.
- SILIKAT** m. 3. si mb. ~, ~E. Që është përgatitur me këtë lloj minerali. Tulla silikate.
- SIMBOLIST** m. art., let. 2. si mb. ~, ~E. Që mbështetet në simbolizëm, që është ithtar i simbolizmit; që krijohet sipas parimeve e metodës së simbolizmit. Poet simbolist. Poezia simboliste.
- SINDIKALIST** m. 2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me sindikatat ose me sindikalizmin; që përkrah sindikalizmin. Krerët sindikalistë borgjezë.
- SINONIM** m. gjuh. 2. si mb. ~, ~E. Sinonimik. Fjalë sinonime.
- SIPËR** 6. përd. mb. I sipërm; i mësipërm. Në katin sipër.
- SITAC** m. 2. përd. ndajf. fig. Vrima-vrima, shoshë. Ishte bërë sitac.
- SKELET** m. 7. përd. mb. Shumë i dobët; kockë e lëkurë. Ishte bërë skelet. Ka mbetur skelet.
- SKIÇ** m. 3. përd. ndajf. Pjerrtas ose tërthorazi në një krah a në një anë; kund. drejt. Rri (ulet) skiç. E vuri skiç. Ecën skiç.

- SKROP** m. 2. përd. mb. Shumë i zi, i zi sterrë. Një palë mustaqe (vetulla) skrop. Ishte bërë skrop ishte nxirë shumë.
3. përd. ndajf. Shumë, fort (për ngjyrën e zezë). Skrop i zi.
- SKUQ** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. E, ~ET. Dhi ose dele me ngjyrë të tillë. Skuqet janë qumështore.
- SMERIL** m. 3. si mb. ~, ~E. Që është i përbërë prej kokrrizave të imëta të këtij minerali. Gur smeril. Letër smerile. Pastë smerile. Lëndët smerile.
- SMIROR** m. 2. si mb. ~, ~E. Smirëzi, resëtar.
- SOLO** f. muz. 2. përd. ndajf. Vetëm, jo së bashku me një këngëtar, valltar ose muzikant tjetër. Këndoi solo. I bie solo një vegle.
- SOLLAK** mb. bised., vjet. 2. si em. f. ~E, ~JA. Dora e majtë.
- SPATHI** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~NJ, ~NJTË. Një letër me këtë ngjyrë. Hedh një spathi. E mori me spathi.
- SPEKULUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Spekulator. Lufta kundër spekuluesve privatë.
- SPIC** 2. përd. mb. Që është i ri fare dhe i zgjedhur me shije të stërholluar; që është i zgjatur dhe i hollë, me majë, spicë. Me rrobat spic. Një palë këpucë spic. Mustaqe spic.
- SPICË** f. 5. përd. mb. Që e ka majën të zgjatur e të hollë, me majë. I mbanin mustaqet spicë.
6. përd. ndajf. Veshur me rroba krejt të reja e duke i mbajtur mirë. Vishet (rri, mbahet) spicë.
- SPIRALE** f. 4. përd. mb. Që vjen duke u dredhur a lakuar rreth një pike a një boshti; që ngjitet a zbret në trajtë spiraleje. Vijë spirale. Shkallë spirale. Turjelë (sustë) spirale.
- SPIUN** m. 4. si mb. ~, ~E. Që është i pajisur me mjete të posaçme për të mbledhur të dhëna, sidomos me karakter ushtarak. Aeroplan spiun. Satelit spiun. Anije spiune.
- SQUKË** f. 2. si mb. Që është prishur (për vezët). Vezë squka.
- STEREOTIP** m. 3. si mb. ~, ~E. Që përsëritet vazhdimisht pa asnjë ndryshim; keq. shabllon, standard. Fjalë (shprehje, fraza) stereotipie.
- STERRË** mb. 4. si ndajf. Shumë, fare (për ngjyrën e zezë). Sterrë i zi. I zi sterrë.
- STRALL** m. 2. përd. mb. Shumë i fortë. E ka gjoksin (kockën) strall.
- SYÇELË** ndajf. 2. si mb. fig. Syhapët. Ushtarë syçelë e të guximshëm. Të jemi kurdoherë syçelë.
- SYHAPUR** ndajf. 2. si mb. fig. Syhapët. Rojë syhapur. Qëndrojmë gjithnjë syhapur.
- SYPËRMBYS** ndajf. 2. si mb. Që nuk vepron hapur, tinëzar.
- SYRGJYN** m. bised., vjet. 4. përd. mb. I internuar ose i mërguar.
- SYTH** m. 10. përd. ndajf. Sikur e kam parë me sy, me siguri, pa asnjë dyshim. E di syth.
- SH** 2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja Sh-ja e madhe (e vogël). Sh-ja e dorës (e shtypit).
- SHABLLON** m. 4. përd. ndajf. keq. Ashtu siç është, pa i ndryshuar e pa i shtuar gjë, pa krijuar vetë asgjë, kallëp. E mori (e zbatoi) diçka shabllon.
- SHABLLONIST** m. 3. si mb. ~, ~E. Që bëhet sipas një shablloni, që ndjek verbërisht një shabllon, që zbatohet në mënyrë shabllone; që vepron në mënyrë shabllone. Veprime shablloniste. Strategji shablloniste.



- SHAFRAN** m. 2. përd. mb. Shumë i verdhë. I verdhë shafra. Janë bërë ftonjtë shafra. U bë shafra (në fytyrë) u zverdh shumë.
3. përd. mb. Shumë i hidhur, helm; shumë i kripur. I hidhur shafra. E ndiej gojën shafra. U bë gjella shafra.
- SHAKULL** m. 4. përd. mb. I fryrë shumë. Me barkun shakull. U bë shakull u fry shumë.
5. si ndajf. I shtrirë pa frymë përtokë, top. Ra (mbeti) shakull. E la (e lëshoi) shakull në vend e vrau në vend.
- SHALAVRIQ** mb. 4. përd. ndajf. Shtrembër e me plogështi. Ecën shalavriq.
- SHARAK** m. 2. përd. mb. Që shan orë e çast, gojëndyrë.
- SHARLATAN** m. 2. si mb. ~, ~E. Mashtrues, i pandershëm, i paturpshëm. Politikan sharlatan.
- SHARRË** f. 8. përd. mb. Që është dhëmbë-dhëmbë, me dhëmbëza, si sharrë; i valëzuar, i dredhur; shumë i mprehtë (për dhëmbët). Thikë sharrë. Makarona sharrë.
9. përd. mb. Që është bërë dhëmbë-dhëmbë, që nuk pret, i topitur (për thikat); që është dhëmbë-dhëmbë a shkallë-shkallë e me thepa (për një vend). U bë sharrë thika. Ishte vendi sharrë.
- SHATORR** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri i shëndoshë e i fortë, njeri i mbushur e i ngjeshur.
- SHENJËTAR** m. 2. si mb. Që qëllon mirë në shenjë. Pushkë shenjëtare.
- SHEQERE** mb. 3. si em. SHEQER/E, ~JA f. ~E, ~ET. Lloj dardhe shumë e ëmbël, dardhë sheqere.
- SHERR** m. 4. si mb. ~, ~E. Sherret, sherrak; i djallëzuar, dinak, i mbrapshtë; resëtar. Është sherr (sherre).
- SHESH** m. 8. përd. mb. I sheshtë, i rrafshët. Vend shesh. E bëri shesh.
9. përd. ndajf. Ulur përdhe, ndenjor. Ulem (rri) shesh. Ra shesh.
10. përd. ndajf. fig. Në mënyrë të qetë e të lirshme, shtruar, këmbëkryq. U shtruan shesh dhe i sqaruan punët. Biseduan (u llafosën) shesh.
- SHËLLIRË** f. 5. përd. mb. Shumë i kripur. Ishte shëllirë gjella.
- SHËRUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT vjet. Mjek.
- SHËTITËS** mb. 2. si em. ~, I m. ~, ~IT. Ai që shëtit, ai që ka dalë për shëtitje. Shëtitësit ishin shpërndarë.
- SHIATIK** mb. anat. 2. si em. ~, ~U m. Nervi shiatik; mjek. sëmundje që prek këtë nerv e që shkakton një dhembje të hidhur. Vuan nga shiatiku. E ka zënë shiatiku.
- SHIGJETË** f. 9. përd. ndajf. Shumë shpejt, fluturimthi. Iku (erdhi) shigjetë.
- SHIRIT** m. 5. përd. mb. Që ka trajtën e një rripi të ngushtë (për disa vegla e përdorëse prej metali a prej një lënde tjetër). Sharrë shirit. Metër shirit.
- SHISHMAN** m. vjet. 2. përd. mb. Shumë i shëndoshë, i trashë nga trupi. Burrë shishman.
- SHITUES** m. krahin. 2. si mb. ~, ~E fig. Që të shpon, që të godit. Me sy shitues.
- SHKËMB** m. 5. përd. mb. I mbushur me shkëmbinj e me gurë të mëdhenj (për një truall a vend). Është vendi shkëmb.
6. përd. mb. Shumë i ngurtë e i thatë, i fortë si gur. U bë toka shkëmb (nga thatësira). Ishte bërë buka shkëmb.
7. përd. mb. Shumë i fortë, që s'tundet nga e tija. E ka kokën shkëmb është shumë kokëfortë, nuk merr vesh.
- SHKËNDIJË** f. 7. përd. mb. Që shkëlqen fort, shumë i ndritshëm, xixë. Syrin shkëndijë e ka. E bëri pushkën (shpatën) shkëndijë e fshiu dhe e pastroi sa e bëri të shkëlqejë.
8. përd. mb. I shkathët dhe i shpejtë në punë e në veprime, shpuzë. Është shkëndijë ajo vajzë.

- SHKOP** m. 9. përd. mb. Shumë i dobët (nga trupi). Ishte bërë shkop!
- SHKOQËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë që shërben për të shkoqur. Shkoqëse misri.
- SHKOQUR** mb. 6. si em. ~A, ~AT (të) f. vet. Para të shkoqura, para të vogla, të holla. S'kam të shkoqura.
- SHKRIFTUES** mb. 2. si em. ~, I m. ~, ~IT bujq. Pajisje e posaçme e plugut, e cila shërben për të shkriftuar tokën. Plug i pajisur me shkriftues.
- SHKRUAR** mb. 4. si em. ~, ~A (e) f. vjet. Fati, e thëna (sipas besimeve të kota). Ashtu e kishte të shkruarën.
- SHKRUMB** m. 3. përd. ndajf. Shumë (zakonisht me mbiemrin i zi). I zi shkrumb shumë i zi, i zi sterrë.
- SHKUL** II m. 2. përd. mb. Shumë i ngrohtë, i nxehtë, i valë. Uji ishte shkul. E përvëlloi me ujë shkul. E kishte trupin shkul.
3. përd. ndajf. Shumë ngrohtë. Kjo pallto të mban shkul.
4. përd. ndajf. Duke hedhur valë, me valë (për ujin kur valon). Hiqe ujin se valoi shkul.
- SHKULËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Mjet që shërben për të shkukur diçka. Shkulëse patatesh. Shkulësja e panxharsheqerit.
- SHKUMË** f. 5. përd. mb. Shumë i butë e i shkrifët, jo i ngjeshur (për gjalpin e njomë etj.). Gjalpë shkumë. Krem shkumë.
6. përd. mb. fig. Që nuk është i lidhur e i ngjeshur, i flashkët, i qullët (për trupin e njeriut). E ka trupin shkumë. Është fare shkumë.
7. përd. ndajf. Shumë, fare (zakonisht me mbiemra si i bardhë, i butë, i shkrifët etj.). I bardhë shkumë. I butë shkumë.
- SHOK** m. 6. si mb. ~, SHOQE drejt. Që është bashkuar me të tjerë në një traktat, në një marrëveshje a në një organizatë ndërkombëtare dhe që gëzon disa të drejta me të kufizuara në krahasim me anëtarët kryesorë. Fuqi shoqe. Anëtar shok.
- SHOSHË** I f. 5. si mb. Vrima-vrime, tërë vrima. E ka tavanin shoshë. U bë shoshë nga plumbat.
- SHOSHUR** mb. 2. si em. ~A, ~AT (të) f. vet. Gëzhuta e papastërti të tjera që bien kur shoshet drithi. Fshij (hedh) të shosurat.
- SHPELLË** f. 3. përd. mb. bised. Shumë i fortë e i lartë (për zërin); fig. i fortë, shkëmb. E ka zërin shpellë. E ka kokën shpellë.
- SHPËTIMTAR** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Ai që shpëton dikë a diçka nga një rrezik a nga një e keqe e madhe. Iu hodh në qafë shpëtimtarit të saj. Shpëtimtar i gjendjes ai që gjen një rrugëdalje në një gjendje të vështirë; ai që përballon një gjendje të vështirë. Shpëtimtarët e atdheut.
- SHPIFËS** m. përcm. 2. si mb. ~, ~E. Që shpif; që përmban shpifje. Propagandë (fushatë) shpifëse.
- SHPIRTO** f. 3. përd. mb. fig. bised. Shumë i gjallë, shumë i shkathët e i zgjuar. Është shpirtol!
- SHPOTITËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Shpotar.
- SHPREHËS** mb. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që shpreh ndjenjat, mendimet, interesat a dëshirat e dikujt. Shprehës i vullnetit (i dëshirave, i mendimeve) të popullit. Shprehësit e interesave të vegjëlisë. U bë shprehës i ndjenjave të dikujt.
- SHPUZË** f. 3. përd. mb. Shumë i kuq e i nxehtë, flakë, prush (për fytyrën kur zemërohemi, kur turpërohemi etj.). U bë shpuzë në fytyrë.
4. përd. mb. Shumë i shkathët e i gjallë, që nuk përton për asgjë, që bën shpejt e mirë çdo gjë që t'i thuash, zjarr; që të kupton menjëherë, shumë i shkathët nga mendja; që duket sikur lëshon shkëndija. Qenka shpuzë. Djalin e ka shpuzë. I ka sytë shpuzë.

- SHQETO** mb. bised. 2. si em. f. ~,~JA gjell. Një lloj gjelle e përgatitur me mish të njomë, të zier vetëm me lëng e me erëza (zakonisht me majdanoz). Porositi një shqeto.  
3. si ndajf. Troç, copë, shqip. Ia tha shqeto.
- SHQIPE** II f. zool. 2. përd. mb. Shumë e shkathët dhe e zonja në punë; trime (për vajzat e gratë). E ka nusen (çupën) shqipe. Është shqipe.
- SHQYT** m. 4. përd. ndajf. krahin. Duke nxjerrë përpara si mburojë trupin a diçka tjetër; për së gjeri, skiç. Ia zuri rrugën shqyt. E zuri derën shqyt me trup.
- SHTALP** m. 4. përd. mb. Shumë i njomë, ende i njomë. Grurë (misër) shtalp. E ka mishin shtalp ky qengj.  
5. përd. mb. fig. I papjekur. Është ende shtalp. E ka kokën shtalp. mospërf. është fare i papjekur (për të rriturit).
- SHTARË** f. 4. përd. mb. fig. Shumë i kripur; i hidhur, farmak. Gjella qenka shtarë. M'u bë goja shtarë.  
5. përd. ndajf. Keq, ters. E nisi mbarë, e mbaroi shtarë. I vaftë shtarë! mallk.
- SHTATËDHJETË** num. rresht. 4. si em. SHTATËDHJETA,~T (të). f. vet. Periudhë prej shtatëdhjetë vjetësh si moshë. I mbushi të shtatëdhjetat.
- SHTATËRROKËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT let. Varg i përbërë nga shtatë rrokje. Shtatërrokëshi përdoret rrallë në poezinë popullore.
- SHTATËVJEÇAR** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Shkollë shtatëvjeçarë e arsimit të përgjithshëm, që ndiqej nga të gjithë fëmijët përpara se të vendosej arsimit i detyrueshëm tetëvjeçar (në vitet e para pas Çlirimit). Ka mbaruar shtatëvjeçaren.
- SHTERP** mb. 6. si em. ~Ë, ~A f. ~A, ~AT. Bagëti (dele, dhi, lopë etj.) që nuk pjell fare ose nuk është barrsë një vit. Shterpë e majme. Kullot shterpat. Ndjaj shterpat nga pëllatë. Theri një shterpë.
- SHTËNG** m. 2. përd. mb. Shumë i ngjeshur dhe i fortë (për tokën, bukën etj.) Ishte bërë toka (buka) shtëng.  
3. përd. ndajf. Si lëmsh i fortë. I mbeti shtëng në grykë.
- SHTJERRË** f. zakon. 2. përd. mb. Shumë i urtë, i butë, i bindur. I ka fëmijët shtjerrra. Është shtjerrë fare.
- SHTOJCË** f. 4. përd. mb. Që i shtohet diçkaje më të rëndësishme a kryesore. Lëndë shtojcë. Punime shtojcë.
- SHTRESA-SHTRESA** mb.  
2. si ndajf. Në formë shtresash të vendosura njëra mbi tjetrën. E hedh dheun shtresa-shtresa. E ndaj shtresa-shtresa.
- SHTRIG** m. 3. përd. mb. keq. Shumë dorështrënguar; zemërngushtë, shpirtkazmë.
- SHTRIGË** f. 4. përd. mb. keq. Shumë dorështrënguar; zemërngushtë e shpirtkazmë.
- SHTRONJAR** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Ferrë shtronjare. E prishi misrin shtronjarja.
- SHTRUES** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë shtruese. Shtruese asfaltbetoni.
- SHTRYDHËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Vegël a çdo mjet tjetër që shërben për të shtrydhur. Shtrydhëse mekanike. Shtrydhëse limoni (domatesh). Shtrydhëse rrushi.
- SHTUPË** f. 5. përd. mb. I thatë, i ngjeshur e që mezi përtypet (zakonisht për disa ushqime që duhet të jenë të buta e me lëng). E paska bërë përseshin shtupë. Iu bë shtupë mishi në gojë.
- SHTYLLË** f. 10. përd. mb. fig. I fortë, i qëndrueshëm, i patundur. Është shtyllë. Qëndron shtyllë e s'bëhet urë.
- SHUK** m. 2. si ndajf. Si toph, si lëmsh, kruspull. E mblodhi shaminë (fustanin, gazetën) shuk.  
3. si ndajf. Vdekur në vend, top. E la shuk në vend.

- SHUMËQELIZOR** mb. biol. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kafshë ose bimë që përbehet nga shumë qeliza a nga një numër shumë i madh qelizash.
- SHUMËS** mb. gjuh. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Numri shumë. Shumësi i shquar (i pashquar). Shumësi i emrave. Shumës mirësjelljeje. Mbaresat e shumësit. Flet në shumë.
- SHUMTA** f. 2. përd. ndajf. Shumë-shumë. E shumta pesë kilometra. E shumta disa javë.
- SHURDH** mb. 2. përd. ndajf. fig. shih SHURDHËR 2.
- SHYQYR** pasth. bised. 2. si em. ~, ~I m. ~E, ~ET vjet., bised. Urim që i bëhej dikujt në një rast gëzimi; gosti që bëhej për një rast të tillë. Shkuan për shyqyr. Ditë shyqyri. Bëri shyqyr kur i lindi djali.  
T.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja t. T-ja e madhe (e vogël). T-ja e dorës
- TAKUES** mb. 3. si em. tek. ~, ~I m. ~, ~IT. Vegël, me anën e së cilës bëhet takimi i dy a më shumë pjesëve të një makine, të një pajisjeje etj. për t'i vënë në punë ato; celës.
- TALMUDIST** m. libr. 2. si mb. ~, ~E. Sko-lastik, pedant. Njeri talmudist.
- TALLABAK** m. 2. përd. mb. I thatë, i ngjeshur (për tokën).
- TALLËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që tall të tjerët, ai që tallet me dikë a me diçka.
- TAMAHQAR** m. bised. 2. si mb. ~, ~E. Që s'ngopet kurrë, që ka tamah, lakmues. Njeri (fëmijë) tamahqar.
- TAMBLAK** m. krahin. 2. përd. mb. Pirës. Qengj tamblak.
- TAPË** f. 5. përd. mb. fig. bised. I dehur keq, i pirë sa nuk e mbajnë këmbët. U bë tapë. Erdhi tapë në shtëpi.
- TATËLOSH** m. bised. 3. përd. mb. Që është pa të keq, baballëk, babëlok. Plak tatëlosh.
- TAZE** mb. bised. 2. përd. ndajf. Shumë pak kohë përpara, thuajse në atë çast, posa.
- TEJBARTËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT spec. Mekanizëm për bartjen e diçkaje. Tejbartës me vargua. Tejbartës me rrip.
- TEK** mb. 4. si em. ~, ~U m. vet. nj. Një i vetëm, një i veçantë.
- TEPËRT** mb. 3. si em. TEPËRT, ~IT (të) as. Të qenët e diçkaje mbi kufijtë a mbi caqet e zakonshme; masë, shkallë, sasi etj. më e madhe se zakonisht; shumicë, tepri. Kujdesej me të tepërt. Kishte para (shpenzonte) me të tepërt. Ia ktheu me të tepërt ia ktheu diçka duke i dhënë edhe një shtesë; ia shpërbleu diçka në një masë disa herë më të madhe.
- TER** m. 2. përd. mb. I patredhur. Dem (buall) ter.
- TERAK** m. 2. përd. mb. I patredhur. Ka (cjav) terak.
- TETËDHJETË** num. rresht. 4. si em. f. vet. ~AT (të). Periudhë prej tetëdhjetë vjetësh si moshë.
- TETËRROKËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT let. Varg i përbërë nga tetë rrokje. Tetërrokëshi në poezinë popullore. Përdor tetërrokëshin.
- TETËVJEÇAR** mb. 4. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET bised. Shkolla tetëvjeçare. Mësues i tetëvjeçares. Nxënësit e tetëvjeçares. Kreu tetëvjeçaren.
- TETORËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~A, ~AT. Periudhë kohe që zgjat tetë orë; kohë punë prej tetë orësh në ditë, që sigurohet me ligj; e drejta për të punuar tetë orë në ditë.
- TEVATUR** m. vjet. 3. përd. ndajf. Gojë pas goje, duke u thënë poshtë e lart. E kishte dëgjuar tevaturo.
- TËMBËL** m. 2. përd. mb. Shumë i hidhur, helm. E kam gojën (gjuhën) tëmbël.

- TËRË** pakuf. 3. përd. ndajf. Përdoret në trajtën e pashquar të një emri në kuptimin «krejt, plot; gjithë». Erdhi tërë gëzim (tërë qejf). Ishte tërë inat. Vendi ishte tërë bar (lule).
4. përd. pj. Krejt, njësoj si dikush tjetër nga vetitë fizike a morale; gjallë, gjithë, Ishte tërë i ati (i vëllai). Ishte tërë e ëma (e motra).
- TËRTËR** m. 2. përd. mb. I dredhur. I ka flokët tërtër.
- TIJ** pron. 7. si em. TIJ, ~I (i) m., TIJ, ~A (e) f. TIJ, ~TË (të) m., TIJA, ~T (të) f.
8. si em. TIJA (e) f. TIJAT (të). Dëshira e vullneti i atij, ajo që do ai; ajo që e dallon a që e karakterizon atë; diçka që është veti e tij a ves i tij; diçka që mendon a kërkon ai ose që ka bërë ai. Bëri të tijën. Vijon të tijën. Ngul këmbë në të tijën. S'heq dorë nga e tija. Do t'i shkoj gjithnjë e tija. I ranë të tijat. Ka edhe ai të tijat.
- TIP** m. 8. përd. mb. Që shërben a që është si model i një grupi të njohur, sendesh ose dukurish. Njësi tip. Rregullore tip. Projekt tip. Statut tip.
- TOÇ** m. 6. përd. ndajf. Duke ethur a duke rruar të gjithë flokët e kokës gjer në rrënjë; pa flokë. U qeth toç. E ka (e bërë) toç kokën.
7. përd. mb. fig. I lehtë nga mendja, torollak. Djalë (plak) toç.
- TOG** m. 6. përd. ndajf. Në grup, bashkë, së bashku, të gjithë së bashku. Mblidhen (rrinë) tog. Ecin tog. I marrim tog.
- TOLLOMBAZ** m. 2. përd. mb. fig. I trashë nga mendja, budalla.
- TONIK** mb. mjek. 3. si em. U m. ~E, ~Et. Bar, pije a lëndë tjetër që të forcon e të jep fuqi. Është një tonik i mirë.
- TOP** m. 6. si ndajf. Të gjithë së bashku, bashkë, tok; lësh, shuk. Erdhën top. Jemi top.
- TOPÇE** mb. bised. 3. si ndajf. Shumë mirë, si top (për shëndetin). Si je? - Topçe.
- TOPURRUK** m. përk. 2. si mb. I shëndoshë, topolak (për fëmijë). Fëmijë (djalë) topurruk.
- TOPUZ** m. 3. përd. ndajf. Mbledhur rrumbullak, top (për flokët). I mban (i kreh, i mbështjell) flokët topuz.
- TOROLINGË** f. 2. përd. mb. fig. keq. I lehtë nga mendja; që e ka kokën bosh, fyçkë. Është torolingë fare!
- TOTAL** mb. libr. 2. si em. ~, ~I m. Tërësia e diçkaje; shuma e përgjithshme. Totali i prodhimit. Totali i shpenzimeve. Detyra në total. Nxjerr totalin. Si total është. E realizoi planin në total.
- TRA** m. 4. përd. mb. fig. I trashë, që s'merr vesh fare, që mezi kupton; trung. Është tra fare.
- TRAGJIK** mb. 3. si em. ~E, ~JA f. let., art. Veçori e botës emocionale që përshkon një vepër letrare ose artistike, e dhënë nëpërmjet një gjendjeje pa rrugëdalje që vjen nga mospërputhja ndërmyjet synimeve të heroit e mundësisë së realizimit të tyre dhe që e çon atë në një fund të hidhur; tragjizëm. Tragjikja dhe komikja. Tragjikja dhe heroikja. Pasqyrimi i tragjikes në letërsi.
- TRAKALIÇ** m. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Fik trakaliç.
- TRASHË** mb. 15. si em. ~A (e) f. ~A, ~AT (të). Pjesa e trashë e diçkaje; gjë e trashë (edhe fig.). E trasha e kofshës kofshëtrashë. Flet (bluan) të trasha thotë budallallëqe.
- TREÇEREKËSHE** f. 3. si mb. Që ka tre çerekë të një të tërë; që nxë tri të katërtat e një mase.
- TREDHËMBËSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Sfurk që ka tre dhëmbë a tri maja. E mblodhi barin me tredhëmbësh.
- TREFLETËSH** mb. 3. si em. ~, ~I m. bot. Tërfil.

- TREMUAJSH** mb. 2. si em. ~,~I m. ~A,~AT. Periudhë kohe prej tre muajsh; tremujor. Tremuajshi i parë i vitit.
- TRETËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ujë a lëng tjetër, që tret një lëndë zakonisht të ngurtë. Tretës vajor. Tretës i zakonshëm. Tretës yndyrash. Heq njollat me tretës. Fut në tretës.
- TRIDHJETË** num. rresht. 4. si em. TRIDHJETAT (të) f. vet. Periudhë prej tridhjetë vjetësh si moshë.
- TRIMOSH** m. 2. përd. mb. Që është i guximshëm e i fortë, trim. Djalë (ushtar) trimosh.
- TROCKIST** m. 2. përd. mb. Që ndjek e përkrah trockizmin, që është ithtar i trockizmit; që i përket trockizmit, që ka lidhje me trockizmin. Grup trockist. Pikëpamje trockiste. Metodë trockiste. Frymë trockiste.
- TROKË** f. 2. përd. mb. Shumë i thatë, i terur; fare pa lagështirë. U bë kopshti trokë. Rrobat u thanë, u bënë trokë.
3. përd. mb. fig. I zhveshur, fare i zbrazët, pa asnjë gjë brenda (pa ushqime, pa orëndi etj.). E kishte shtëpinë trokë.
4. përd. mb. I fëlliqur, keq me pluhur a me baltë. Shkundi, se je bërë trokë! Ishin bërë fëmijët trokë.
5. përd. mb. I grisur, zhele-zhele, copë-copë. Copë e trokë. Trokë se trokë ishim.
- TRUMË** f. 3. përd. ndajf. Në grup, mbledhur në një grup; grumbull mbledhur në një vend; lëmshe. Ecin (fluturojnë, rrinë) trumë. Erdhën top e trumë erdhën të gjithë së bashku, erdhën njësh, tok. Ishin mbledhur trumë. E bëjmë mishin trumë.
- TRUPAK** m. 2. përd. mb. I ngjeshur, i rrasët; i trashur, (zakonisht për gjëra të qullëta). Ishte bërë trupak dheu (balta). U bë trupak gjella.
- TRYEZË** f. 5. përd. mb. Që është i përshatshëm për t'u ngrënë ose për t'u pirë gjatë drekës, darkës etj. Rrush tryeze.
- TU** pron. 2. si em. ~ TË (të) m. Njerëzit e afërm, me të cilët ke lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njerëzit të cilët i do dhe të cilëve u beson shumë. Erdhën (fituan) të tutë. Janë të tutë.
- TUA** (e) pron. 2. si em. ~ (të) f. Ato me të cilat ti ke lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; shoqe a mike të cilat i do dhe të cilave u beson shumë. Janë të tuat.
- TUAJ** pron. 2. si em. ~T. m. Njerëzit e afërt, me të cilët keni lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njerëzit të cilët i doni dhe të cilëve u besoni shumë. Tuajt e humbën lojën.
- TUAJA** pron. 2. si em. ~T f. Ato me të cilat ju keni lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; shoqe a mike, të cilat i doni dhe të cilave u besoni shumë. Erdhën edhe tuajat.
- TUFË** f. 8. përd. ndajf. Së bashku, në grumbuj të dendur, grumbull. Nxënësit dilnin në tufë. Lulet kishin çelur tufë.
- TUHAF** mb. bised. 3. përd. pasth. Çudi!
- TUL** m. 6. përd. mb. I tultë. Mish tul. Është tul.
7. përd. mb. I butë; pjellor (për, tokën). Tokë tul. Dhe tul.
8. përd. mb. fig. keq. I qullët, i ngathët, që s'të kryen punë; që s'ia pret, i trashë; sylesh (për njerëzit). Tul me dy sy copë mishi me dy sy. Ishte tul fare.
- TULLË** f. 4. përd. mb. Tullac, pa flokë. E ka kokën tullë. E bëri kokën tullë i preu flokët gjer në rrënjë ose e rroi kokën me brisk.
- TULLUPAN** m. 3. përd. mb. Shumë i bardhë e i pastër. E lau, e bëri tullupan.
- TURIVARUR** mb. keq. 2. përd. ndajf. Me buzët varur, duke qenë i pakënaqur a i zemëruar.
- TURLI** f. gjell. 2. përd. mb. I ndryshëm; që përmban lloje të ndryshme, që bëhet me lloje të ndryshme, i përzier; gjithfarë, i

- gjithfarshëm; lloj-lloj. Turli mendimesh (fjalësh). Turli njerëzish (popujsh). Turli punësh (gjërash, sendesh). Turli gjellësh (pijesh).
- TYMAK** mb. 2. si em. ~U m. ~Ë, ~ËT krahin. OXHAK. Tymi i tymakut.
- TYTË** f. 5. përd. ndajf. Bosh, zbrazur, pa gjë. Mbeti shtëpia tytë. E kishte barkun tytë.
- TYTOSH** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Njeri pa asnjë vlerë.  
TH.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja th. Th-ja e madhe (e vogël).
- THADËR** f. 2. përd. mb. fig. I hajthëm, por i fortë (për njerëzit). Është thadër ai.
- THANË** f. 2. përd. mb. fig. Jo i ëmbël, pak si i athët; jo shumë i këndshëm a i pëlqyeshëm; i thartë, i ka fjalët thanë. E ka gojën thanë.
- THARTANIK** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. kryes. ~E, ~ET. Tharbore.
- THIKË** m. 4. përd. mb. Shumë i pjerrët, që vjen a që zbret gati pingul. Vend thikë. E përpjet ë(e tatëpjetë) thikë. Nëpër faqet thikë të malit (të kodrës). Ishte thikë rruga (bregu).  
5. përd. ndajf. Pingul. Vjen (zbret, ngrihet, bie) thikë.
- THINJË** f. kryes. 2. përd. mb. Që e ka qimen si të përhitur në të bardhë (për kafshët). Dele thinjë.
- THUK** m. 2. përd. mb. I ngjeshur, i fortë. E ka mishin thuk. I janë bërë krahët thuk.
- THUK** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT. Thuthuq.
- THUMBVERDHË** mb. 2. si em. THUMBVERDH/Ë, ~A f. A, ~AT zool. Mëllenjë thumbverdhë.
- THUNDRAK** mb. zool. 2. si em. ~, ~U m. kryes. ~Ë, ~ËT zool. Rend gjitarësh, ku hyjnë kafshë me trup të madh si kali, gomari, kau, delja etj., që kanë thundra në fund të këmbëve.
- THYER** mb. 8. si em. ~, ~A (e) f. ~A, ~AT (të). Vendi ku është thyer diçka; pjesa ku diçka është çarë, ka krisur a ka filluar të thyhet; pjesa e thyet e diçkaje. E thyera e kockës.  
9. si em. ~A, ~AT (të) f. vet. Para me vlerë të vogël, me të cilat këmbehet një monedhë me vlerë më të madhe të holla, të shkoqura. S'kam (s'më ndodhen) të thyera.  
U I  
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja u. U-ja e vogël (e madhe). U-ja e dorës (e shtypit).
- UBUBU** pasth. 2. si em. f. zakon. ~, ~ TË. Shprehje shqetësimi a frike, duke bërë «ububu».
- UGAR** m. 4. si mb. I punuar, por i lënë pa mbjellë; i lënë pa punuar. Tokë ugare.
- UJEM** m. 4. përd. mb. edhe fig. I përzier, ngatërruar, i turbullt. Raki ujem. Mendime ujem.  
5. përd. ndajf. Turbull, në mënyrë jo të qartë e të ngatërruar, në tym. Flet ujem.
- UJË** m. 11. përd. mb. Shumë i lagur, i qullur. U bë ujë në djersë. Jam ujë.  
12. përd. mb. fig. Që nuk është formuar e lidhur mirë ende, shumë i njomë.  
13. përd. ndajf. Shumë mirë, rrjedhshëm; përmendsh. E di (e flet, e mësoi, e bëri) ujë diçka.
- ULLI** m. bot. 2. përd. mb. Që ka ngjyrë të blertë të errët pak si të përhimët.  
UNAZA-UNAZA ndajf.  
2. përd. mb. Që është në trajtë rrathësh të vegjël, të vendosur njëri pranë tjetrit
- UNË** 2. si em. m. UNI. Tërësia e tipareve që përbëjnë thelbin e njeriut si individ i caktuar dhe për të cilat ai është i vetëdijshëm, qenia e vet, vetvetja në botën që e rrethon njeriun; let., art. veçoritë e botës së krijuesit, të shprehura në vepër; filoz. subjekti; keq. tërësia e vetive të një njeriu, të cilat ai përpiqet t'i vërë në dukje në çdo kohë e me çdo kusht,

- vetja; bota e ngushtë e dëshirave dhe e interesave vetjake të një njeriu, të cilën ai kërkon ta vërë mbi çdo gjë tjetër, mbi interesin e përgjithshëm. Uni poetik (lirik). Fryma e unit. Ngre krye (nxjerr kokë) uni. Shpreh unin e vet. Flet uni. Vë (nxjerr) përpara unin. E bren (e pengon) uni. S'e lë uni. E mposhti (e mundi) unin.
- URITUR** mb. 4. si em. URITUR, ~I (i) m. ~, ~ IT (të). Ai që ka a që ndien uri; ai që nuk ka ngrënë për një kohë të gjatë; i varfër. I ngopuri s'e kujton të uriturin. fj. u.
- USHTËR** f. 2. përd. mb. I paarrirë, shumë i njomë (për bimët dhe frytet e tyre); fig. i papjekur.
- UTHULL** f. 2. përd. mb. Shumë i thartë. Qenka uthull ky rrush.  
V.  
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja v. V-ja e madhe (e vogël). V-ja e dorës
- VAJ** I m. 4. përd. mb. Shumë i qetë, pa dallgë (për detin, liqenin); i shtruar, i bindur; i qetë (për njerëzit). Ishte bërë deti vaj. U shtrua, u bë vaj.  
5. përd. ndajf. Mirë, pa ndonjë vështirësi, pa pengesa, lehtë; qetë. Ecën vaj puna. Diskutimi (mbledhja) shkoi vaj.
- VAJZË** f. 3. përd. mb. E virgjër. Është vajzë.
- VALË** f. 10. përd. mb. Shumë i nxehtë, që të djeg, që të përvëlon; shumë i ngrohtë. Ujë valë. Gjella është valë. Dhoma ishte valë. Shtrati është valë. E bëri valë e ngrohu shumë, e nxehi mirë. U bë valë u ngroh shumë, u nxeh mirë.  
VALË-VALË ndajf.  
2. përd. mb. Që ka shumë valë, i valëzuar. Lundronte në detin valë-valë. I ka flokët valë-valë.
- VARDA** pasth. bised. 3. përd. ndajf. Paesh-tur, një pas një, vazhdimisht; lirisht, pa kufi. Vinin varda;
- VARDAR** m. 2. përd. ndajf. Njëri pas tjetrit, në rresht, varg. Shkonin (vinin) vardar.
- VARE** I f. 3. përd. mb. Shumë i rëndë, plumb; shumë i fortë. Ishte vare. E kishte grushtin (dorën) vare.
- VARG** m. 8. përd. ndajf. Një pas një, njëri pas tjetrit, në radhë, në rresht për një. Shkonin (vinin) varg. Ishin varg. Hynë varg. Lidhen varg. U bënë varg.
- VARGAN** m. 2. përd. ndajf. Njëri pas tjetrit, varg. Ecnin vargan. Shkuan vargun.
- VARR** m. 5. përd. mb. Shumë i vështirë e i rëndë, i paduruëshëm; shumë i mërzitshëm e i zyrtë. Jeta në të kaluarën ishte varr. I ishte bërë shtëpia varr.
- VATËR** f. 10. përd. ndajf. (në bashkëva-jtje me një). Shumë, tufë. Ka një vatër fëmijë. Është me një vatër kalamaj. Erdhën një vatër mysafirë (miq).
- VATHOR** mb. 2. si em. f. VATHOR/E, ~JA. ~E, ~ET. Dhi me vathë a me rezhda, rezhdake.
- VEÇANËRISHT** ndajf. 2. përd. pj. Përdoret për të veçuar një fjalë, një togfjalësh a një fjali ose për të përforcuar a për të kufizuar kuptimin e tyre; sidomos. Heroi pozitiv e veçanërisht njeriu i ditëve tona është pasqyruar mirë në vepër. Mbjelljet, veçanërisht në tokat nën ujë, të mos bëhen njëherësh për të dyja kulturat. Ky vit është veçanërisht i mbarë për punonjësit e shpim-shfrytëzimit.
- VEPROR** mb. gjuh. 2. si em. ~E, ~JA f. Diateza veprorë.
- VESHGJATË** mb. 3. si em. euf. VESHGJAT/Ë, ~I. m. ~Ë, ~ËT. Gomari.
- VET** pron. vetv. 2. si em. Njeri i afërm me të cilin dikush ka lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njeriu; të cilin dikush e do dhe i beson shumë. Shkoi tek të vetët.
- VETE** përem. vetv. 3. si em. Një njeri i veçantë, person. Mos mendo vetëm për veten tënde! Këtë e kam nga vetja ime.



4. si em. euf. Vendi ku janë herdhet, vendi i hollë, vendi i keq; herdhet. I dhemb vetja. I ra në vete. I ra vetja u rrënxua. U këput ndër vete u rrënxua.
- VETËTIMË** f. 3. përd. mb. Shumë i shpejtë; shumë i shkathët. Është vetëtimë nusja.
4. përd. mb. fig. Shumë i pastër; shumë i ndritshëm, dritë. Palla e tij vetëtimë.
5. përd. ndajf. fig. Shumë shpejt, si vetëtimë, vetëtimthi. U nis (u turr, u sul) vetëtimë.
- VETMITAR** mb. poet. 3. si em. ~, ~I m. ~I, ~IT. Ai që rri a jeton vetëm, larg të tjerëve; ai që s'ka të afërm e farefis; ai që e ndjen veten të huaj midis të tjerëve. Jeta e vetmitarit.
- VETMOR** mb. 2. si em. ~, ~I ~m. ~Ë, ~ËT. shih VETMITAR, ~E 3.
- VIJË** f. 14. përd. ndajf. Me shumicë, shumë, rrëke, çurg. I shkonte gjaku vijë.
- VILAR** m. 3. përd. ndajf. Si rrotull, si top pëlhure. E mbështolli (e bëri) vilar.
- VISHNJË** f. 3. përd. mb. bised. Që ka ngjyrën e kokrrave të pjekura të kësaj peme. Fustan vishnjë.
- VITORE** f. 6. përd. mb. E mirë, e zonja dhe e shkathët në punë (për gra e vajza). Vajzë vitore.
- VJOLLCË** f. bot. 2. përd. mb. bised. Që ka ngjyrën e lules së kësaj bime. Fustan vjollcë.
- VOBEKTË** mb. 2. si em. VOBEKT/Ë, ~I (i) m. ~Ë, ~ËT (të). Njeri i varfër, i varfri.
- VODENËS** m. 2. përd. mb. I verdhë në fytyrë, shumë i zbehtë (zakonisht pas një sëmundjeje të rëndë). Është bërë vodenës. E kanë bërë ethet vodenës.
- VRAP** m. 4. përd. ndajf. Duke vrapuar shpejt, me të katra, me nxitim; me të shpejtë, menjëherë. U turr vrap. Shkoi (kaloi) vrap. Vrap u ngrita. Çoje vrap në shtëpi!
- VRER** m. 5. përd. mb. fig. Shumë i hidhëruar, i pikëlluar, i vrerosur helm; shumë i inatosur, i mbushur urrejtje. Dukej vrer. Ishte helm e vrer. Ishte pikë e vrer. U bë vrer.
- VRIMA-VRIMA** ndajf.
2. përd. mb. Që është shpuar a është bërë me vrima. I kishte gjetet vrima-vrима.
- VRUNDULL** m. 3. përd. ndajf. Vrullshëm, me hov. Vërtitet vrundull. Hidhej vrundull.
- VRUSHKULL** m. sh 3. përd. ndajf. Si curril; si rrëke. I shkonte gjaku vrushkull. I rridhnin lotët vrushkull. Derdhej vrushkull.
- X
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja x. X-ja e madhe (e vogël).
- XIXË** f. 5. përd. mb. Shumë i pastër; shumë i ndritshëm. Është xixë. Duket xixë. I ka rrobat xixë. E bëri xixë e pastroi shumë mirë diçka, e bëri të shkëlqejë, e bëri pasqyrë.
- XH.
1. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja xh. Xh-ja e madhe (e vogël). Xh-ja nistore.
- XHABAXHI** m. bised. keq. 2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit.
- XHADE** f. 2. përd. mb. edhe fig. I shtruar, i rrafshët, i sheshtë që nuk ka pengesa a vështirësi, shesh me lule. E bënë fare xhade. E ka rrugën xhade. Jeta nuk është xhade. fj.u.
- XHAM** m. 10. përd. mb. fig. Shumë i pastër; shumë i kthjellët; i ndritshëm. E ka (e bëri) shtëpinë xham. Qielli ishte xham. I ka sytë xham. E ka mendjen xham.
11. përd. ndajf. Shumë (me mbiemra që tregojnë qartësinë ose pastërtinë e diçkaje). Xham i qartë (i kthjellët, i pastër).

- XHENAZE** f. 3. përd. mb. Shumë i dobësuar, i tretur e i bërë kockë e lëkurë (nga ndonjë sëmundje etj.). Ishte bërë fare xhenaze.
- XHENET** m. 3. përd. mb. bised. Që është vetë i qeshur, i gëzuar e gojëmbël dhe që u sjell gëzim edhe të tjerëve. Është djalë (njeri) xhenet. Ka marrë një grua xhenet.
- XHEVAHIR** m. 4. përd. mb. Shumë i mirë, i dashur e i sjellshëm, që ka zemër shumë të mirë; shumë i vlefshëm e i çmueshëm. Djalë (vajzë) xhevahir. Fjalë xhevahir.  
XHUFKA-XHUFKA ndajf.  
2. përd. mb. Që ka shumë xhufka, që është me shumë xhufka. Perde xhufka-xhufka.
- XHUXH** m. 3. si mb. ~, ~E. Shumë i shkurtër, shkurtabiq; shumë i vogël. Djalë xhuxh. Vajzë xhuxhe. Shelg xhuxh. Bimë xhuxhe. Mbeti xhuxh.
- XHUXHMAXHUXH** m. 3. si mb. ~, ~E. Shumë i shkurtër, shkurtabiq; shumë i vogël; xhuxh.  
Y I  
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja y. Y-ja nistore. Y-ja e vogël (e madhe).
- YLL** m. 12. përd. mb. Shumë i bukur. E ka vajzën yll.
- YNË** pron. 7. si em. YNI TANËT. Një i afërt, me të cilin kemi lidhje gjaku, farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njeri, me të cilin na bashkojnë të njëjtat synime, pikëpamje etj.; njeri, të cilin e duam dhe të cilit i besojmë shumë. Është yni. Erdhën tanët. Fituan tanët.
- YT** pron. 7. si em. YTI TUTË (të). Një i afërt, me të cilin ke lidhje gjaku, lidhje farefisnie ose lidhje të ngushta miqësie; njeri, me të cilin të bashkojnë të njëjtat synime, pikëpamje etj.; njeri, të cilin e do dhe të cilit i beson shumë. Është yti. Erdhën të tutë. Fituan të tutë.  
Z
2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja z. Z-ja e madhe (e vogël). Z-ja e dorës
- ZBARDHËS** mb. 2. si em. ~, ~I m.sh. ~, ~IT. Lëndë zbardhëse.
- ZBARKUES** mb. usht. 3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që zbret nga një anije, nga një aeroplan etj. në tokën e kundërshtarit ose në zonën e pushtuar prej tij për të bërë luftime e veprime të tjera ushtarake. Rrethimi (asgjësimi) i zbarkuesve.
- ZBRAZËS** m. 2. përd. mb. Që shërben për të zbrazur diçka të mbushur. Kanal zbrazës.
- ZEBË** mb. 2. si em. ZEB/Ë, ~A f. ~A, ~AT. Dhi a kafshë tjetër me qime të zezë.
- ZEMËRÇELUR** mb. 2. si ndajf. Me zemër të hapur, me çiltëri, çiltas. E priti (i foli) zemërçelur.
- ZEMËRDJEGUR** mb. 3. si ndajf. Me zemër të djegur nga një hidhërim i madh, nga humbja e një njeriu të dashur etj. Shkoi zemërdjegur.
- ZEMËRHAPUR** mb. 2. si ndajf. Pa mbajtur asgjë të fshehtë, me çiltëri me zemër të hapur, hapur, çiltas. Biseduan zemërhapur.  
3. si ndajf. Me gëzim, me kënaqësi të vërtetë; me miqësi të çiltër e të pastër. E priti zemërhapur.
- ZEMËRLËSHUAR** mb. 3. si ndajf. Me zemër të lëshuar, pa guxim e pa besim në vetvete. Iku zemërlëshuar.
- ZEMËRNGRIRË** mb. 2. si ndajf. Me shqetësim të madh e plot ankth në zemër, me zemër të ngrirë. Dëgjonte (rrinte, priste) zemërngrirë.
- ZEMËRPËRVËLUAR** mb. 3. si ndajf. Me zemër të përvëluar, me zemër të plagosur rëndë nga hidhërimi, nga malli etj. E dëgjonte zemërpërvëluar.
- ZEMËRPLASUR** mb. 3. si ndajf. Me zemër të plasur, me brengë në zemër. Shkoi (vdiq) zemërplasur.

- ZEMËRPRISHUR** mb. 2. si ndajf. Me zemër të prishur, me zemër të thyer, zemërthyer. U largua zemërprishur.
- ZEMËRTHYER** mb. 2. si ndajf. Pa dëshirë, pa qejf, me zemër të thyer. Doli zemërthyer.
- ZEMËRVRARË** mb. 2. si ndajf. Me zemër të vrarë, tërë pikëllim, me hidhërim. Erdhi (u kthye) zemërvrarë. U mblodhën zemërvrarë.
- ZEMËRZHURITUR** mb. 2. si ndajf. Me zemër të zhuritur nga malli për dikë a nga dëshira e madhe për diçka ose nga vdekja e një njeriu shumë të afërt. Vdiq zemërzhuritur.
- ZGAVRIQ** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Zgavër e vogël.
- ZGROF** m. bised. 2. përd. mb. I zgavërt, i zbrazët. Ky trung qenka zgrof.
- ZGJEBARAK** mb. 2. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT përcm. Njeri i fëlliqur e i veshur keq.
3. si em. ~, ~U m. ~Ë, ~ËT fig. përcm. Njeri i keq e i poshtër, njeri i pacipë i cili përcmohet nga të tjerët. Ç'merresh me atë zgjebarak!
- ZGJYRË** f. 5. përd. mb. Shumë i fëlliqur. I kishte këmbët zgjyrë. Ishte bërë zgjyrë.
6. përd. mb. fig. I zi, i mjerë. Ia bëri jetën zgjyrë.
7. përd. ndajf. Zi, keq. I ka vajtur puna zgjyrë.
8. përd. ndajf. Shumë (me mbiemra si i zi, i errët, i keq). Zgjyrë i zi.
- ZIGZAG** m. 3. përd. ndajf. Me dredha, me kthesa, me bërryla. Ecën (shkon) zigzag.
- ZINXHIR** m. 6. përd. mb. Që vijnë a që ndodhin varg njëri pas tjetrit; që përbëhet nga veprime, procese etj. të lidhura varg njëri pas tjetrit; i pandërprerë. Aksione zinxhir. Metoda (sistemi) zinxhir. Reaksion zinxhir. kim. reaksion i vijueshëm, ku elementet që dalin nga një zëbrthim mund të hyjnë përsëri në veprim me elementet fillestare.
7. përd. ndajf. Në mënyrë të pandërprerë, njëri pas tjetrit, varg. U radhitën zinxhir. Gjërat janë të lidhura zinxhir. Këto punë shkojnë zinxhir.
- ZJARR** m. 8. përd. mb. Që nuk i përmban dot ndjenjat, që e shfaq haptas e menjëherë një ndjenjë të fuqishme; i gjallë e i papërmbajtur në punë, në luftë etj. I ka djemtë zjarr. Ai është zjarr.
9. përd. ndajf. Përdoret për të dhënë shkallën më të lartë të cilësisë (të shprehur nga një mbiemër) ose të veprimit (të shprehur nga një folje). Është i kuq zjarr. Ishte zjarr i nxehtë. Biseda u ndez zjarr. I digjej koka zjarr. Ai digjet zjarr nga dëshira.
- ZJARRVËNËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që i vë zjarrin qëllimisht diçkaje.
- ZONJË** f. 6. përd. mb. Shumë e mirë, e sjellshme, që të ngjall nderim (për një grua). Është zonjë grua.
- ZOR** m. bised. 5. përd. ndajf. Vështirë. Zor se kthehet (se vjen). Zor se e bën. Zor se e gjen. Zor ta dijë. Është zor ta ndalosh. E ka zor të hyjë.
- ZOTËRI** m. 5. përd. mb. bised. Shumë i mirë, i sjellshëm e i nderuar, fisnik. Burrë (djalë) zotëri.
- ZH** 2. si em. f. Bashkëtingëllorja dhe shkronja zh. Zh-ja e madhe (e vogël). Zh-ja e dorës (e shtypit).
- ZHDKUR** mb. 2. si em. ~, ~I (i) m. ~, ~IT (të). Ai që nuk është më i gjallë; ai që është zhdukur, ai që ka ikur a që ka munguar për një kohë të gjatë. Kërkonin (i gjetën) të zhdukurit.
- ZHELE** f. 2. fig. bised., keq. Njeri a diçka që nuk ka asnjë vlerë, leckë; njeri që merret nëpër këmbë nga kushdo. Para tij ai është zhele. E bëri zhele e shau rëndë, s'ï la gjë pa thënë, e bëri për pesë para. përd. mb. I vjetër, i grisur dhe i ndotur (kryesisht për veshjet). Pantallona (këpucë) zhele.

- ZHELE-ZHELE** mb.  
2. përd. ndajf. Me rroba të vjetra e të grisura, me zhele, lecka-lecka. Ishte veshur zhele-zhele. Ishte bërë zhele-zhele.
- ZHIGËL** f. krahin. 2. përd. mb. Që s'ka thelb a bukë brenda, fyl, fyrbë (për arrën). Arrë zhigël.
- ZHIVË** f. 2. përd. mb. bised. Që ta rrudh gojën kur e ha a e shijon, shumë i kripur; shumë i hidhur, helm. Gjiza qenka zhivë. Duhani ishte zhivë.  
3. përd. mb. fig. bised. Shumë i shkathët, i gjallë e i zhdërvjellët; shumë i lëvizshëm.  
4. përd. ndajf. bised. Përdoret për të shprehur një shkallë të lartë cilësie ose një gjendje të ngritur; shumë mirë. Është zhivë e gjallë. I ecën puna zhivë.
- ZHUBËL** f. 2. përd. ndajf. Me tutla e me rrudha. E biri zhubël letrën. E kishte bërë zhubël fustanin (këmishën).
- ZHUR** m. 5. përd. mb. Që ka shumë rërë e gurë të vegjël. Tokë (vend) zhur-ishtë.  
6. përd. mb. edhe fig. I djegur fare, që është bërë shkrumb; me zemër të djegur, i përvëlur. Bukë zhur. Mbeti zhur. E ka zemrën zhur. Shkoi zhur, e zeza! Ishte zhur të shihte djalin.
- ZHURISHTË** f. 2. përd. mb. Që ka rërë e zhavorr; që ka zhur. Tokë (vend) zhur-ishtë.
- ZHURMËMBYTËS** mb. spec. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Pjesë e posaçme e një motori, e një arme etj., që shërben për të shuar, për të zvogëluar a për të mbytur zhurmën. Pistoletë me zhurmëmbytës. I vuri një zhurmëmbytës.
- ZHURMËPLOTË** mb. poet. 2. përd. ndajf. Me shumë gjallëri e me zhurmë, plot zhurmë. Vjen zhurmëplotë.
- ZHURMËTHITHËS** mb. spec. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Aparat i posaçëm që shuan a që thith zhurmat.
- ZHURMUËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT spec. Aparat i posaçëm që përdore për të shkaktuar zhurmë në valët e radios, të televizionit etj.
- ZHVATËS** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që përdor rrugë, mjete e mënyra jo të ndershme për të marrë nga shteti a nga shoqëria më shumë se i takon a se meriton.
- ZHVESHËS** mb. 2. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET. Makinë e posaçme që përdoret për të zhveshur misrin, orizin etj. Zhveshëse orizi. Zhveshëse misri.
- ZHVILLUES** mb. 2. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Ai që zhvillon më tej dhe e shpie më përpara një teori, një shkencë etj.; ai që vijon e përmirëson më tej punën e dikujt, ai që zgjeron e thellon më tej një ide, një tezë, një doktrinë etj. Zhvilluesit e mendimit shkencor.  
3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT foto. Lëndë kimike e posaçme, tretësirë ku futet një film, një pllakë fotografike etj. për ta larë. Zhvillues i fortë. Përgatit zhvilluesin.
- ZHYT** m. 2. si ndajf. Zhytas. Bie zhyt. E kaloi lumin zhyt. U krodh zhyt. Bëj not zhyt.  
3. si ndajf. fig. Pa u kthjelluar, pa u sqaruar a pa u zgjidhur; mbytur; pa u marrë vesh mirë. Mbeti puna zhyt. E la zhyt.